



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Raporti vjetor i punës për vitin 2022

drejtuar

Kuvendit të Republikës së Kosovës

Mars 2023

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMbledhje Ekzekutive	7
KORNIZA Ligjore	9
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	9
<i>Misioni i KPM-së është:</i>	9
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL	9
<i>Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së</i>	9
<i>Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2022</i>	9
<i>Procesi i nominimeve për anëtarë të KPM-së gjatë vitit 2022</i>	10
AKTIVITETET E KPM-së	10
<i>Mbledhja e parë e KPM-së</i>	11
<i>Mbledhja e dytë e KPM-së</i>	11
<i>Mbledhja e tretë e KPM-së</i>	11
<i>Mbledhja e katërt e KPM-së</i>	11
<i>Mbledhja e pestë e KPM-së</i>	12
<i>Mbledhja e gjashtë e KPM-së</i>	12
<i>Mbledhja e shtatë e KPM-së</i>	13
<i>Mbledhja e tetë e KPM-së</i>	14
<i>Mbledhja e nëntë e KPM-së</i>	14
<i>Mbledhja e dhjetë e KPM-së</i>	15
<i>Mbledhja e njëmbëdhjetë e KPM-së</i>	15
<i>Mbledhja e dymbëdhjetë e KPM-së</i>	16
<i>Mbledhja e trembëdhjetë e KPM-së</i>	17
<i>Mbledhja e katërmëdhjetë e KPM-së</i>	18
<i>Mbledhja e pesëmbëdhjetë e KPM-së</i>	19
<i>Mbledhja e gjashtëmbëdhjetë e KPM-së</i>	20
<i>Luftimi i piraterisë në fushën audiovizuale</i>	20
NDRYSHIMI NË KORNIZËN Ligjore TË KPM-së	21
<i>Vazhdimi i punës në ndryshimin e Ligjit të KPM-së</i>	21
<i>Vazhdimi i punës në legjislacionin sekondar të KPM-së</i>	21
<i>Shpallja e konkursit publik për dhënien e licencave për ofrues të shërbimeve mediale audio (radio)</i>	21
VLERËSIMI I PËRMBAJTJEVE PROGRAMORE DHE MBROJTJA E PUBLIKUT NGA LAJMET E RREME	22
<i>Largimi i përkohshëm nga transmetimi i të gjitha kanaleve me origjinë nga Federata Ruse</i>	22
MBROJTJA E FËMIJËVE DHE TË MITURVE NË MEDIA	23
<i>Vlerësimi i përmbajtjeve programore</i>	23
EDUKIMI MEDIAL	23

<i>Aktivitetet në kuadër të Edukimit Medial me fokus mbrojtën e fëmijëve në media - Organizimi i tri punëtorive me nxënës të shkollave të mesme.....</i>	<i>23</i>
<i>Ligjëratë lidhur me Edukimin Medial me nxënës të shkollës SH.M.U. “Iliria” në Prishtinë</i>	<i>24</i>
<i>Tryeza e diskutimit me rastin Ditës së Fëmijës – 1 qershori.....</i>	<i>25</i>
<i>Takimi me grupin e gazetarëve të rinj kosovar</i>	<i>25</i>
<i>Bashkëpunimi i KPM-së me Departamentin e Gazetarisë së Universitetit të Prishtinës, OSBE-në dhe AGK-në</i>	<i>26</i>
<i>Organimi i vizitës studimore për Shkollën Etike të Gazetarisë.....</i>	<i>26</i>
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE DHE ORGANIZATA VENDORE.....	27
<i>Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</i>	<i>27</i>
<i>Pjesëmarrja në tryezën e diskutimit në kuadër të Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit.....</i>	<i>27</i>
<i>Vizita në transmetuesin publik (RTK).....</i>	<i>27</i>
<i>Takimi me organizatat e personave me aftësi të kufizuara - OPAK.....</i>	<i>28</i>
<i>Memorandumi i Bashkëpunimit me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK).....</i>	<i>28</i>
<i>Pjesëmarrja në tryezën e diskutimit "Media dhe Mbrojtja e Konsumatorit"</i>	<i>29</i>
<i>Takimi me gazetarët nga Ukraina të strehuar në Republikën e Kosovës.....</i>	<i>29</i>
<i>Pjesëmarrja në seminarin mbi rolin e Institutit për Mjekësi Ligjore në trajtimin e rasteve të sulmeve seksuale dhe dhunës seksuale dhe rëndësinë e raportimit të ndjeshëm në media</i>	<i>30</i>
<i>Tryeza e diskutimit “Konsumatorët në tregun e telekomunikimeve”</i>	<i>30</i>
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE.....	31
<i>Takimi rajonal në mes të rregullatorëve të medias lidhur me harmonizimin e Direktivës për Shërbimet Mediale Audiovizuale (AVMSD).....</i>	<i>31</i>
<i>Bashkëpunimi me OSBE dhe Zyrën e Këshillit të Evropës</i>	<i>31</i>
<i>Takimi me përfaqësues nga Unioni Evropian i Transmetuesve (EBU).....</i>	<i>32</i>
<i>Pjesëmarrja në takimet vjetore të Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatore (EPRA)</i>	<i>32</i>
<i>Bashkëpunimi me misionin e ODIHR.....</i>	<i>34</i>
<i>Vizita e KPM-së dhe AMA-s në SHBA.....</i>	<i>34</i>
<i>Takimi me Federal Communication Commission</i>	<i>35</i>
<i>Takimi me National Press Club në Washington</i>	<i>35</i>
<i>Takimi me përfaqësues nga Japan International Cooperation Agency (JICA)</i>	<i>35</i>
<i>Vizita studimore në Agjencinë për Media Elektronike të Kroacisë (AEM) dhe Transmetuesin Publik HRT</i>	<i>36</i>
<i>Vizita në Dikasterin për Komunikim në Vatikan</i>	<i>37</i>
<i>Pjesëmarrja në Konferencën përmbyllëse në kuadër të projektit “Instrumenti Horizontal II”</i>	<i>37</i>
<i>Konferenca për Mediat BE - Ballkani Perëndimor 2022</i>	<i>38</i>
<i>Takimi Regjional i Autoriteteve Kombëtare Rregullative të Mediave</i>	<i>39</i>
<i>Takimi me Partnerët e Platformës së Këshillit të Evropës për Siguri të Gazetarëve</i>	<i>39</i>
<i>Prezantimi i KPM-së në Konferencën Ndërkombëtare të Rregullatorëve të Medias.....</i>	<i>40</i>
<i>Bashkëpunimi i KPM-së me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA)</i>	<i>40</i>
PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE.....	42
<i>Burimet njerëzore.....</i>	<i>42</i>

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS (DMA)	42
<i>Ndalimi i ritransmetimit të kanaleve me origjinë ruse</i>	43
<i>Pajtueshmëria me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë</i>	43
<i>Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale</i>	43
<i>Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës</i>	44
<i>Komunikimet Komerciale Audiovizuale</i>	46
DEPARTAMENTI LIGJOR	46
<i>Rastet për transmetim ilegal - Shkelja e nenit 21, paragrafi 1, dhe nenit 30, paragrafi 5, të Ligjit 04/L-44 për KPM-në</i>	46
<i>Rastet e Shkeljes së Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, nenit 28 - Mos sjellja e Raportit vjetor</i>	47
<i>Rastet për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale</i>	47
<i>Mbrojtja e fëmijëve dhe e të miturve nga përmbajtjet e dëmshme, duke u bazuar në Rregulloren KPM- 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës</i>	48
<i>Rastet e shkeljes së Ligjit 04/L-44 për KPM-në, shkelja e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës; Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale; Rregullores KPM 2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë</i>	48
<i>Rastet për zbatimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta</i>	49
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë - Mos pagesa e taksës për licencë dhe gjobat e shqiptuar nga Komisioni i KPM-së</i>	49
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale</i>	49
<i>Ankesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2022, rastet e shkeljes së Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës</i>	50
<i>Vendimet të cilat i ka marrë Komisioni i KPM-së gjatë vitit 2022 si raste të paraqitura nga Departamenti Ligjor janë gjithsej 124, prej të cilave 44 me gjobë, 73 me vërejtje, 6 vendime për revokim të licencës dhe 1 vendim konfiskim të pajisjeve.</i>	53
DEPARTAMENTI I LICENCIMIT	54
<i>Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës</i>	54
<i>Numri i Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (OSHMA) të licencuar për transmetim tokësor të programeve - ndarja e tyre sipas gjuhës së transmetimit dhe mbulueshmërisë</i>	54
<i>Ndarja e televizioneve përmes operatorëve sipas llojit të programeve</i>	58
<i>Numri i Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) të licencuar - ndarja e tyre sipas pronësisë:</i>	59
<i>Numri dhe llojet e kërkesave/rasteve të proceduara</i>	60
<i>Shpallja e konkurseve publike për frekuenca të reja të radios</i>	61
<i>Vendimet e KPM-së lidhur me rastet e licencimit</i>	61
<i>Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2023</i>	62
<i>Rastet të cilat janë mbyllur pas Shkresave të KPM-së</i>	63
<i>Krahasimi i gjendjes së të licencuarve të cilët kanë operuar në vitin 2021 me vitin 2022</i>	63
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR	64

<i>Raste të ndryshimit të lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së.....</i>	<i>67</i>
<i>Subjektet transmetuese të cilat kanë ndërprerë transmetimin tokësor ose kanë zvogëluar zonën e mbulueshmërisë</i>	<i>67</i>
<i>Kërkesa për frekuencë shtesë dhe frekuenca të reja.....</i>	<i>67</i>
<i>Plani frekuencor dhe dixhitalizimi.....</i>	<i>67</i>
<i>Gjendja për prezencën e sinjaleve televizive tokësore dixhitale, gjegjësisht evidentimi i prezencës së sinjaleve nga shtetet fqinjë:.....</i>	<i>68</i>
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE	68
<i>Buxheti</i>	<i>68</i>
<i>Organizimi i brendshëm i tri organeve të KPM-së.....</i>	<i>73</i>
BORDI PËR ANKESA	74
<i>Përbërja aktuale e Bordit për Ankesa</i>	<i>74</i>
<i>Përbërja e Bordit për Ankesa gjatë vitit 2021.....</i>	<i>74</i>
<i>Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa</i>	<i>74</i>
OBJEKTIVAT E VITIT 2023	75
REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT	76
<i>Vështirësitë dhe sfidat lidhur me zbatimin e Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta</i>	<i>76</i>
<i>Pikëpamjet e KPM-së për dixhitalizimin tokësorë</i>	<i>77</i>
<i>Vështirësitë dhe sfidat lidhur me pavarësinë financiare.....</i>	<i>79</i>
<i>Nevoja për rritjen e numrit të stafit</i>	<i>79</i>
AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2021	80
<i>Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)</i>	<i>80</i>

SHTOJCAT

Shtojca I - Organogrami

Shtojca II - Tabela e Rasteve Ligjore

Shtojca III - Raporti Vjetor Financiar

Shtojca IV - Raporti i Monitorimit “Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale”

Shtojca V - Raporti i Monitorimit “Vlerësimi i pajtueshmërisë së OSHMA-ve me Rregulloren KPM 2017/07 për komunikimet komerciale audio-vizuale”

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet aktivitetet e Komisionit të Pavarur të Mediave (në vazhdim KPM), për periudhën kohore janar-dhjetor 2022, të cilin ju përcjellim në pajtim me nenin 3, paragrafi 2, pika 8, të Ligjit Nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Ashtu siç kërkohet nga Kuvendi, raporti ofron një pasqyrë të punës së KPM-së kundrejt mandatit, kompetencave dhe përgjegjësive të saj. KPM-ja ka arritur t'i realizojë shumicën e objektivave të saj, përfshirë amandamentimin dhe miratimin e akteve nënligjore, shqyrtimin e kërkesave për licencim, monitorimin e të licencuarve dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, gjatë vitit 2022, KPM-ja ka regjistruar 93 raste për shqyrtim të kërkesave, përfshirë kërkesat për licencë të operatorëve të shpërndarjes dhe OSHMA-ve me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, ndryshim të emrit të subjektit të licencuar, ndryshim të pronësisë, heqje dorë nga licenca dhe ndryshim të skemës programore. KPM-ja ka të licencuar 19 TV me transmetim tokësor (përmes frekuencave), 108 TV me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, 89 radio me transmetim tokësor (përmes frekuencave) dhe 38 operatorë të shpërndarjes.

Në 16 mbledhjet e rregullta, KPM-ja ka shqyrtuar me dhjetra raste dhe ka marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë me shkëlqje të legjislacionit të KPM-së, respektivisht shkëlqje të Kodit të Etikës, Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale. Disa nga vendimet e KPM-së janë ankimuar tek Bordi për Ankesa (BA), i cili gjatë vitit 2022 nuk ka mbajtur seanca shqyrtuese ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së, për shkak të mungesës së kuorumit për mbledhje respektivisht mungesës së njërit prej tre anëtarëve të BA-së.

KPM gjatë vitit 2022 ka miratuar Planin e Frekuencave në brezin e transmetimeve në vlerësim të së drejtës së saj për qasje të barabartë me shtetet fqinje në resurset frekuencore, si dhe është vendosur në parim që të iniciohet procedura për lirimin e dividendës së dytë dixhitale dhe kanalet televizive në këto frekuenca të barten në frekuenca tjera. Gjithashtu janë iniciuar procese të koordinimeve frekuencore me Malin e Zi, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Ndërsa, në vazhden e luftimit të piraterisë televizive, edhe këtë vit KPM ka bashkëpunuar ngushtë me ARKEP-in dhe Policinë e Kosovës.

Sa i përket avancimit të infrastrukturës ligjore, KPM-ja ka vazhduar punën me hartimin e rregulloreve të reja dhe amandamentimin e rregulloreve ekzistuese.

KPM i ka kushtuar vëmendje të veçantë promovimit të edukimit medial në të gjitha segmentet e shoqërisë, ngritjen e kapaciteteve për përdorim aktiv, kritik dhe kreativ të mediave dhe ndërgjegjësimin e shikuesve dhe dëgjuesve lidhur me të drejtat e tyre dhe përdorimin e sigurt të shërbimeve mediatike.

Në kuadër të rritjes së partneritetit me akterët vendor dhe ndërkombëtar, KPM-ja ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Organizatën e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK).

Ndërsa, gjatë këtij viti KPM ka bashkëpunuar edhe me Misionin e OSBE-së në Kosovë dhe Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve të BE-së (EU EOM). Për më tepër, KPM-ja ka marrë pjesë në takimin e 55-të dhe 56-të të EPRA-s dhe në Asamblenë e 22-të plenare të Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullative – MNRA dhe në ngjarje të tjera në vend dhe rajon.

Puna e KPM-së për vitin 2023 do të orientohet drejt arritjes së gjashtë objektivave kryesore.

Objektivi i parë ka të bëjë me avancimin e infrastrukturës primare ligjore, finalizimin e punës për Draft Ligjin e ri për KPM-së, bazuar në zhvillimet e fundit teknologjike, evoluimin e mediave, legjislacionin evropian dhe praktikat më të mira rregullative. Objektivi i dytë vazhdon me avancimin e legjislacionit rregullator sekondar, hartimin e rregulloreve të reja dhe amandamentimin e atyre ekzistuese. Objektivi i tretë synon ngritjen e efikasitetit të monitorimeve, respektivisht do të definohet një procedurë më efikase e trajtimit të gjetjeve, respektivisht definimi i intervaleve kohore të arsyeshme të trajtimit të lëndëve prej momentit të shfaqjes së tyre deri në një vendimmarrje meritore dhe ekzekutimin e saj. Objektivi i katërt ka të bëjë me rritjen e transparencës institucionale përmes ridizjanimit të uebfaqes dhe lehtësimit të qasjes së publikut në të. Objektivi i pestë ka të bëjë me përdorimin eficient të resurseve frekuencore, ku për këtë objektiv planifikohet të hartohet Strategjia për Trasmetim Audio Dixhital (Digital Audio Broadcasting – DAB) dhe pjesëmarrja në takimet e organizuara rajonale për këtë temë dhe spektrin frekuencor në përgjithësi.

Objektivi i fundit është afatmesëm dhe lidhet me ndërgjegjësimin e mediave për përgjegjësinë editoriale dhe zhvillimin profesional të mediave (2023 – 2026). Për këtë planifikohet të kryhet hulumtime rreth besueshmërisë së publikut ndaj mediave vendore.

Mars 2023
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

KORNIZA LIGJORE

KPM-ja është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Është themeluar me Ligjin Nr. 04/L-44 për KPM-në, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 mars 2012 dhe i cili ka hyrë në fuqi më 20 prill 2012.

Me nenin 3, paragrafi 2.8, të Ligjit për KPM-në përcaktohet që: “KPM-ja i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri me 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës”.

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

KPM-ja është organ i pavarur, kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio dhe audio-vizuele.

Misioni i KPM-së është:

- Të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audio-vizuele dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare;
- Të kontribuojë në profesionalizimin e shërbimeve mediale audio-vizuele;
- Të mbështes lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audio-vizuele.

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së

Sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, KPM-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, biznesi, menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, media dhe teknologjia informative.

Procedura për emërimin e anëtarëve të KPM-së bëhet sipas nenit 11, pika 2.1, të Ligjit për KPM-në, i cili përcakton se: “brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj”.

Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2022

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar më	Kohëzgjatja e mandatit
Xhevat	LATIFI	Ish-Kryetar	16 tetor 2020 deri më 16 tetor 2022	mandat dy (2) vjeçar

Granit	MUSLIU	Ish-Nënkryetar	16 tetor 2020 deri më 16 tetor 2022	mandat dy (2) vjeçar
Azra	DEŠIĆ	Anëtare	16 tetor 2020	mandat tre (3) vjeçar
Violeta	HYSENI KELMENDI	Ish-Anëtare	17 prill 2018 deri më 17 prill 2022	mandat katër (4) vjeçar
Besnik	BERISHA	Anëtar	21 janar 2022	mandat katër (4) vjeçar
Jeton	MEHMETI	Anëtar	21 janar 2022	mandat tre (3) vjeçar
Fatih	BASHA	Anëtar	21 janar 2022	mandat tre (3) vjeçar

Mandati i anëtarëve të KPM-së përcaktohet në bazë të nenit 13, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, i cili përcakton se: *Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve bëhet me short. Mandati i anëtarëve të KPM-së do të jetë si në vijim: dy (2) anëtarë të KPM-së do të emërohen me mandat dy (2) vjeçar, tre (3) anëtarë me mandat tre (3) vjeçar dhe dy (2) anëtarë me mandat katër (4) vjeçar.*

Procesi i nominimeve për anëtarë të KPM-së gjatë vitit 2022

Bazuar në nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM më 16 shkurt 2022 ka bërë ftesë tjetër publike për nominime për një anëtar të KPM-së, nga komuniteti shumicë. Afati ka qenë 15 ditë, përkatësisht prej datës 16 shkurt deri më 2 mars 2022. Zyra Ekzekutive e KPM-së ka kryer të gjitha procedurat e nominimeve ashtu siç është e përcaktuar me Ligjin për KPM-në dhe të gjitha nominimet e pranuar janë përcjellur sipas procedurës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 4 korrik 2022, KPM ka bërë ftesë tjetër publike për nominime për një anëtar të KPM-së, nga komuniteti shumicë. Afati ka qenë 15 ditë, përkatësisht prej datës 4 deri më 22 korrik 2022.

Gjithashtu, duke u bazuar në nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, më 15 gusht 2022, KPM ka bërë ftesë tjetër publike për nominime për dy anëtarë të KPM-së, nga komuniteti shumicë. Afati ka qenë 15 ditë, përkatësisht prej datës 15 deri më 29 gusht 2022.

Zyra Ekzekutive e KPM-së ka kryer të gjitha procedurat e nominimeve ashtu siç është e përcaktuar me Ligjin për KPM-në dhe të gjitha nominimet e pranuar janë përcjellë sipas procedurës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

AKTIVITETET E KPM-së

Në kuadër të aktivitetit institucional dhe në bazë të obligimeve ligjore, gjatë vitit 2022, KPM-ja ka mbajtur gjashtëmbëdhjetë (16) mbledhje të rregullta, në të cilat ka shqyrtuar dhe ka marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për KPM-në.

Në vazhdim paraqiten në mënyrë kronologjike dhe të përmbledhura rastet e trajtuara dhe vendimet e marra nga Komisioni gjatë seancave të mbledhjeve të rregullta të vitit 2022.

Mbledhja e parë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 20 janar 2022, ka mbajtur mbledhjen e parë të rregullt. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, Komisioni ka shqyrtuar disa raste ligjore lidhur me të drejtat e autorit. Për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion për të analizuar këto raste, Komisioni ka vendosur që të shtyej për mbledhjen e radhës marrjen e vendimeve për këto raste.

Në këtë takim, janë trajtuar edhe dy raste të licencimit, që kishin të bënin me kërkesa për ndërprerje të licencës së operatorëve të shpërndarjes. Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për rastet, Komisioni erdhi në përfundim se janë plotësuar kriteret ligjore dhe ka miratuar këto kërkesa:

- Fiberlink SHPK – Vendim për ndërprerje të licencës së Operatorit të Shpërndarjes; dhe
- N.T.SH. Valanet – Vendim për ndërprerje të licencës së Operatorit të Shpërndarjes.

Mbledhja e dytë e KPM-së

Pas emërimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës së tre anëtarëve të rinj të KPM-së, Komisioni në përbërje të plotë prej shtatë anëtarësh, më 1 shkurt 2022, ka mbajtur mbledhjen e dytë të rregullt.

Sipas rendit të ditës, në këtë mbledhje Komisioni ka shqyrtuar Raportin tremujor të punës së KPM-së, për periudhën tetor – dhjetor 2021. Komisioni pas shqyrtimit ka miratuar Raportin tremujor të punës së KPM-së, për ta përcjellur në Kuvendin e Republikës së Kosovës, bazuar në obligimin ligjor që del nga neni 15 i Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Mbledhja e tretë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 11 shkurt 2022, ka mbajtur mbledhjen e tretë të rregullt. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, Komisioni ka shqyrtuar rastet ligjore lidhur me të drejtat e autorit.

Pas diskutimeve të anëtarëve, Komisioni ka hasur në vështirësi në interpretimin e Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në mungesë të kuptimit diskret dhe të qartë të neneve që kanë të bëjnë me obligimet e KPM-së, si dhe mospërputhjen e neneve të këtij ligji me direktivën Council Directive 93/83/EEC, të cilës i referohet se është në linjë me të. Rrjedhimisht, Komisioni ka vendosur që të shtyej marrjen e vendimit për këto raste dhe të konsultohet me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit lidhur me paqartësitë e disa dispozitave ligjore.

Mbledhja e katërt e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 4 mars 2022, ka mbajtur mbledhjen e katërt të rregullt.

Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, Komisioni ka shqyrtuar disa raste të licencimit. Komisioni ka gjetur se të gjitha kërkesat i kanë plotësuar kriteret ligjore dhe ka miratuar rekomandimet në vijim:

- Radio Plus – Vendim për ndryshimin e lokacionit të transmetuesit;
- Net Plus D.O.O – Vendim për licencim të operatorit të shpërndarjes;
- Dankos Plus Televizija – Vendim për licencim të Ofruesit të Shërbimit Medial Audiovizuel përmes platformës së operatorit të shpërndarjes.

Komisioni ka shqyrtuar gjithashtu edhe një rast ligjor, respektivisht një ankesë për operim ilegal dhe pas shqyrtimit të rastit, Komisioni vendosi për konfiskimin e aparaturës përkatëse, sipas nenit 30, paragrafi 5 i Ligjit për KPM:

- Niart SH.P.K – Vendim për konfiskimin e aparaturës përkatëse të transmetimit si operatori i shpërndarjes.

Mbledhja e pestë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 15 mars 2022, ka mbajtur mbledhjen e pestë të rregullt.

Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, Komisioni ka shqyrtuar çështjen e planit të frekuencave në brezin e transmetimeve (broadcast).

Duke marrë parasysh faktin se menaxhimi me resurset frekuencore është e drejtë sovrane dhe e pamohueshme e secilit vend, në njohje të parimit të së drejtës së qasjes së barabartë në spektrin e frekuencave gjatë procesit të koordinimeve nga ana e shteteve të ndryshme (në veçanti atyre që kufizohen me njëra tjetrën), duke marrë parasysh faktin se në bazë të marrëveshjes Gjeneva 06, Kosovës nuk i janë ndarë frekuenca nacionale që mbulojnë tërë territorin e Kosovës (ato që janë ndarë kanë shtrirje lokale, mbulojnë pjesëza të territorit të Kosovës, dhe si të tilla janë në emër të Serbisë e cila ka negociuar një aranzhim të tillë), Komisioni e vlerësoi si të nevojshme dhe të domosdoshme rishikimin e planit të frekuencave për transmetim dixhital dhe hyrjen në procese koordinimi me të gjitha vendet fqinje.

Komisioni mori vendim që Planit për frekuenca dixhitale (21, 31, 44 dhe 46) në nivel nacional t'i shtohen edhe kanalet 35, 37, 39, 47 dhe 48 në brezin UHF 470-694. Gjithashtu, është vendosur që të fillohet procesi i koordinimit me vendet fqinje me qëllim të eliminimit të pengesave teknike gjatë shfrytëzimit të frekuencave transmetuese sipas parimit të qasjes së barabartë në spektrin frekuencor.

Mbledhja e gjashtë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 29 mars 2022, ka mbajtur mbledhjen e gjashtë të rregullt. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, sipas agjendës Komisioni ka shqyrtuar disa kërkesa në rastet e licencimit dhe ka vendosur si në vijim:

- TIK Telecommunications L.L.C – Kërkesë për licencimin e OSH. Pas shqyrtimit të rastit, Komisioni gjeti se kërkesa nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret ligjore të KPM-së dhe ka vendosur që ky rast të shtyhet për mbledhjen e radhës.

-RTV Podguri – Kërkesë për licencimin e OSHMA-së përmes operatorit të shpërndarjes. Pas shqyrtimit të rastit, Komisioni gjeti se kërkesa nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret ligjore të KPM-së dhe ka vendosur që ky rast të shtyhet për mbledhjen e radhës.

-ARTDOKU 1, ARTKINO 1, ARTDOKU 2, ARTKINO 2, ARTKINO 3, ARTSPORT 1, ARTSPORT 2, ARTSPORT 3, ARTSPORT 4, ARTSPORT 5, ARTSPORT 6 – Kërkesë për ndryshimin e emrit të OSHMA-ve përmes operatorit të shpërndarjes. Pas shqyrtimit të këtyre rasteve dhe rekomandimeve, Komisioni ka konstatuar se janë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe ka vendosur të miratojë këtë kërkesë.

-RADIO 038 – Rekomandim për ripërtëritje të licencës. Pas shqyrtimit të rekomandimit për ndryshim, Komisioni ka konstatuar se janë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe ka vendosur të miratojë këtë kërkesë.

-NIART – Rekomandim për licencimin e OSH sipas platformës IPTV. Pas shqyrtimit të rastit, Komisioni gjeti se kërkesa nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret ligjore të KPM dhe vendosi që ky rast të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Gjithashtu, Komisioni ka shqyrtuar edhe një rast ligjor, respektivisht një ankesë për shkelje të Kodit të Etikës:

-Rasti lidhur me Ankesën e z. Mërgim Teplani ndaj TE7. Pas shqyrtimit të rastit, Komisioni ka kërkuar sqarime shtesë nga Zyra Ekzekutive, duke e shtyer këtë rast për vendimmarrje në mbledhjen e radhës, deri në sqarimet e mëtutjeshme nga Zyra Ekzekutive.

Mbledhja e shtatë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 5 prill 2022, ka mbajtur mbledhjen e shtatë të rregullt. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, sipas rendit të ditës, Komisioni ka shqyrtuar disa raste të licencimit. Rastet e shqyrtuara kishin të bënin me dy kërkesa për licencim të operatorit të shpërndarjes dhe një kërkesë për licencim të OSHMA-së përmes operatorit të shpërndarjes.

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për rastet, Komisioni ka vendosur si në vijim:

- TIK Telecommunications L.L.C – Kërkesë për licencimin e operatorit të shpërndarjes. Pas shqyrtimit, Komisioni konstatoi se kjo kërkesë nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret, prandaj rasti shtyhet për mbledhjen e radhës.
- RTV Podguri –Vendim për licencimin e OSHMA përmes operatorit të shpërndarjes. Pas shqyrtimit, Komisioni ka konstatuar se janë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe ka vendosur të miratojë këtë kërkesë.
- NIART –Vendim për licencimin e operatorit të shpërndarjes. Pas shqyrtimit, Komisioni ka konstatuar se janë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe ka vendosur të miratojë këtë kërkesë.

Gjithashtu, Komisioni ka shqyrtuar edhe një rast ligjor, respektivisht një ankesë për shkelje të Kodit të Etikës.

- Rasti TE7- Ankesa e z. Mërgim Teplani ndaj TE7. Pas shqyrtimit, Komisioni konstatoi se TE7, me mos transmetimin e reagimit të palës ankuese, z. Mërgim Teplani, respektivisht mos dhënien e së drejtës për reagim, ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit

të Etikës KKPM-2016/03. Prandaj, TE7 është sanksionuar me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

Në këtë mbledhje, Komisioni ka aprovuar gjithashtu edhe Rregulloren për Avancimin në Karrierë dhe Transferimin e nëpunësve në Komisionin e Pavarur të Mediave.

Mbledhja e tetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 12 prill 2022, ka mbajtur mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2022. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, sipas rendit të ditës, Komisioni ka shqyrtuar një kërkesë të Asociacionit të Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovë (AMPEK), lidhur me vazhdimin e afatit për fillimin e transmetimit tokësor për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA) lokale dhe regjionale. Ndërsa, shumica e OSHMA-ve me transmetim tokësor lokal dhe regjional përmes shkresave të dërguara kanë kërkuar që për shkak të kostos së transmetimit t'iu mundësohet transmetimi vetëm përmes Operatorëve të Shpërndarjes, përkatësisht të mos obligohen të transmetojnë përmes frekuencave të licencuara të tyre.

Pas shqyrtimit të kërkesës, Komisioni duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, mori vendim që të miratojë pjesërisht kërkesën e AMPEK dhe të obligohen të gjitha OSHMA-të me transmetim lokal dhe regjional, të cilët shfrytëzojnë frekuencat sipas Planit të Spektrit të Frekuencave të Transmetimit, të kthehen në transmetim tokësor deri më datën 30 shtator 2022.

Në vazhdim të mbledhjes, Komisioni ka shqyrtuar gjithashtu edhe disa raste ligjore për shkelje të nenit 30 të Ligjit për të Drejtën e Autorit nga disa operatorë të shpërndarjes:

Swiss Plus 1, Progres, Comnet-A, Bledi, Dot Net, Emonet, Astra Net, Max Tv, Link Produkcija, ISP Broadcast, IPTV Tech, Kadria Net, Job Net, KDS Telestar, Kugo TV, Kumanova Cable, Vision TV, Vista, Kujtesa Net, Ipko, Bb Herc, Artmotion, Galaktika, Connect 3, MTS D.O.O, Speed TV, Telkos, TV Eho dhe Tel Communications.LI.C.

Pas shqyrtimit të rasteve, Komisioni ka vendosur që të gjithë operatorët e shpërndarjes të renditur më lartë të sanksionohen me masën Vërejtje, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në. Po ashtu, Operatorët e Shpërndarjes janë obliguar që në afat brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të Vendimit, të bëjnë regjistrimin e të gjitha marrëveshjeve për kanalet të cilat janë në transmetim nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit të Qeverisë dhe të njoftojnë KPM-në në lidhje me veprimet që kanë ndërmarrë për të vepruar në pajtim me nenin 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Mbledhja e nëntë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 29 prill 2022, ka mbajtur mbledhjen e nëntë të rregullt për vitin 2022. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, Komisioni ka shqyrtuar disa raste të licencimit. Rastet e shqyrtuara kishin të bënin me një kërkesë për licencim të operatorit të shpërndarjes dhe pesë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së OSHMA-ve me transmetim tokësor audio (radio).

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për rastet e licencimit, Komisioni erdhi në përfundim se të gjitha rastet i kanë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe ka vendosur të miratojë të gjitha rekomandimet:

- TIK Telecommunications L.L.C – Vendim për licencimin e operatorit të shpërndarjes;
- Radio 7 – Vendim për ripërtëritjen e licencës së OSHMA-së;
- Radio Bravo – Vendim për ripërtëritjen e licencës së OSHMA-së;
- Radio Campus – Vendim për ripërtëritjen e licencës së OSHMA-së;
- Radio Km – Vendim për ripërtëritjen e licencës së OSHMA-së; dhe
- Radio Maria – Vendim për ripërtëritjen e licencës së OSHMA-së.

Mbledhja e dhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 30 maj 2022, ka mbajtur mbledhjen e dhjetë të rregullt për vitin 2022. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, sipas rendit të ditës, Komisioni ka shqyrtuar disa raste të licencimit. Pas shqyrtimit të rasteve të licencimit, Komisioni ka gjetur se dy kërkesa i kanë plotësuar kriteret ligjore ndërsa një jo dhe ka vendosur të miratojë rekomandimet në vijim:

- TV D+ - kërkesë për licencimin e OSHMA-së me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes. Pas shqyrtimit, Komisioni erdhi në përfundim se nuk janë plotësuar të gjitha kriteret ligjore të KPM-së, prandaj vendosi që kjo kërkesë të shtyhet për shqyrtim për një mbledhje tjetër.
- CORONA MEDIA D.O.O - kërkesë për ndërprerje të licencës së Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA): Balkan Hot, Balkan HOT 2, TV Tajna, Telebet dhe Decija TV. Pas shqyrtimit, Komisioni erdhi në përfundim se janë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe vendosi të miratojë këtë kërkesë.
- Rekomandim për shpallje të konkursit publik për frekuenca të lira për radio në gjuhën Boshnjake në Vitomiricë, Komuna e Pejës. Komisioni shqyrtoi rekomandimin dhe vendosi të shpallë konkurs publik për frekuenca të lira për radio në gjuhën boshnjake në Vitomiricë – Pejë.

Mbledhja e njëmbëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 27 qershor 2022, ka mbajtur mbledhjen e njëmbëdhjetë të rregullt për vitin 2022. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, sipas rendit të ditës, Komisioni ka shqyrtuar disa raste ligjore. Komisioni i Pavarur i Mediave me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së të licencuarve me aktet nënligjore të KPM-së, ka kryer monitorimin e tyre. Sipas gjetjeve nga procesi i monitorimit, KPM ka iniciuar disa raste ligjore të cilat kanë të bëjnë me shkelje të legjislacionit të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Komisioni i ka shqyrtuar këto raste dhe pas shqyrtimit ka vendosur si në vijim:

- KDS Telestar - shkelje e Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Pas shqyrtimit, Komisioni vendosi që t'i shqiptojë masë sanksionuese me Vërejtje operatorit të shpërndarjes KDS Telestar në bazë të nenit 30, paragrafi 1.3, të Ligjit për KPM-në.
- Telekomi i Kosovës - Pajtueshmëria e Telekomit të Kosovës me Rregulloren KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Pas shqyrtimit,

Komisioni vendosi që t'i shqiptojë masë sanksionuese me Vërejtje operatorit të shpërndarjes Telekom i Kosovës në bazë të nenit 30, paragrafi 1.3, të Ligjit për KPM-në.

Sipas rendit të ditës, Komisioni ka trajtuar edhe disa raste të licencimit. Rastet e shqyrtuara kishin të bënin me kërkesa për: ndryshimin e pronësisë, ripërtëritje të licencës dhe licencim të OSHMA-së përmes operatorit të shpërndarjes. Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për këto raste, Komisioni ka vendosur si në vijim:

- Radio Urban FM – Kërkesë për ndryshim të pronësisë. Pas shqyrtimit, Komisioni erdhi në përfundim se nuk janë plotësuar të gjitha kriteret ligjore të KPM-së, prandaj vendosi që kjo kërkesë të mos miratohet.
- Radio Kent FM 2 - Vendim për ripërtëritje të licencës; dhe
- TV D + Vendim për licencimin e OSHMA-së përmes operatorit të shpërndarjes.

Gjithashtu, Komisioni ka shqyrtuar çështjen e amandamentimit të dy rregulloreve: Rregullorja për Komunikime Komerciale Audiovizuale dhe Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale. Pas shqyrtimit, Komisioni vendosi që të fillohet me procedurën e ndryshimit të dy rregulloreve të lartcekura.

Mbledhja e dymbëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 12 korrik 2022, ka mbajtur mbledhjen e dymbëdhjetë të rregullt. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, sipas rendit të ditës, Komisioni ka shqyrtuar disa raste ligjore që kishin të bënin me shkelje të nenit 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit të KPM-së, respektivisht mossjellja e raportit vjetor në KPM.

Sipas nenit 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit të KPM-së përcaktohet që:

1.“*Shërbimet e licencuara mediale audiovizuale duhet t'i paraqesin raport vjetor KPM-së, në të cilin përfshihet informacioni përkitazi me programin dhe veprimin në përputhje me kushtet e licencës së bashku me një raport financiar të detajuar dhe informacione të tjera të parapara me ligj*”.

2.“*Raportet vjetore duhet të dorëzohen në KPM-së jo më larg se me datë 31 mars të vitit vijues, për vitin paraparak. KPM-ja mund të kërkojë informacion të mëtejshëm nëse konsideron se informacioni i paraqitur në raportet vjetor nuk është i plotë.*”

Sipas gjetjeve të KPM-së, të licencuarit në vijim nuk kanë përmbushur obligimin ligjor për sjelljen e raportit vjetor në KPM, prandaj KPM ka iniciuar raste ligjore ndaj këtyre të licencuarve për shkelje të Ligjit për KPM-në:

Radio Dardania, Radio Helix, Mbtv, Radio Borzani, Radio Kaçaniku, Radio Rinia, Fwf City Radio, TV Vali, TV Llapi, 1 TV, Rahovec Channel, Link Produkcija, Connect 3, Isp Broadcast, Iptv Tech ll.c., Vision TV, Max TV, Telekom i Kosovës sha, Tel Communications ll.c., Telekom i Kosovës ott, Emonet, Swiss plus-1, Comnet-a, Radio Antena, Radio Urban FM Prishtinë, Radio Aktiv, Radio Kent FM 2, Radio Iliria, Radio Klokot, TV Iliria, TV Zoom, TV Kosova Channel, Olti TV, A 9 international TV, Tv dialog, Astranet, Radio Urban Fm Prizren, Radio Dodona dhe Radio Bambus.

Komisioni i ka shqyrtuar këto raste dhe pas shqyrtimit ka vendosur që të gjithë të licencuarit e lartpërmendur të sanksionohen me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-

së, për shkelje të nenit 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit të KPM-së. Gjithashtu, janë urdhëruar të gjithë të licencuarit e lartpërmendur që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta dorëzojnë raportin vjetor për vitin 2021 të kompletuar, ashtu siç përcaktohet me nenin 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit të KPM-së.

Mbledhja e trembëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 29 gusht 2022, ka mbajtur mbledhjen e trembëdhjetë të rregullt. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, sipas rendit të ditës, Komisioni ka shqyrtuar disa raste ligjore.

Komisioni i Pavarur i Mediave, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së të licencuarve me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, ka kryer monitorimin e mediave dhe sipas gjetjeve nga procesi i monitorimit, ka iniciuar disa raste ligjore të cilat kanë të bëjnë me shkelje të legjislacionit të KPM-së.

Komisioni i ka shqyrtuar këto raste dhe pas shqyrtimit ka vendosur si në vijim:

- Kanal 10 – shkelje e Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale. Pas shqyrtimit, Komisioni vendosi që të sanksionojë OSHMA Kanal 10 me masën Vërejtje;
- Klan Kosova – shkelje e Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale. Pas shqyrtimit, Komisioni vendosi që të sanksionojë OSHMA Klan Kosova me masën Vërejtje;
- KTV – shkelje e Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale. Pas shqyrtimit, Komisioni vendosi që të sanksionojë OSHMA KTV me masën Vërejtje;
- MTV Kosova – shkelje e Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale. Pas shqyrtimit, Komisioni vendosi që të sanksionojë OSHMA MTV Kosova me masën Vërejtje;
- TE 7 – Pas shqyrtimit, Komisioni vendosi që ky rast të shtyhet për mbledhje tjetër;
- TV Mir – shkelje e Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale. Pas shqyrtimit, Komisioni vendosi që të sanksionojë OSHMA TV Mir me masën Vërejtje.

Sipas rendit të ditës, Komisioni ka trajtuar edhe disa raste të licencimit. Rastet e shqyrtuara kishin të bënin me kërkesa për ndryshimin e pronësisë dhe licencimin e OSHMA-së përmes operatorit të shpërndarjes. Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për këto raste, Komisioni ka vendosur si në vijim:

- Big Brother 1 – kërkesa për licencimin e OSHMA-së përmes operatorit të shpërndarjes është shtyrë për mbledhjen e radhës;
- Big Brother 2 – kërkesa për licencimin e OSHMA-së përmes operatorit të shpërndarjes është shtyrë për mbledhjen e radhës;
- Radio Aktiv – është miratuar kërkesa për ndryshim të pronësisë.

Komisioni ka shqyrtuar çështjen e miratimit të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës për OSHMA me Kërkesë si dhe Formës për Aplikim “Video on Demand”. Pas shqyrtimit, Komisioni vendosi që të shtyhet kjo pikë për mbledhjen e radhës.

Komisioni ka shqyrtuar edhe propozimin për themelimin e “Komisionit për vlerësimin e aplikacioneve për licencë të KPM-së” dhe pas shqyrtimit e ka miratuar propozimin.

Gjithashtu, Komisioni ka miratuar Raportin e Monitorimit “Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale”, monitorim i cili është kryer gjatë muajit korrik 2022.

Mbledhja e katërbëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 19 shtator 2022, ka mbajtur mbledhjen e katërbëdhjetë të rregullt. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, sipas rendit të ditës, Komisioni ka shqyrtuar disa raste ligjore që kishin të bënin me shkelje të nenit 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit të KPM-së, respektivisht mossjellja e raportit vjetor.

KPM, në mbledhjen e mbajtur me datë 12 korrik 2022, kishte vendosur masa sanksionuese me Vërejtje për shkelje të nenit 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit të KPM-së për OSHMA-të të cilat nuk kanë sjellë Raportin vjetor për vitin 2021. Përkundër kësaj, OSHMA-të e listuara në vijim, kanë dështuar të veprojnë në pajtim me Ligjin e KPM-së, duke mos dorëzuar raportin vjetor për vitin 2021 edhe pas masës sanksionuese Vërejtje. Prandaj, KPM pas shqyrtimit të rekomandimeve për këto raste ka marrë vendime për masë sanksionuese me gjobë për shkelje të nenit 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit të KPM-së ndaj këtyre të licencuarve:

Radio Dardania – 2000 €, Radio Helix – 2000 €, MBTV – 2000 €, Radio Borzani – 2000 €, Radio Kaçaniku – 2000 €, Fwf City Radio – 2000 €, TV Vali – 2000 €, TV Llapi – 2000 €, 1tv – 2000 €, Rahovec Channel – 1000 €, Isp Broadcast – 1000 €, Iptv Tech Llc – 2000 €, Vision TV – 2000 €, Max TV – 1000 €, Tel Communications Ll.C. – 1000 €, Comnet-A -2000 €, Radio Kent Fm 2 - 1000€, Radio Klokot – 2000 € dhe Radio Dodona – 2000 €.

Gjithashtu, janë urdhëruar të gjithë të licencuarit e lartpërmendur që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta dorëzojnë raportin vjetor për vitin 2021 të kompletuar, ashtu siç përcaktohet me nenin 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit të KPM-së.

Sipas rendit të ditës, Komisioni ka trajtuar edhe disa raste të licencimit. Rastet e shqyrtuara kishin të bënin me kërkesa për licencimin e OSHMA-së përmes operatorit të shpërndarjes, ndryshimin e pronësisë dhe rekomandim për shpalljen e konkursit publik për frekuence të lirë të radios. Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për këto raste, Komisioni ka vendosur të miratojë rastet në vijim:

- Miratohet kërkesa për ndryshimin e pronësisë së Radio Club FM dhe OSHMA 1 TV;
- Miratohet kërkesa për ndryshimin e pronësisë së Radio Rinia;
- Miratohet rekomandimi për shpalljen e konkursit publik për frekuence të lirë të radios në gjuhën turke në Komunën e Prizrenit;
- Miratohen Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe Formës për Aplikim për OSHMA me Kërkesë (On-Demand).

Komisioni ka shqyrtuar edhe Raportin e Komisionit Vlerësues të Aplikacioneve lidhur me vlerësimin e aplikacioneve (dokumente) të pranuar në konkursin publik për licencë të radios në Vitomiricë. Pas shqyrtimit është konstatuar se nuk janë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së prandaj është vendosur të rishpallet konkursi.

Ndërsa, për dy kërkesa tjera për licencimin e OSHMA Bigbrother 1 dhe Bigbrother 2 Komisioni kishte vendosur që të shtyhen për mbledhjen tjetër.

Gjithashtu, Komisioni ka shqyrtuar edhe disa rekomandime për ndërprerje të transmetimit. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së OSHMA-ve me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, ka realizuar disa monitorime ku ka rezultuar se OSHMA-të e mëposhtme janë gjetur në shkelje të vazhdueshme të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, Rregullores KPM-2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë dhe Ligjin e KPM-së:

- A9 International;
- Labia TV;
- Olti TV;
- Tribuna Channel;
- TV Dialog; dhe
- TV Kosova Channel.

Pas shqyrtimit të rasteve, Komisioni ka vendosur që OSHMA-të e lartcekura të sanksionohen me ndërprerje të licencës së transmetimit në bazë të nenit 30, paragrafi 1.6, të Ligjit të KPM-së, për shkeljet të vazhdueshme të nenit 4.6 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, nenit 24 të Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, nenit 13, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë dhe nenit 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit të KPM-së.

Mbledhja e pesëmbëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 26 shtator 2022, ka mbajtur mbledhjen e pesëmbëdhjetë të rregullt. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, sipas rendit të ditës, Komisioni ka shqyrtuar disa raste të licencimit, që kishin të bënin me kërkesa për licencimin e OSHMA-së përmes operatorit të shpërndarjes.

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për këto raste të licencimit, Komisioni ka gjetur se të dyja kërkesat i kanë plotësuar kriteret ligjore dhe ka vendosur të miratojë rekomandimet në vijim:

- Big Brother 1 – Miratohet kërkesa për licencimin e OSHMA-së përmes operatorit të shpërndarjes; dhe
- Big Brother 2 – Miratohet kërkesa për licencimin e OSHMA-së përmes operatorit të shpërndarjes.

Mbledhja e gjashtëmbëdhjetë e KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 10 tetor 2022, ka mbajtur mbledhje e gjashtëmbëdhjetë të rregullt. Pas miratimit të agjendës dhe procesverbalit nga mbledhja e fundit, sipas rendit të ditës Komisioni ka shqyrtuar disa raste ligjore për shkelje të nenit 30 të Ligjit për të Drejtën e Autorit nga disa operatorë të shpërndarjes lidhur me regjistrimin e marrëveshjeve të operatorëve të shpërndarjes në shoqatën VAPIK.

Bazuar në nenin 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, marrëveshjet mbi të drejtën e autorit që kanë të bëjnë me ritransmetimin e programeve audio-vizuele do të jenë të vlefshme vetëm pasi ato të jenë regjistruar nga shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave. Rastet e shqyrtuara janë renditur si në vijim:

Artmotion, Swiss plus 1, Tel communications, Telkos, Vision tv, Vista, Link produkcija, Bb Herc, Astra net, Bledi, Komnet-A, Connect-3, Dot net, Emonet, Galaktika, Ipko, IPTV Tech, ISP Broadcast, Job Net, Kadria net, Kugo tv, Kujtesa net, Kumanova cable, Max Tv, MTS D.O.O, Speed Tv, TV Eho.

Pas shqyrtimit të rasteve, Komisioni ka vendosur që të gjithë operatorët e shpërndarjes të renditur më lartë të sanksionohen me masën sanksionuese gjobë 1000€ (një mijë euro), në bazë të nenit 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-së për ritransmetim të kanaleve pa marrëveshje valide në kuptim të nenit 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, si dhe nenit 21, paragrafi 2.7 të Ligjit Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, konkretisht nenit 160, paragrafi 2.

Gjithashtu, sipas këtij vendimi janë obliguar operatorët e shpërndarjes që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, të bëjë ndërprerjen e kanaleve në ritransmetim, deri në regjistrimin e marrëveshjeve në shoqatën për menaxhimin kolektiv të të drejtave, ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, si dhe nenit 21, paragrafi 2.7 të Ligjit Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, konkretisht nenit 160, paragrafi 2.

Komisioni në këtë mbledhje ka miratuar edhe Raportin tremujor të punës së KPM-së, për periudhën korrik-shtator 2022, bazuar në obligimin ligjor që del nga neni 15 i Ligjit Nr.4/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Luftimi i piraterisë në fushën audiovizuele

Në kuadër të luftimit të piraterisë në fushën audiovizuele, gjatë periudhës raportuese, KPM ka ndërmarrë veprime ndaj një operatori ilegal të shpërndarjes. KPM ka pranuar ankesë me pretendimin se një operator i shpërndarjes Niart SH.P.K, i pa licencuar në KPM, është duke transmetuar dhe ritransmetuar kanale pa marrëveshje.

Pas procesit të monitorimit nga ana e KPM-së, është gjetur se ky operator kryen transmetime ilegale dhe se nuk ka filluar procedurat e licencimit në KPM. Prandaj, në mbledhjen e katërt të KPM-së, Komisioni pas shqyrtimit të rastit, ka vendosur për konfiskimin e aparaturës përkatëse, sipas nenit 30, paragrafi 5, të Ligjit për KPM. Pas këtij vendimi, KPM në bashkëpunim/koordinim

me Policinë e Kosovës, ka zbatuar procedurën e konfiskimit të pajisjeve përkatëse të transmetimit. Gjithashtu, lidhur me këtë rast të transmetimit ilegal, disa ditë pas konfiskimit të pajisjeve, i njëjti ka filluar procedurat për licencim në KPM.

NDRYSHIMI NË KORNIZËN LIGJORE TË KPM-së

Vazhdimi i punës në ndryshimin e Ligjit të KPM-së

Sipas Planit të Veprimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2021 është iniciuar edhe ndryshimi/amandamentimi i Ligjit për KPM-në. Në lidhje me këtë, janë mbajtur disa takime në mes të përfaqësuesve të KPM-së dhe përfaqësuesve nga Zyra e Kryeministrit.

Puna ka vazhduar edhe gjatë pjesës së dytë të vitit, ku janë mbajtur disa takime në mes të përfaqësuesve të KPM-së dhe përfaqësuesve nga Zyra e Kryeministrit. KPM ka ofruar sugjerimet e saj për ndryshimet e nevojshme në projektligj, të cilat më pas janë shqyrtuar edhe në grupin punues të kryesuar nga ZKM. Projektligji është nxjerrë në konsultim publik nga ana e Qeverisë dhe komentet e pranuar me shkrim dhe ato gjatë dëgjimit publik, janë shqyrtuar në një punëtori të përbashkët të ZKM-së dhe KPM-së. Në muajin gusht 2022, KPM ka organizuar në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit një punëtori për finalizimin e draftit të projektligjit për KPM-në. Deri në fund të periudhës raportuese, puna në projektligj është finalizuar dhe pritet procedim i mëtejshëm sipas agjendës së ZKM-së.

Vazhdimi i punës në legjislacionin sekondar të KPM-së

KPM, gjatë vitit 2022, ka iniciuar amandamentimin e dy akteve nënligjore: 1. Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audio-vizuele dhe 2. Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audio-vizuele. KPM gjithashtu ka vazhduar punën e nisur më herët në nxjerrjen e një akti të ri nënligjor që është “Rregullorja për Pronësinë dhe Koncentrimin e Mediave”.

Gjatë periudhës raportuese, grupet punuese për hartimin e legjislacionit sekondar, pothuajse i kanë finalizuar draftet për tu publikuar për diskutim publik sipas procedurës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga ana e KPM-së. Ndërsa, procesi ka stagnuar për shkak të skadimit të mandatit të dy anëtarëve të KPM-së më 16 tetor 2022, njëkohësisht Kryetarit dhe Nënkyetarit, ku Komisioni ka mbetur jo funksional në vendimmarrje dhe në pritje të emërimit edhe të tre anëtarëve të KPM-së nga Kuvendi. Rrjedhimisht, deri atëherë këto akte nënligjore të planifikuara, nuk mund të finalizohen për diskutim publik pa miratimin e Komisionit.

Shpallja e konkursit publik për dhënien e licencave për ofrues të shërbimeve mediale audio (radio)

Komisioni i Pavarur i Mediave, në mbledhjen e datës 19 shtator 2022, ka vendosur për shpalljen e konkursit publik për dhënien e licencave për transmetimin e programeve në radio në Komunën e Prizrenit - një (1) frekuencë regjionale në gjuhë turke, dhe në Komunën e Pejës (Vitomiricë) - një (1) frekuencë lokale në gjuhën boshnjake.

KPM, duke u bazuar në nevojën e banorëve të komunitetit turk të Komunës së Prizrenit si dhe banorëve të komunitetit boshnjak të Vitomiricës - Komuna e Pejës, për informacione të karakterit lokal dhe në gjuhën e tyre amtare, interesimin e tyre për frekuenca të radios si dhe mundësinë e zhvillimit të pluralizmit medial, ka bërë vlerësimin mbi mundësinë e shpalljes së konkursit për frekuenca të lira në këto lokacione dhe ka vlerësuar se ka mungesë të shërbimeve mediale audio në nivel lokal si edhe ka vlerësuar nevojën për zhvillimin e pluralizmit medial.

Ky vlerësim është bërë i bazuar në Ligjin e KPM-së, respektivisht nenin 9, i cili përcakton Politikën e Transmetimit në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, KPM ka konfirmuar edhe mundësitë teknike për frekuencat e lira, të cilat janë në pajtim me planin frekuencor të Republikës së Kosovës dhe që të njëjtat mund të dalin në konkurs për dhënie në shfrytëzim për kandidatët të cilët i plotësojnë më së miri kriteret konkurruese. Konkursi për aplikime ka qenë i hapur për 30 ditë, duke filluar nga data 28 shtator 2022 deri më 28 tetor 2022.

VLERËSIMI I PËRMBAJTJEVE PROGRAMORE DHE MBROJTJA E PUBLIKUT NGA LAJMET E RREME

Largimi i përkohshëm nga transmetimi i të gjitha kanaleve me origjinë nga Federata Ruse

Me 26 shkurt 2022, Komisioni i Pavarur i Mediave ka marrë vendim të Urdhërojë të gjithë operatorët e shpërndarjes që përkohësisht t'i largojnë nga transmetimi kanalet me origjinë nga Federata Ruse, me qëllim të parandalimit të propagandës dhe mbrojtjes së sigurisë publike në Republikën e Kosovës. Qëllimi i këtij vendimi ishte parandalimi i propagandës dhe mbrojtjes së sigurisë publike në Republikën e Kosovës dhe jo pengimi dhe cenimi i lirisë së fjalës dhe lirisë së medias.

Gjithashtu, sa i përket kësaj çështje, Komisioni i Pavarur i Mediave ka përcjellur një Letër të hapur për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale lidhur me përmbajtjet programore përmes platformave të ndryshme, me theks të veçantë nga mediat me origjinë dhe të afërta me pushtetin aktual në Federatën Ruse.

KPM përmes kësaj letre i ka udhëzuar të gjithë të licencuarit që gjatë transmetimit të përmbajtjeve programore të kenë kujdes dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura me qëllim të evitimit të shpërndarjes së lajmeve propaganduese dhe të rreme. Posaçërisht është kërkuar kujdes i shtuar për lajmet nga mediat me origjinë ruse apo të afërta me pushtetin aktual në Federatën Ruse, që mund të shpërndajnë përmbajtje me gjuhë të urrejtjes, dezinformimit, diskriminimit, jo tolerancës me qëllim të arsyetimit të luftës së tyre ndaj Ukrainës dhe të cilat në një formë ose tjetër mund të cenojnë edhe sigurinë dhe rendin publik të Republikës së Kosovës.

Përmbajtjet programore që promovojnë gjuhë të urrejtjes si dhe nxisin ose promovojnë cilëndo nga format e diskriminimit dhe jo tolerancës, janë të ndaluara sipas Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, dhe në këtë aspekt janë në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Për të shmangur shpërndarjen e përmbajtjeve të tilla dhe për të mbrojtur interesin publik, në informimin e drejtë dhe të paanshëm të publikut rreth ngjarjeve me interes të përgjithshëm, është kërkuar nga të licencuarit e KPM-së të ndërmerren veprime të menjëhershme.

Në këtë letër, KPM ka vlerësuar lartë rolin e të licencuarve të saj dhe profesionalizmin e treguar gjatë raportimit lidhur me situatën e luftës në Ukrainë.

MBROJTJA E FËMIJËVE DHE TË MITURVE NË MEDIA

Vlerësimi i përmbajtjeve programore

Komisioni i Pavarur i Mediave në mënyrë të vazhdueshme ka treguar vëmendje të posaçme sa i përket zbatimit të akteve nënligjore të KPM-së nga ana e OSHMA-ve, me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve, si kategori e ndjeshme e shoqërisë, nga përmbajtjet që mund të kenë ndikim negativ në zhvillimin e tyre fizik, mental dhe moral.

Me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të përmbajtjeve programore të ofruara nga OSHMA-të në raport me aktet nënligjore të KPM-së sa i përket mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale, në periudha të ndryshme kohore gjatë vitit 2022, KPM ka kryer monitorimin e OSHMA-ve me transmetim tokësor dhe OSHMA-ve me karakter gjeneralistik që operojnë përmes OSH-ve. Në monitorimin e zhvilluar në muajin prill janë përfshirë njëzet e një (21) OSHMA me përmbajtje gjeneralistike, prej tyre gjashtëmbëdhjetë (16) OSHMA me transmetim tokësor: RTK1, TV 21, TV Koha Vision, TV Puls, TV Besa, TV Vali, TV Mir, TV Most, TV Herc, TV Festina, TV Liria, TV Prizreni, TV Dukagjini, TV Syri Vision, TV Mitrovica dhe TV Tema dhe pesë (5) OSHMA me transmetim përmes OSH-ve: RTK2, Klan Kosova, TE7, Kanal 10 dhe ATV. Tri OSHMA me transmetim tokësor lokal/regjional: TV Iliria, TV Opinion dhe TV Zoom nuk janë përfshirë në monitorim për arsye të mungesës së incizimit të sinjalit të tyre për shkak të mos transmetimit nga ana e tyre.

Në muajin maj monitorimi ka përfshirë katër (4) OSHMA me përmbajtje tematike (muzikë) që operojnë përmes OSH-ve: ON TV, Zico TV, MTV Kosova dhe First Channel.

Monitorimi në qershor/korrik ka përfshirë pesë (5) OSHMA me përmbajtje gjeneralistike të gjetura në shkelje gjatë muajit prill: TV Koha Vision, TV Vali, TV Mir, Klan Kosova dhe Kanal 10.

Në muajin korrik, monitorimi i realizuar ka përfshirë katër (4) OSHMA me përmbajtje tematike (muzikë) të gjetura në shkelje gjatë muajit maj: ON TV, Zico TV, MTV Kosova dhe First Channel. Për të gjitha shkeljet e identifikuar gjatë këtyre periudhave, Komisioni ka marr vendime në pajtim me Ligjin për KPM-në. (Për më shumë detaje rreth gjetjeve të raportit shih shtojcën numër IV).

EDUKIMI MEDIAL

Aktivitetet në kuadër të Edukimit Medial me fokus mbrojtjen e fëmijëve në media - Organizimi i tri punëtorive me nxënës të shkollave të mesme

Në kuadër të angazhimeve të edukimit medial, Komisioni i Pavarur i Mediave ka mbajtur dy punëtori në Prishtinë me nxënës të shkollave me qëllim të diskutimit të çështjeve që kanë të bëjnë me edukimin medial. Punëtoritë janë mbajtur më 10 dhe 11 mars 2022 me nxënësit e shkollave të mesme “Sami Frashëri” dhe “Xhevdet Doda”.

Qëllimi i organizimit të këtyre punëtorive ishte promovimi dhe ndërgjegjësimi për ndikimin e medias, rritjes së njohurive rreth pranim, përdorimit, mbrojtjes dhe konsumit të përmbajtjeve mediale, zhvillimit të shprehive dhe aftësive që nevojiten për të zhvilluar mendimin kritik sa i përket përmbajtjeve në internet dhe teknologji tjera dixhitale.

Për dy ditë me radhë, nxënësit kishin mundësinë të marrin njohuri rreth rolit dhe mandatit të KPM-së si dhe rreth çështjeve që kanë të bëjnë kryesisht me edukimin medial, gazetarinë dhe qytetarinë dixhitale.

Gjithashtu u zhvilluan diskutime me nxënësit mbi rëndësinë e analizimit dhe zbërthimit të lajmeve dhe mesazheve të tjera mediatike.

Aktivitete për edukimin medial janë vazhdimësi e bashkëpunimit në forcimin e programit për edukimin medial të Komisionit të Pavarur të Mediave, mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë. Punëtoritë janë organizuar në kuadrin e Aksionit “Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias (JUFREX)” pjesë e programit “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë II” (Horizontal Facility II) një iniciativë bashkëpunimi e bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës dhe i zbatuar nga Këshilli i Evropës.

Gjithashtu, në kuadër të aktiviteteve për edukimin medial, Komisioni i Pavarur i Mediave ka mbajtur një ligjëratë edhe me nxënës të shkollës së mesme Gjumnazi “Ulpiana” në Lipjan, me qëllim të diskutimit të çështjeve që kanë të bëjnë me edukimin medial, përkatësisht mbrojtjen nga lajmet e rreme. Ligjëratat është mbajtur më 17 mars 2022, me Grupin e nxënësve për Siguri dhe Parandalim, që funksionon në kuadër të shkollës.

Diskusimet me nxënësit u fokusuan në rëndësinë e analizimit dhe zbërthimit të lajmeve dhe mesazheve të tjera mediatike, me theks të veçantë në format e identifikimit të lajmeve të rreme dhe parandalimit të ndikimit të tyre.

Gjatë prezantimit janë ofruar informata rreth funksionimit të mediave në Kosovë, respektivisht kuadrin të rregullimit ligjor të mediave nga ana e KPM-së. Ndërsa, me fokus të veçantë ishte sqarimi se si mund të bëhet një ankesë në KPM ndaj përmbajtjeve mediale.

Ligjëratë lidhur me Edukimin Medial me nxënës të shkollës SH.M.U. “Iliria” në Prishtinë

Komisioni i Pavarur i Mediave, më 5 maj 2022, ka mbajtur një ligjëratë me nxënës të Shkollës “Iliria” në Prishtinë, me qëllim të diskutimit të çështjeve që kanë të bëjnë me edukimin medial, përkatësisht mbrojtjen nga lajmet e rreme.

Qëllimi i organizimit të kësaj ligjërate ishte promovimi dhe ndërgjegjësimi për ndikimin e lajmeve të rreme në media, rritjes së njohurive rreth pranimit, përdorimit, mbrojtjes dhe konsumit të përmbajtjeve mediale, zhvillimit të shprehive dhe aftësive që nevojiten për të zhvilluar mendimin kritik sa i përket përmbajtjeve në internet dhe teknologji tjera dixhitale.

Gjithashtu, janë zhvilluar diskutime me nxënësit mbi rëndësinë e analizimit dhe zbërthimit të lajmeve dhe mesazheve të tjera mediatike, me theks të veçantë format e identifikimit të lajmeve të rreme dhe parandalimit të ndikimit të tyre.

Gjatë prezantimit janë ofruar informata rreth funksionimit të mediave në Kosovë, respektivisht kuadrin të rregullimit ligjor të mediave nga ana e KPM-së. Ndërsa, me fokus të veçantë ishte edhe sqarimi se si bëhet një ankesë ndaj mediave në KPM, forma dhe mënyra e paraqitjes së ankesave nga ana e qytetarëve.

Tryeza e diskutimit me rastin Ditës së Fëmijës – 1 qershori

Me rastin e Ditës së Fëmijës – 1 qershori, KPM me 1 qershor 2022 ka organizuar një tryezë diskutimi me temën: “Mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e papërshtatshme në media”.

Qëllimi i tryezës ishte që në kuadër të Ditës së Fëmijës – 1 qershori, aktorët të mund të paraqesin pikëpamjet e veta lidhur me raportin fëmijë-media, përmbajtjet e papërshtatshme në media, edukimin medial si dhe mënyrat e mundshme se si mund të mbrohen fëmijët nga përmbajtjet e dëmshme në media.

Pjesëmarrësit në panelin e diskutimit kanë paraqitur para të pranishmëve në pika kryesore pikëpamjet e tyre kryesisht në lidhje me edukimin medial ku një ndër çështjet kryesore është mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve në media, nga përmbajtjet e dëmshme mediale, konkretisht çka konsiderohet përmbajtje e papërshtatshme mediale për fëmijët, si ndikojnë përmbajtjet e papërshtatshme tek fëmijët etj.

Nga të gjitha diskutimet e pjesëmarrësve, përgjithësisht janë pajtuar se ende nuk është arritur që të formësohet një qasje e organizimit të përbashkët në mes të institucioneve dhe organizmave përgjegjëse si: rregullatori, mediat, shkollat, këshillat e prindërve dhe institucionet tjera publike si dhe OJQ-të që e kanë fushëveprimtari mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Prandaj, rekomandim i takimit ishte që të hartohet një politikë unike në nivel vendi për mbrojtjen e fëmijëve e në këtë kuadër të futet edukimi medial dhe mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në media si lëndë e rregullt në shkolla. Ndërsa, nga përfaqësuesi i Këshillit të Prindërve është kërkuar që institucionet të shqyrtojnë edhe mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet, sepse krahas ndryshimeve të hovshme teknologjike sigurisht se nevojitet edhe sfida e rregullimit adekuat ligjor përkatësisht amandamentimin dhe hartimin e legjislacionit.

Takimi me grupin e gazetarëve të rinj kosovar

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 13 qershor 2022, ka pritur në takim pune një grup gazetarësh të rinj nga Kosova, në kuadër të një vizite studimore të organizuar nga OSBE.

KPM si institucion çdo herë ka shprehur gatishmërinë të ofrojë mundësi për vizita të tilla e posaçërisht me gazetarë të rinj, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me rregullimin e mediave në vend. Në vazhdim të takimit janë prezantuar dhe sqaruar në detaje organizimi, funksionimi dhe roli i KPM-së si rregullator i vetëm dhe i pavarur për mediat audiovizuele në Republikën e Kosovës. Në pika të shkurta është paraqitur puna dhe aktivitetet e KPM-së, në monitorimin e zbatueshmërisë së legjislacionit nga ana e të licencuarve si dhe veprimet e ndërmarra nga KPM-ja.

Zyrtarët e KPM-së iu kanë përgjigjur pyetjeve të studentëve duke u ofruar sqarime lidhur me punën e KPM-së në monitorimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audiovizuele, si punë e përhershme e institucionit dhe në bazë të ankesave, si dhe obligimet ligjore të të licencuarve, sidomos në respektimin e Kodit të Etikës, Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuele etj. Gjithashtu, u ofruan edhe përgjigje

dhe sqarime tjera për pyetjet e parashtruara për çështjet që kanë të bëjnë me rregullimin e të licencuarve si dhe çështje tjera lidhur me shërbimet mediale audiovizuele në përgjithësi.

Ky takim ka qenë si vazhdimësi e takimeve të tjera dhe bashkëpunimit të KPM-së me gazetarët e rinj e sidomos me studentët e gazetarisë, me qëllim të promovimit të standardeve etike të gazetarisë, rritjes së cilësisë së raportimit në media dhe mbrojtjes së interesit të publikut.

Bashkëpunimi i KPM-së me Departamentin e Gazetarisë së Universitetit të Prishtinës, OSBE-në dhe AGK-në

Në kuadër të bashkëpunimit në mes të KPM-së me Departamentin e Gazetarisë së Universitetit të Prishtinës (UP), OSBE-së dhe Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), më 25 maj 2022, në Zyrën e KPM-së është mbajtur takimi i radhës në mes përfaqësuesve të institucioneve respektive.

Qëllimi i këtij takimi ishte inicimi dhe konkretizimi i projektit i cili për bazë e ka Memorandumin e Bashkëpunimit të KPM-së me UP-në, respektivisht fillimi i fazës së dytë të punës praktike në KPM, për studentë të gazetarisë të përzgjedhur nga Departamenti i Gazetarisë.

Gjatë muajve korrik-gusht 2022, ka vazhduar faza e dytë e punës praktike në KPM, për studentë të gazetarisë të përzgjedhur nga Departamenti i Gazetarisë. Puna praktike ka qenë e planifikuar dhe është realizuar në monitorimin e mediave, përkatësisht hulumtimin dhe analizimin e përmbajtjeve programore sa i përket monitorimit të lajmeve për mbulueshmërinë e tyre gjeografike dhe monitorimit të numrit të burimeve të lajmeve.

Studentët e gazetarisë në koordinim nga mentori i tyre nga universiteti, sipas projektit kanë hartuar dhe paraqitur një raport lidhur me gjetjet e tyre mbi temat që kanë hulumtuar gjatë punës së tyre në KPM. Rekomandimet nga raportet, do të shërbejnë për mediat, studentët e tjerë dhe të gjithë të interesuarit në fushën e shërbimeve mediale audiovizuele.

Ky projekt ashtu si edhe i kaluari, është realizuar me mbështetjen edhe të Misionit të OSBE-së në Kosovë, me çka është bërë e mundur edhe zbatimi i objektivave të memorandumit.

Organimi i vizitës studimore për Shkollën Etike të Gazetarisë

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 23 nëntor 2022, ka pritur në vizitë studimore një grup gazetarësh të rinj dhe studentë të gazetarisë nga Shkolla e Etikës së Gazetarisë, në kuadër të një vizite studimore të organizuar nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK).

Nga ana e KPM-së është prezantuar një përmbledhje e shkurtër rreth rregullatorit të mediave. Në vazhdim të takimit janë prezantuar dhe sqaruar në detaje organizimi, funksionimi dhe roli i KPM-së si rregullator i vetëm dhe i pavarur për mediat audio-vizuele në Republikën e Kosovës. Në pika të shkurtra është paraqitur edhe puna dhe aktivitetet e KPM-së, në monitorimin e zbatueshmërisë së legjislacionit nga ana e të licencuarve, kuadri ligjor, procedurat e punës dhe afatet si dhe ankesat ndaj mediave dhe trajtimi i tyre nga KPM-ja.

Zyrtarët e KPM-së u janë përgjigjur studentëve në pyetjet e parashtruara për çështjet që kanë të bëjnë me rregullimin e të licencuarve, duke u ofruar sqarime lidhur me punën e KPM-së në monitorimin dhe rregullimin e Shërbimeve Mediale Audio-vizuele. Me theks të veçantë u diskutua për këto tema: respektimi i Kodit të Etikës nga ana e mediave dhe rastet e ankesave, Rregullorja

për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve dhe Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuele, skemat programore, procedurat e licencimit në KPM, bartja e obligueshme e kanaleve, emisionet e drejtpërdrejta dhe mbrojtja e të miturve në media.

Ky takim ka qenë një vazhdimësi e takimeve tjera dhe bashkëpunimit të KPM-së me KMSHK-në, me qëllim të promovimit të standardeve etike të gazetarisë, rritjes së cilësisë së raportimit në media dhe mbrojtjes së interesit të publikut. KPM mbetet institucion i cili është çdo herë i gatshëm që të ofrojë mundësi për bashkëpunim dhe takime të tilla e posaçërisht me gazetarë të rinj, në lidhje çështjet që kanë të bëjnë me rregullimin e mediave në vend.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE DHE ORGANIZATA VENDORE

Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Gjatë periudhës raportuese, KPM ka mbajtur një takim edhe me Ministrin e Kulturës z.Hjarullah Çeku. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i çështjes së zbatimit të obligimeve të KPM-së që dalin nga Ligji për të Drejtat e Autorit, respektivisht çështja e marrëveshjeve për të drejtat e autorit. Në këtë takim, KPM sqaroi sfidat me të cilat përballlet në zbatim të Nenit 30 të Ligjit për të Drejtat e Autorit, në veçanti problemet me terminologjinë e asaj që quhet ritransmetim kabllor, si dhe obligimeve absurde për OSHMA-të që t'i nënrenditen kërkesave për regjistrim të marrëveshjeve kolektive. Meqë Ligji për të Drejtat e Autorit është në fazën e amandametimit, KPM gjithashtu ka kërkuar që gjatë rishikimit të Ligjit të ketë diskrecion në kuptimet e neneve dhe të adresohet çështja e të drejtave të autorit sipas praktikave më të mira dhe direktivave evropiane.

Pjesëmarrja në tryezën e diskutimit në kuadër të Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit

Në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, më 3 maj 2022, Komisioni i Pavarur i Mediave ka marrë pjesë në një tryezë diskutimi me temën "Të bërit gazetar i në këtë kohë, plasimi i Informatës si e mirë publike, sfidat, kërcënimet dhe rreziqet", të organizuar nga Instituti i Mediave të Kosovës dhe Klubi i Gazetarëve të Vitisë. Pjesëmarrës tjerë në këtë organizim ishin edhe Këshilli Koordinues i Rotarian-ve të Kosovës, Ambasada Britanike në Prishtinë, Ambasada e Shqipërisë në Prishtinë, Komuna e Vitisë, Instituti i Mediave të Kosovës dhe gazetarë nga media të ndryshme.

Në shenjë nderimi nga organizatori janë vendosë kurora lulesh te lapidari i "Kerim Lawton", gazetarit të Associated Press, në Viti. Aktiviteti vazhdoi me një diskutim nga pjesëmarrësit në Shtëpinë e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Qëllimi i këtij organizimi ishte që të tërhiqet vëmendje për rolin e veçantë të gazetarisë në krijimin e lajmeve që janë informata të verifikuara, në lidhje me interesin publik dhe se si kjo varet nga ekosistemi i gjerë që ofron informatën si një të mirë publike, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë ekonomike të mediave. Pjesëmarrësit në tryezë gjatë diskutimeve paraqiten pikëpamjet e tyre edhe lidhur me avancimin e mekanizmave për sigurimin e transparencës, avancimin e kapaciteteve për Edukimin Medial dhe informativ që u mundësojnë njerëzve të njohin, vlerësojnë dhe të mbrojnë gazetarinë e lirë dhe të pavarur si pjesë jetike dhe e konsideruar edhe si një e mirë publike.

Vizita në transmetuesin publik (RTK)

Një delegacion i Komisionit të Pavarur të Mediave ka vizituar përfaqësuesit e Bordit dhe Menaxhmentit të Radio Televizionit të Kosovës, më 6 maj 2022.

Në këtë takim është diskutuar lidhur me fushat e interesit të përbashkët me qëllim të rritjes së bashkëpunimit në mes të KPM-së dhe RTK-së. Pos tjerash u ngrit edhe çështja e borxheve të trashëguara që RTK-ja ka ndaj KPM-së dhe për rëndësinë e harmonizimit të agjendës dhe veprimeve për procesin e dixhitalizimit.

Gjithashtu, përfaqësuesit e KPM-së dhe transmetuesit publik kanë diskutuar edhe për rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional lidhur me procesin e draftimit të projekt ligjeve për KPM-në dhe RTK-në, të cilat projekt ligje janë në agjendën legjislative të Kuvendit të Kosovës për këtë vit.

Takimi me organizatat e personave me aftësi të kufizuara - OPAK

Në kuadër të aktiviteteve të Vitit 2022 – Vit i Personave me Aftësi të Kufizuara, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 24 maj 2022, ka realizuar një takim me përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara – OPAK: HANDIKOS, Shoqatën e të Verbërve, Forumin Kosovar të Aftësisë së Kufizuar dhe Down Syndrome, me qëllim të diskutimit rreth mospërdorimit të drejtë të terminologjisë për personat me aftësi të kufizuara nëpër media të Kosovës.

Duke qenë se termi adekuat është ‘aftësi e kufizuar’, i definuar edhe në Kushtetutën e Kosovës dhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, shumë gazetarë e media, individët e këtij komuniteti i etiketojnë gabimisht si ‘persona me paaftësi, hendikep, nevoja të veçanta etj’.

Si rrjedhojë, organizatat e personave me aftësi të kufizuara, me rekomandim të KPM-së janë dakorduar që të shtojnë ankesa në KPM në rastet kur hasin se media të caktuara audio-vizuele kanë përdorur terme të gabuara për personat me aftësi të kufizuara.

Në fund të këtij takimi, palët janë dakorduar që shpejt të nënshkruajnë një marrëveshje për një bashkëpunim e ndërgjegjësim sa më të madh për këtë qëllim.

Memorandumi i Bashkëpunimit me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK)

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në bashkëpunim me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK), më 30 maj 2022, kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi.

Memorandumi është nënshkruar nga z. Xhevat Latifi - Kryetar i KPM, z.Afrim Maliqi - HANDIKOS, Daut Tishuki - Shoqata e të Verbërve të Kosovës (SHVK), z.Enver Kurtalani - Shoqata Kosovare e të Shurdhërve (SHKSH), znj. Sebahate Beqiri - Down Syndrome Kosova dhe z. Bujar Kadriu - Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar.

Duke u bazuar në shpalljen e Vitit 2022 – Vit i Personave me Aftësi të Kufizuara, memorandumi është iniciuar me qëllim kryesor bashkëpunimin ndërmjet Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Komisionit të Pavarur të Mediave. Objektiv kryesor është ndërgjegjësimi sa më i madh i shërbimeve mediale audiovizuele në Kosovë, lidhur me terminologjinë e saktë për personat me aftësi të kufizuara, respektivisht parandalimin e përdorimit të terminologjisë së gabuar, në shërbimet mediale audiovizuele.

Ky memorandum synon forcimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve në funksion të ngritjes së vetëdijes së publikut rreth përdorimit të terminologjisë adekuate për personat me aftësi të kufizuara, e veçanërisht nga mediat.

Ndërsa, Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara, do të dërgojnë në KPM ankesa për të gjitha rastet kur mediat bëjnë shkelje në përdorimin e terminologjisë në kundërshtim me broshurën e përgatitur nga OPAK dhe e cila është publikuar nga KPM dhe gjithashtu është përcjell tek mediat.

Pjesëmarrja në tryezën e diskutimit "Media dhe Mbrojtja e Konsumatorit"

Komisioni i Pavarur i Mediave, më 27 korrik 2022, mori pjesë në punëtorinë "Media dhe Mbrojtja e Konsumatorit", të organizuar nga INDEP. Pjesëmarrës ishin gazetarë, media të ndryshme, OJQ, të cilët diskutuan rreth çështjeve që kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorit.

Në këtë tryezë është trajtuar ndikimi i medias në botën e sotme, pasi media është burimi kryesor i informacionit dhe kontribuon drejtpërdrejt në jetën e njerëzve. Pjesëmarrësit konstatuan se pasqyrimi mediatik i temave të caktuara ka kontribuar në një interes shumë më të lartë të publikut dhe ka vënë në qendër të vëmendjes shumë çështje si dhe fokusi i mediave është kryesisht i lidhur me politikën, ndërsa çështjet sociale duke përfshirë edhe mbrojtjen e konsumatorit, trajtohen shumë pak.

Fokusi i diskutimit kishte të bënte me nevojën e ngritjes së kapaciteteve të gazetarëve mbi fushën e të drejtave të konsumatorit dhe nevojën për mbulueshmëri më të madhe të rasteve të shkeljeve ndaj këtyre të fundit. Përpos të tjerash, në këtë tryezë janë diskutuar edhe format se si media mund të mbulojë në mënyrë proaktive çështjet që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit dhe potencialin e mediave për të avancuar tutje me agjendën për mbrojtjen e konsumatorit.

Takimi me gazetarët nga Ukraina të strehuar në Republikën e Kosovës

Në kuadër të bashkëpunimit në mes të KPM-së me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës (AGK), më 2 shtator 2022, në Zyrën e KPM-së është mbajtur një takim me gazetarët nga Ukraina, të strehuar në Republikën e Kosovës. Grupi i gazetarëve u prit nga Kryetari i KPM-së z. Xhevat Latifi, së bashku me zyrtarë të tjerë të Zyrës Ekzekutive.

Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi me gazetarët si dhe shprehja e gatishmërisë së KPM-së për të kontribuar në çfarëdo forme të mundshme në përkrahje të këtyre gazetarëve dhe KPM si institucion është shprehur i gatshëm që çdo herë të ofrojë kontributin institucional me të gjitha kapacitetet, në përkrahje të këtyre gazetarëve.

Në këtë takim janë prezantuar organizimi, funksionimi dhe roli i KPM-së si rregullator i vetëm dhe i pavarur për mediat audio dhe audiovizuale në Republikën e Kosovës. Në pika të shkurta është paraqitur puna dhe aktivitetet e KPM-së, në monitorimin e zbatueshmërisë së legjislacionit nga ana e të licencuarve si dhe veprimet e ndërmarra nga KPM-ja pas fillimit të luftës në Ukrainë, respektivisht vendimit të KPM-së që ka ndaluar transmetimin e kanaleve me origjinë nga Federata e Rusisë, ndërsa tjetër rregullator në Evropë që e ka nxjerrë këtë vendim.

Gjatë takimit, gazetarët nga Ukraina paraqitën përvojat e tyre personale të rrugëtimit drejt Kosovës, sfidat që kanë hasur në raportim përgjatë kësaj periudhe, si dhe ambientimin e tyre në Kosovë. Gazetarët u shprehën se janë të kënaqur me mikpritjen që iu është bërë dhe po iu ofrohet në Kosovë, ku u janë mundësuar të gjitha kushtet si të jetës ashtu edhe të punës dhe janë duke vazhduar të punojnë për mediat ukrainase por edhe të informojnë qytetarët ukrainas me lajme të sakta lidhur me Kosovën.

Në fund të takimit, nga ana e KPM-së është ritheksuar se rregullatori mbetet i përkushtuar në ofrimin e çfarëdo forme të përkrahjes për gazetarët ukrainas dhe mirëpret propozimet e tyre në këtë drejtim.

Pjesëmarrja në seminarin mbi rolin e Institutit për Mjekësi Ligjore në trajtimin e rasteve të sulmeve seksuale dhe dhunës seksuale dhe rëndësinë e raportimit të ndjeshëm në media

KPM ka marrë pjesë në seminarin mbi rolin e Institutit për Mjekësi Ligjore në trajtimin e rasteve të sulmeve seksuale dhe dhunës seksuale dhe rëndësinë e raportimit të ndjeshëm në media, organizuar nga Instituti për Mjekësi Ligjore dhe Misioni i OSBE-së, i cili u mbajt më 26 shtator 2022 në Prishtinë.

Ky organizim kishte si qëllim diskutimin për ndërgjegjësimin e përfaqësuesve të mediave lidhur me konceptet dhe standardet që lidhen me dhunën seksuale dhe sulmin seksual, rolin e Institutit për Mjekësi Ligjore në sistemin e drejtësisë dhe rëndësinë e raportimit të ndjeshëm të mediave në rastet e sulmeve seksuale dhe dhunës seksuale. Pjesëmarrësit në këtë tryezë diskutimi ishin nga fusha e mediave, përfaqësues nga agjencitë e mediave lokale si dhe zyrtarët për media, të cilët prezantuan pikëpamjet e institucioneve që përfaqësonin lidhur me temën e seminarit.

Pjesa e prezantimit të KPM-së ishte tek tema “Roli i medias, institucioneve të medias dhe asociacioneve të gazetarëve në zbatimin e legjislacionit të zbatueshëm, kodeve etike për gazetarë dhe standardeve të raportimit”, ku u diskutua për parimet dhe standardet e rregullimit të mediave bazuar në legjislacionin e KPM-së, duke u fokusuar në parimet e Kodit të Etikës së KPM-së për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale.

Tryeza e diskutimit “Konsumatorët në tregun e telekomunikimeve”

Komisioni i Pavarur i Mediave, më 21 dhjetor 2022, ka marrë pjesë në tryezën e diskutimit ‘Konsumatorët në tregun e telekomunikimeve’, e mbajtur në Prishtinë, në organizim të Institutit për Politika Zhvillimore – INDEP.

Në takim ishin pjesëmarrës përfaqësues nga fusha e komunikimeve elektronike dhe audio-vizuale, rregullatorët e medias dhe telekomunikimit, respektivisht KPM dhe ARKEP, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit në kuadër të MINT, deputetë nga Kuvendi, si dhe pjesëtarë të shoqërisë civile që merren me mbrojtjen e konsumatorit. Pjesëmarrësit në këtë tryezë kanë paraqitur pikëpamjet e tyre lidhur me gjendjen aktuale rreth mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit dhe ankesave të konsumatorit. Duke marrë parasysh se gjatë vitit respektiv ankesat e konsumatorëve për tregun e komunikimeve elektronike janë gjithnjë e në rritje, në një situatë të tillë, u potencua se konsumatorët kërkojnë përgjigje për një numër të konsiderueshëm të shqetësimeve në tregun e shërbimeve audio-vizuale dhe të internetit.

Në terma të përgjithshme, pjesëmarrësit kanë diskutuar për zbatimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit nga ana e institucioneve, Ligjit për Komunikimet Elektronike dhe zbatimin e obligimeve për mbrojtjen e konsumatorit nga ana operatorëve tregtar.

KPM ka prezantuar kornizën ligjore aktuale sa i përket pjesës së mbrojtjes së konsumatorit, ankesat më të shpeshta që KPM ka pranuar gjatë vitit respektiv lidhur me shërbimet mediale audio-vizuale, e të cilat kanë qenë kryesisht për ndryshimet në listën e kanaleve nga ana e operatorëve të shpërndarjes. KPM ka trajtuar të gjitha ankesat sipas procedurave dhe afateve ligjore dhe iu ka kthyer përgjigje palëve ankuese. Në kuadër të licencimit të ofruesve të shërbimeve mediale, padyshim se vend të rëndësishëm kanë edhe konsumatorët e shërbimeve mediale. KPM përmes

kritereve dhe obligimeve të operatorëve të shpërndarjes, ka siguruar në masë të madhe mbrojtjen e konsumatorëve. Operatorët e shpërndarjes janë të obliguar që të ofrojnë shërbime cilësore për konsumatorët dhe t'i njoftojnë konsumatorët për çdo ndryshim që ndodh në listën e kanaleve.

Konkluzioni i përbashkët nga folësit në tryezë ishte se konsumatori i sotëm përballet me një gamë të gjerë shërbimesh audio-vizuele dhe interneti që ofrohen në treg dhe të drejtat e konsumatorëve duhet të respektohen në mënyrë që të sigurohet që shërbimet audio-vizuele dhe shërbimet e internetit të përmbushin pritshmëritë e konsumatorëve dhe të ofrohen në mënyrë të drejtë nga ofruesit e shërbimeve.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE

Takimi rajonal në mes të rregullatorëve të medias lidhur me harmonizimin e Direktivës për Shërbimet Mediale Audiovizuale (AVMSD)

Komisioni i Pavarur i Mediave ka marrë pjesë në takimin rajonal në mes të rregullatorëve të medias lidhur me harmonizimin e Direktivës për Shërbimet Mediale Audiovizuale (AVMSD), takim i cili u mbajt nën organizimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), nga data 20 deri më 23 shkurt 2022, në Shqipëri.

Pjesëmarrës në takim ishin rregullatorët e medias nga Kosova (Komisioni i Pavarur i Mediave), Shqipëria (Autoritetit të Mediave Audiovizive), Mali i Zi (Agjencia për Komunikime Elektronike dhe Shërbimeve Postare), Maqedonia e Veriut (Agjencisë për Komunikime Elektronike) dhe Serbia (Autoriteti Rregullativ i Mediave Elektronike).

Në takim palët kanë diskutuar lidhur me obligimet që dalin nga Direktiva e re AVMSD 2018/1808, respektivisht harmonizimin e legjislacionit të mediave të shteteve pjesëmarrëse me këtë Direktivë si dhe sfidat me të cilat do të përballen rregullatorët gjatë këtij procesi. Gjithashtu, janë diskutuar edhe tema tjera me rëndësi aktuale siç janë koordinimi rajonal lidhur me planet e frekuencave, respektivisht koordinimi në lirim të brezit frekuncor 700 MHz, i njohur si DD2.

Gjithashtu, gjatë këtij organizimi Komisioni i Pavarur i Mediave dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive kanë nënshkruar një deklaratë të përbashkët bashkëpunimi ndërinstitucional, në të cilën janë vendosur objektivat e këtij bashkëpunimi. Palët në takim u dakorduan për mbajtjen e takimeve rajonale në mënyrë periodike si dhe ranë dakord që të vazhdojnë bashkëpunimin me qëllim të arritjes së objektivave të përbashkëta.

Bashkëpunimi me OSBE dhe Zyrën e Këshillit të Evropës

Komisioni i Pavarur i Mediave ka marrë pjesë në një tryezë diskutimi me temë “Eliminimi i portretizimit negativ të grave politike në media për të avancuar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e barabartë në politikë në rajonin e Prizrenit”. Kjo tryezë është organizuar më 29 mars 2022, nga Misioni i OSBE-së dhe Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë. Ky organizim kishte si qëllim eliminimin e portretizimit negativ të grave politike dhe diskutimin rreth rolit kyç të mediave në këtë përpjekje.

Pjesëmarrësit në këtë tryezë diskutimi që ishin nga fusha e mediave dhe e politikës, ndanë përvojat e tyre personale për sfidat me të cilat përballen gratë në politikë dhe në media, si dhe theksuan nevojën për të trajtuar shpifjet dhe diskriminimin me bazë gjinore. Diskutimet përfshinë tema rreth heqjes së pengesave tradicionale që i pengojnë gratë të marrin pjesë plotësisht në çështjet publike dhe politike, si dhe ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut përmes raportimit të medias me ndjeshmëri gjinore.

Në përfundim të tryezës, tetë media lokale kanë nënshkruar një Deklaratë të Përbashkët përmes së cilës zotohen të avancojnë barazinë gjinore dhe të punojnë për të eliminuar portretizimin negativ të grave në media.

Takimi me përfaqësues nga Unioni Evropian i Transmetuesve (EBU)

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 22 prill 2022, ka pritur në një takim pune zyrtaren e Unionit Evropian të Transmetuesve (EBU), znj. Radka Betcheva, dhe përfaqësues nga transmetuesi publik (RTK).

Nga ana e KPM-së është shprehur gatishmëria që të thellohet bashkëpunimi në mes të institucioneve. Pjesëmarrësit në takim diskutuan për disa tema me interes të përbashkët në fushën e mediave, e me theks të veçantë në punën që po bëhet sa i përket procesit të amandamentimit të Ligjit për KPM-në me qëllim të harmonizimit me Direktivën e re AVMS dhe amandamentimit të Ligjit për RTK-në dhe përfundimin e procesit të kalimit në transmetim dixhital. Gjithashtu, në takim u diskutua për vështirësitë financiare me të cilat po ballafaqohet KPM-ja si pasojë e shkurtimeve buxhetore, çështjen e matjes së audiencës së mediave, luftimin e lajmeve të rrejshme sidomos pas situatës në Ukrainë dhe Vendimit të KPM-së për ndalimin e përkohshëm të transmetimit të kanaleve me orgjinë nga Federata Ruse dhe Edukimin Medial.

Znj. Betcheva ka vlerësuar lartë rëndësinë e punës së institucionit të KPM-së si rregullator i mediave dhe shprehu përkushtimin për përkrahje të vazhdueshme në zbatimin e standardeve më të larta në fushën e rregullimit të shërbimeve mediale audio-vizuele. Ndërsa, sa i përket zhvillimeve në fushën e mediave ajo tha se e gjithë bota është duke u sfiduar me mënyra të shumta të keqpërdorimit të lirisë së shprehjes, prandaj është impresionuese puna dhe angazhimi që po vazhdon të bëjë KPM-ja si rregullator.

Pjesëmarrja në takimet vjetore të Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatore (EPRA)

Një delegacion me përfaqësues të Komisionit të Pavarur të Mediave ka marr pjesë në Takimin e 55-të të Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatore (EPRA), ku KPM është anëtar-përfaqësues i Republikës së Kosovës. Ky takim vjetor është organizuar nga Autoriteti Rregullator Flaman për Media (VRM) dhe është mbajtur prej 12 deri më 13 maj 2022, në Antwerp të Belgjikës. Temat që kanë qenë subjekt i diskutimit në mes tjerash, kanë përfshirë çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve, edukimin medial, komunikimet komerciale, lirinë e medias dhe dezinformimin në kohë konfliktesh. Poashtu, në takim janë trajtuar edhe tema tjera lidhur me mediat dhe rregullatorët në mjedisin dixhital, me theks të veçantë platformat e shpërndarjes së videoeve (video sharing platforms).

Në kuadër të takimit të 55-të të EPRA-s, Kryetari i KPM-së, z. Xhevat Latifi, ka takuar Kryetaren e Këshillit Nacional për TV dhe radio transmetim në Ukrainë, znj. Olha Herasymiuk. Gjatë këtij takimi, Kryetari z. Latifi e ka informuar për veprimet e KPM-së sa i përket luftimit të propagandës ndaj përmbytjeve të shpërndara nga kanalet ruse, përkatësisht vendimit të KPM-së për ndalimin e shpërndarjes së kanaleve ruse në Kosovë. Ndërsa, znj. Herasymiuk ka falënderuar për kontributin e Kosovës në ndihmë të popullit të Ukrainës.

Konferenca e Rregullatorëve Evropian ka zhvilluar punimet në sesione punuese, me theks të veçantë tek temat: Qasja e rregullimit dhe mbrojtja e fëmijëve në mjedisin dixhital, me fokus në platformat e shpërndarjes së videove si dhe rrjetet sociale, që ishin disa nga temat e diskutuara në ditën e fundit të takimit të 55-të të EPRA-së.

Përfaqësuesit e rregullatorëve kanë diskutuar dhe shkëmbyer përvojat e tyre edhe sa i përket rregullimit të platformave të reja pas implementimit të direktivës AVMS si dhe aktiviteteve të ndërmarra në këtë drejtim, në radhë të parë me qëllim të mbrojtjes së publikut në përgjithësi, e në veçanti mbrojtjen e fëmijëve nga përmbytjet e papërshtatshme për ta.

Në takim, gjithashtu është diskutuar edhe për sfidat me të cilat ballafaqohen rregullatorët e mediave sa i përket kapaciteteve njerëzore dhe financiare, sidomos pas zgjerimit të kompetencave ndaj shërbimeve të reja, të përcaktuara në Direktivën AVMS.

Gjithashtu një delegacion me përfaqësues të KPM-së ka marrë pjesë edhe në takimin e 56-të vjetor të EPRA-s. Ky takim është organizuar nga Këshilli Suprem i Radios dhe Televizionit të Republikës së Turqisë (RTUK), prej 12 deri më 14 tetor 2022, në Antalya të Turqisë.

Temat që ishin subjekt i diskutimit në mes tjerash, kanë përfshirë çështjet që kanë të bëjnë me dezinformimin, pluralitetin medial dhe besimin në media si dhe punën e autoriteteve rregullatore të medias në një mjedis dixhital, respektivisht si reagojnë dhe lidhen me njëri-tjetrin dezinformimi, pluraliteti dhe besimi. Sesioni kishte synim të ofrojë një analizë të thellë të gjendjes aktuale dhe të ndikimit të saj në konsumin dhe perceptimet e publikut, me synimin për të hartuar zgjidhje dhe ndërhyrje më efektive.

Gjithashtu, janë trajtuar edhe temat tjera lidhur me mediat dhe rregullatorët në mjedisin medial, lidhur me atë se si mund të ndihmojnë rregullatorët në ruajtjen e një mjedisi mediatik pluralist dhe të besueshëm.

Në margjina të takimit të rregullatorëve në EPRA-s, delegacioni i KPM-së ka mbajtur një takim me Kryetarin e rregullatorit turk RTÜK (Këshilli Suprem i Radios dhe Televizionit të Republikës së Turqisë), z. Ebubekir Şahin, dhe Nënkryetarin z. Ibrahim Uslu, si nikoqir të organizimit të takimit të EPRA-së.

Të dy delegacionet kanë pasqyruar gatishmërinë e bashkëpunimit në fusha të ndryshme në mes të rregullatorëve dhe u pajtuan që këto bashkëpunime të marrin një formë më konkrete, përmes renovimit të Memorandumit të Bashkëpunimit KPM-RTÜK.

Delegacioni i KPM-së gjatë pjesëmarrjes në EPRA ka pasur edhe takime të tjera me përfaqësues të rregullatorëve evropian.

Bashkëpunimi me misionin e ODIHR

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 2 qershor 2022, ka pritur në takim një ekip të ekspertëve në kuadër të ODIHR, nga Projekti Ekipi Mbështetës për Reformat Zgjedhore në Ballkanin Perëndimor. Temë diskutimi ishte Raporti i Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, i publikuar në shkurt të vitit 2022, respektivisht gjendja aktuale me zbatimin e rekomandimeve nga ai raport.

Ekipi i projektit të ODIHR-it për Mbështetjen e Reformave Zgjedhore në Ballkanin Perëndimor njoftoi se janë duke kryer disa takime me institucionet e përfshira në raport, me qëllim që të informohen nga aktorët relevant se deri në çfarë faze është arritur të punohet në adresimin e rekomandimeve të raportit dhe cilat janë sfidat e institucioneve në këtë drejtim, me qëllim të mbështetjes së palëve të përfshira në proceset zgjedhore në Kosovë. Gjatë takimit janë diskutuar të gjitha rekomandimet e raportit që lidhen me KPM-në.

Përfaqësuesit e KPM-së në takim i njoftuan ekspertët rreth punës dhe aktiviteteve të KPM-së, në monitorimin e mediave gjatë zgjedhjeve, problemet që janë hasur, shkeljet e ndryshme që kanë bërë mediat dhe hapat ligjor që ka ndjekur KPM-ja për rastet e shkeljeve gjatë zgjedhjeve, kornizën ligjore që e rregullon këtë pjesë si dhe sfidat nga zbatimi i rekomandimeve të raportit.

Vizita e KPM-së dhe AMA-s në SHBA

Prej 3 deri më 12 qershor 2022, një delegacion i përbashkët i dy rregullatorëve të medias, së Kosovës dhe Shqipërisë, përkatësisht Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ka zhvilluar një vizitë pune në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përfaqësuesit e dy autoriteteve rregullatore, kryesuar nga z.Xhevat Latifi dhe nga znj. Armela Krasniqi fillimisht zhvilluan një takim në Departamentin Amerikan të Shtetit, ku u pritën nga z. Martin McDowell, Drejtor i Zyrës për Evropën Qendrore dhe Juglindore.

Dinamika e zhvillimeve në të dy autoritetet rregullatore, si dhe sfidat me të cilat ato përballen, u prezantuan gjatë takimit, ku u vu theksi më shumë tek garantimi i lirisë së medias dhe konkurrencës së ndershme në transmetimet audio/audiovizive, por duke përmendur edhe përpjekjet që bëhen për të evituar fenomenet e ç'rregullimit informativ, më shumë në formën e dezinformimit apo propagandës. Të gjitha përpjekjet bëhen edhe më imperative duke patur parasysh luftën në Ukrainë dhe dezinformimin që është permanent si kërcënim për të gjithë shoqëritë demokratike.

Spektori audiovizual është konsideruar si një hapësirë ku mund të bashkëpunohet me institucionet homologe apo subjekte të SHBA-ve për të ndikuar dhe mbështetur projekte të përmirësimit të cilësisë dhe shumëllojshmërisë së përmbajtjeve të transmetuara, si dhe rritjes së standardeve të rregullimit të operatorëve të licencuar në treg.

Takimi me Federal Communication Commission

Delegacionet e rregullatorëve të Kosovës dhe të Shqipërisë gjatë vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë takuar edhe me përfaqësues të lartë të institucionit homolog amerikan Federal Communication Commission (Komisioni Federal i Komunikimit), znj. Olga Madruga-Forti - Shefe për Strategjitë Globale, Zyra Ndërkombëtare, Ira Keltz - Kryeshefe e Zyrës për Inxhinieri dhe Teknologji, dhe z. Jim Szeliga - Shef i Kujdesit ndaj Klientit.

Në kuadër të vendosjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, shtyllat kryesore do jetë shkëmbimi i eksperiencës. Në këtë kontekst, partnerët e FCC kanë shprehur gatishmërinë për asistencën e tyre në veprimtarinë e mëtejshme të KPM-së dhe AMA-së, nëpërmjet mbështetjes teknike dhe shkëmbimit të praktikave më të mira. Edhe pse KPM dhe AMA u takuan për herë të parë me Komisionin Federal të Komunikimit u vendosën konkretisht tre fusha të nisjes së punës së përbashkët në këto pika:

- Lirimi i brezave frekuencor me fokus të veçantë informimin e shikuesit mbi procesin e lirimit të këtij brezi (Dividenda 2, pasi Dividenda 1 është liruar më herët);
- Procesi i rinovimit të licencave; dhe
- Rregullimi i shërbimeve mediale audiovizuale.

Përfaqësuesit e të trija institucioneve kanë shprehur vullnetin për fillimin e një ndërlidhjeje institucionale dhe vendosjes së afateve kohore të përbashkëta për takimet e radhës.

Takimi me National Press Club në Washington

Delegacionet e Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive të Shqipërisë gjatë qëndrimit të tyre në SHBA, kanë zhvilluar një takim me z. Bill McCarren - Drejtor Ekzekutiv i National Press Club (Klubit Kombëtar të Shtypit) dhe z. Gilbert Klein - President i Institutit të Gazetarisë, ish President i National Press Club. National Press Club është themeluar në vitin 1908 dhe shërben si një organizatë profesionale dhe sociale për gazetarët dhe profesionistët e komunikimit.

Përfaqësuesit e të trija institucioneve kanë diskutuar mbi sfidat me të cilat po përballlet media sot në të gjithë botën dhe vështirësitë e gazetarëve profesionistë për të ushtruar profesionin e tyre në shërbim të publikut pa u ndikuar nga fenomene të ndryshme që po e cenojnë median. Në takim u nda bindja se zhvillimet komplekse në sektorë të ndryshëm të jetës shoqërore kanë shtuar nevojën për rritjen e bashkëpunimit mes institucioneve dhe aktorëve relevantë në këtë fushë. Gjithashtu, u ra dakord që me National Press Club të nisë eksplorimi i mundësive për shkëmbimin e eksperiencave përmes praktikave më të mira dhe mbështetjen e medias mbarë shqiptare me projekte për rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve.

Takimi me përfaqësues nga Japan International Cooperation Agency (JICA)

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 14 qershor 2022, ka pritur në një takim pune një delegacion nga misioni i JICA – Japan International Cooperation Agency, z. Hashimoto Keiichi, z. Takehara Masayoshi dhe z. Xhelal Gashi.

Nga ana e KPM është shprehur falënderimi për angazhimin e JICA-s në Kosovë si dhe gatishmërinë e KPM-së për avancimin e bashkëpunimit me JICA-n. Pjesëmarrësit në takim diskutuan për disa tema me në fushën e mediave, e me theks të veçantë në punën që po bëhet sa i përket amandamentimit të Ligjit për KPM-në me qëllim të harmonizimit me Direktivën e re AVMS, amandamentimit të Ligjit për transmetuesin publik RTK-në, me fokus gjetjen e zgjidhjes lidhur me mënyrën e financimit të transmetuesit publik, e ku qëndrimi i KPM-së për këtë çështje është që pavarësia e transmetuesit publik duhet ruajtur gjithmonë. Diskutimi ka vijuar lidhur me temën për luftimin e lajmeve të rrejshme me theks të veçantë pas situatës në Ukrainë, aktiviteteve të KPM-së në edukimin medial si forma kryesore efektive në luftimin e lajmeve të rrejshme.

Gjithashtu, nga ana e KPM-së u prezantua edhe puna dhe aktivitetet në monitorimin e mediave gjatë zgjedhjeve, problemet që janë hasur, shkeljet e ndryshme që janë bërë nga mediat dhe hapat ligjor që ka ndjekur KPM-ja për rastet e shkeljeve gjatë zgjedhjeve duke u bazuar në kornizën ligjore që e rregullon këtë pjesë.

Ndërsa, nga ana e përfaqësuesve të JICA-s është vlerësuar lartë rëndësia e punës së institucionit të KPM-së si rregullator i mediave dhe kanë shprehur përkushtimin për përkrahje të vazhdueshme në zbatimin e standardeve më të larta në fushën e rregullimit të shërbimeve mediale audio-vizuele.

Vizita studimore në Agjencinë për Media Elektronike të Kroacisë (AEM) dhe Transmetuesin Publik HRT

Në kuadër të programit “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”, iniciativë e bashkëpunimit të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, më 8 dhe 9 qershor 2022, është organizuar një punëtori për përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) me përfaqësuesit e Agjencisë për Media Elektronike (AEM), në Zagreb të Kroacisë.

Gjatë kësaj punëtorie janë diskutuar tema që kanë të bëjnë me pluralizmin dhe diversitetin e mediave, transparencën e pronësisë së mediave, rregullave lidhur me koncentrimin e pronësisë së mediave, parandalimin e monopolit në tregun medial, zhvillimin dhe promovimin e lirisë së shprehjes, aktiviteteve të ndërmarra nga rregullatori sa i përket monitorimit dhe rregullimit të mediave në Kroaci.

Pjesëmarrësit janë informuar se në Kroaci në tetor të vitit 2021 është amendamentuar Ligji i Mediave (Media Act) me qëllim të harmonizimit të tij me Direktivën për Shërbime Mediale Audiovizuale (AVMSD) dhe në proces është hartimi i Ligjit Dixhital, përmes së cilit do të synohet rregullimi i platformave dixhitale në internet, që janë jashtë juridiksionit të BE-së por që për synim kanë publikun kroat. Kjo do të përfshijë në mes tjerash edhe mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet programore, mbrojtjen e veprave evropiane, mbrojtjen e konsumatorit si dhe mënyrën e pagesës së taksës së operimit. Gjithashtu, në këto takime janë diskutuar edhe tema tjera si mbështetja e mediave, edukimi medial dhe promovimi gjinor në media, sfida e mbrojtjes nga lajmet e rreme në mediat online, duke pas parasysh se këto përdoren shumë nga mosha e re e popullsisë dhe implementimi i dispozitave ligjore të Direktivës AVMS.

Gjatë kësaj periudhe, është zhvilluar edhe një vizitë në televizionin publik kroat (HRT). Në HRT, pjesëmarrësit patëm rastin të njihen nga afër me funksionimin e televizionit publik kroat dhe të

informohen rreth punës e aktiviteteve të televizionit publik, përbërjen dhe strukturën e organizimit të tij si dhe në veçanti rreth mënyrës së financimit të HRT-së.

Ndërsa, nga ana e KPM-së është prezantuar baza ligjore aktuale dhe procesi i punës në amandamentimin e legjislacionit me qëllim të harmonizimit me Direktivën AVMS, pastaj aspektet që kanë të bëjnë me rregullimin e mediave përfshirë licencimin dhe monitorimin e mediave si dhe mjedisin e përgjithshëm medial në Kosovë.

Vizita në Dikasterin për Komunikim në Vatikan

Më 23 shtator 2022, Kryetari i KPM-së ka vizituar Dikasterin për Komunikim në Vatikan, respektivisht Radio Vatikanin. Kryetari është prituri në takim nga z. Massimiliano Menichetti, përgjegjës për mediat në Dikasterin e Vatikanit për Komunikim.

Në takim është diskutuar për gjetjen e mënyrave të bashkëpunimit dhe avancimin e raporteve në mes këtyre dy institucioneve. Gjatë takimit, z. Menichetti është shprehur se Vatikani mbetet i hapur ndaj çdo vendi, çdo herë ka krijuar raporte të mira me vendet e ndryshme në fushën e mediave, ku sot transmetojnë në platforma të ndryshme, pothuajse në gjithë botën, në 51 gjuhë të ndryshme, duke përfshirë edhe gjuhën shqipe. Prandaj, sipas z. Menichetti ky takim ishte i një rëndësie të veçantë dhe u theksua që në takimet e radhës do të vazhdohet të flitet për projekte konkrete bashkëpunimi me interes të përbashkët. Gjithashtu, gjatë kësaj vizite është zhvilluar një talim edhe drejtorin e redaksisë në gjuhën shqipe Dom David Gjugja, i cili ka prezantuar historikun 71 vjeçar të emetimit të pa ndërprerë në gjuhën shqipe në Radio Vatikan.

Pjesëmarrja në Konferencën përmbyllëse në kuadër të projektit “Instrumenti Horizontal II”

KPM ka marrë pjesë në Konferencën përmbyllëse në kuadër të Programit “Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë II”, një iniciativë e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Konferenca është organizuar në Budva të Malit të Zi, prej 27 deri më 28 shtator 2022.

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin përfituesit e projektit, partnerët dhe përfaqësuesit nga institucionet publike nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Turqia, të cilët kanë diskutuar rreth rezultateve kryesore të programit në fushën e garantimit të drejtësisë, luftimit të korrupsionit, promovimit të diversitetit dhe barazisë dhe lirisë së shprehjes dhe medias. Temat e shqyrtuara në konferencë ishin: forcimi i sistemit të drejtësisë, lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, mbrojtja nga diskriminimi dhe liria e medias e liria e shprehjes. Konferenca ka vazhduar në sesione të ndara, sipas temave/fushave të përcaktuara në kuadër të këtij programi. KPM ka kontribuar në Sesionin “Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias”, moderuar nga znj. Jutta Gützkow, Shefe e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë.

Në këtë sesion është diskutuar rreth përmirësimit të kushteve dhe mjedisit për ushtrimin e të drejtave themelore dhe lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias dhe rolit aktiv të organizatave të shoqërisë civile në promovimin e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias. KPM ka informuar pjesëmarrësit rreth aktiviteteve të mbështetura në kuadër të këtij programi, si dhe rreth procesit të ndryshimit të Ligjit të KPM-së. Lidhur me këtë, është potencuar nevoja për mbështetje nga programi gjatë procesit të harmonizimit të akteve nënligjore të KPM-së pas ndryshimit të Ligjit, me theks nevojën për mbështetje me ekspertizë ligjore përmes ekspertëve nga BE-ja dhe ngritje të

kapaciteteve njerëzore sa i përket rregullimit dhe implementimit të dispozitave ligjore në lidhje me mediat e reja, me theks platformat e shpërndarjes së videove (video sharing platforms).

Konferenca për Mediat BE - Ballkani Perëndimor 2022

Komisioni i Pavarur i Mediave ka marr pjesë në Konferencën për Mediat BE - Ballkani Perëndimor, organizuar në Tiranë më 10 dhe 11 nëntor 2022.

Në 5 panele diskutimi ishin të ftuar mbi 180 pjesëmarrës, gazetarë dhe aktorë të ndryshëm nga fusha e mediave nga Ballkani Perëndimor dhe Bashkimi Evropian.

Liria e shprehjes dhe liria e mediave konsiderohen elemente esenciale në raport me perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor për shkak se këto janë elemente qenësore të politikës së zgjerimit të BE-së. Konferenca ishte një mundësi e mirë e dialogut me komunitetin e mediave dhe aktorët tjerë relevant për të diskutuar rreth lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave, për të adresuar sfidat me të cilat përballet rajoni si dhe evidentuar mundësitë në arritjen e objektivave për media të pavarura, profesionale dhe të qëndrueshme, të cilat bëjnë raportime kualitative e korrekte.

Në konferencë u potencua nevoja për kujdesin e duhur sidomos në përballje me elemente të dezinformimit, manipulimit të informacionit dhe ndërhyrjeve të jashtme, në veçanti në kontekstin e agresionit të Rusisë në Ukrainë. Fokus i veçantë iu kushtua edhe verifikimit të fakteve, duke ilustruar qasjet dhe praktikatat më të mira.

Gjatë konferencës është diskutuar edhe për ndikimin e mediave online si dhe kompanive të njohura si “big tech companies”. Kompanitë e mëdha janë vetë-rregulluar, ndërsa përmes Aktit të Shërbimeve Dixhitale ato do t’i nënshtrohen rregullimit. Në përgjithësi, u la të nënkuptohet se zgjerimi i rregullimit do të jetë më efektiv në luftën kundër dezinformimit, manipulimit të informacionit dhe ndikimit të jashtëm.

Po ashtu, diskutime kishte edhe për pronësinë e mediave, në kuptimin e kontrollit dhe koncentrimin të mediave ku roli i rregullatorëve është i pazëvendësueshëm.

Konferencës i kishte paraprirë punëtorja për qëndrueshmërinë e mediave, ku gjerësisht u diskutua për sfidat financiare me të cilat ballafaqohen mediat sot si dhe programet e asistencës mediale.

Konferenca u organizua nga Bashkimi Evropian si shprehje e angazhimit për fuqizimin e lirisë së mediave dhe pavarësisë së tyre në nivel rajonal.

Nga ana e KPM-së është theksuar se si institucion mbetet e përkushtuar në angazhimin për krijimin e një ambienti të favorshëm medial, ku kemi pluralizëm medial dhe media profesionale. Brenda kompetencave ligjore, KPM do të ushtrojë mandatin ligjor për të siguruar se kemi raportime të besueshme, të sakta, e që janë të bazuara në fakte, si dhe në përgjithësi media të pavarura e të qëndrueshme.

Takimi Regional i Autoriteteve Kombëtare Rregullative të Mediave

Nga data 9 deri më 11 nëntor 2022, një delegacion i KPM-së ka marr pjesë në Takimin Regional të Autoriteteve Kombëtare Rregullative të Mediave, i cili u mbajt në Shkup nën organizimin e rregullatorit të mediave të Maqedonisë së Veriut AVMU (Agjencia për Shërbimet Mediale Audio dhe Audio-vizuele), në 25 vjetorin e themelimit të kësaj agjencie. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues të autoriteteve rregullatore të mediave nga: Sllovenia, Kroacia, Bullgaria, Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia.

Temat e diskutuara në këtë takim regional ishin: Autoritetet rregullatore të medias në mjedisin e ri të medias – si të sigurohet pavarësia; Procedurat ligjore për emërimin dhe shkarkimin e organeve drejtuese; Pavarësia operative (përfshirë nga Qeveria, Organet Publike dhe Subjektet Private); Burimet dhe kompetencat për një zbatim efikas të detyrave të rregullatorëve si dhe si të përmirësohet bashkëpunimi rajonal.

Në këtë takim dy ditë janë shtjelluar temat e lartcekura, duke u shkëmbyer informacione dhe përvoja lidhur me pavarësinë e autoriteteve rregullatore, mënyrën e emërimit dhe shkarkimit të organeve drejtuese, burimet financimit të rregullatorëve, kompetencat, implementimin e obligimeve që rrjedhin nga Direktiva AVMS si dhe rritja e bashkëpunimit rajonal.

Në konkluzion të takimit, të gjitha delegacionet ishin të pajtimit që të iniciohet organizimi i takimeve të rregullta në mes të rregullatorëve të rajonit, me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së eksperiencave në fushën e rregullimit dhe medias në përgjithësi.

Takimi me Partnerët e Platformës së Këshillit të Evropës për Siguri të Gazetarëve

Më 15 nëntor 2022, përfaqësuesit e KPM-së dhe RTK-së kanë pritur në një takim pune “Partnerët e Platformës së Këshillit të Evropës për Siguri të Gazetarëve”, në përbërje nga: Roberta Taveri - ARTICLE 19, Jamie Wiseman - International Press Institute, Ricardo Gutiérrez - European Federation of Journalists, Attila Mong - Committee to Protect Journalists, Pavol Szalai - Reporters Without Borders, Radka Betcheva - European Broadcasting Union dhe Flutura Kusari - European Centre for Press and Media Freedom.

Pjesëmarrësit në takim kanë shtjelluar disa tema me interes të përbashkët në fushën e mediave, respektivisht gjendjen aktuale në mjedisin medial në Kosovë, monitorimin e mediave, amandamentimin e akteve nënligjore, sfidat rregullatore, çështjen e matjes së audiencës së mediave si dhe luftimin e lajmeve të rrejshme dhe edukimin medial.

Gjithashtu, në takim është diskutuar edhe për punën që po bëhet sa i përket procesit të amandamentimit të Ligjit për KPM-në me qëllim të harmonizimit me Direktivën e re AVMS dhe obligimet e reja ligjore të parapara në këtë Direktivë. Në takim është diskutuar edhe për transmetuesin publik dhe amandamentimin e Ligjit për RTK-në.

Prezantimi i KPM-së në Konferencën Ndërkombëtare të Rregullatorëve të Medias

Me ftesë të Këshillit për Media Elektronike (CEM) të Bullgarisë, Komisioni i Pavarur i Mediave ka marrë pjesë në Konferencën e parë Ndërkombëtare të Rregullatorëve të Medias të vendeve të rajonit të Ballkanit. Konferenca është zhvilluar në Sofje nga data 23 deri më 25 nëntor 2022. Në panelin "Dezinformimi dhe edukimi medial - problemet dhe zgjidhjet", z. Jeton Mehmeti, anëtar i Komisionit të KPM-së, ka folur mbi ndikimin e dezinformatave në besueshmërinë e mediave.

Paneli është moderuar nga Prolet Velkova, anëtare e CEM. Aty u prezantuan edhe projektet e BNT - "MeGra" (Nadia Obretenova) dhe BNR - Factcheck (Nikolai Petrov), që kanë të bëjnë me luftimin e lajmeve të rreme. Prof. Gheorghe Plios, një anëtar i organit rregullator grek dhe Emilia Yanevska nga Maqedonia e Veriut folën gjithashtu për luftimin e dezinformatave dhe përvojën e punës për ngritjen e edukimit medial.

Në panelin "Inteligjenca artificiale në rregullim – avantazhe dhe rreziqe", janë diskutuar mundësitë e luftimit të dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes me ndihmën e teknologjisë, mundësitë e inteligjencës artificiale në luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe aspektet etike.

Në panelin e tretë "Veçoritë rajonale të rregullimit dhe sfidat bashkëkohore" janë diskutuar dy tema veçanërisht të rëndësishme, "Sfidat për rregullatorin e medias në kushtet e një konflikti ushtarak në afërsi të vendit" si dhe "Zbatimi i ndalimit të reklamave të lojërave të fatit" në vendet të cilat e kanë ndaluar këtë aktivitet.

Gjatë forumit, pjesëmarrësit kanë shkëmbyer mendime dhe përvoja të vlefshme dhe konfirmuan gatishmërinë e tyre për të punuar për promovimin dhe konvergjencën e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet vendeve të rajonit të Ballkanit, për temat dhe proceset që lidhen me sfidat ndaj rregullimit të medias, të cilat i përcaktojnë dinamikat dhe proceset moderne.

Pjesëmarrësit u bashkuan rreth idesë për të vazhduar bashkëpunimin e tyre në të ardhmen, ku konferenca në Sofje hapi terrenin për takime të mëtejshme, të rregullta, si një platformë që do të mbështesë shkëmbimin e informacionit, sinjaleve dhe praktikave të mira. Përveç Kosovës, në forum kanë qenë pjesëmarrës/përfaqësues nga Shqipëria, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia Veriore, Rumania, Serbia, Turqia dhe folës të ftuar nga Italia, Katalonia (Spanja) dhe Moldavia.

Bashkëpunimi i KPM-së me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA)

Komisioni i Pavarur i Mediave, më 19-20 dhjetor 2022, ka pritur në një punëtori dy ditore stafin e Autoritetit të Mediave Audiovizive - AMA. Përfaqësuesit e departamenteve përgjegjëse nga KPM dhe AMA kishin rastin që gjatë dy ditëve të punëtorisë të njihen nga afër me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të punës ekipore që kryejnë të dy rregullatorët. E veçanta e kësaj punëtorie ishte se për herë të parë stafi që kryejnë punën në baza ditore, kishin mundësinë që të prezantojnë aktivitetet e tyre që nga niveli edhe teknik e deri te rregullimi ligjor si dhe të shkëmbejnë eksperiencat e tyre dhe pikëpamjet lidhur me zhvillimet e hovshme teknologjike në fushën e mediave, por edhe vështirësitë me të cilat përballen. Pjesëmarrës në punëtori nga KPM ishin përfaqësues nga: Departamenti Ligjor, Departamenti i Licencimit, Departamenti i Monitorimit dhe

Analizave dhe Departamenti i Menaxhimit të Frekuencave. Ndërsa, nga AMA ishin përfaqësues nga: Këshilli i Ankesave, Drejtoria e Programeve dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes.

Fillimisht, pjesëmarrësit kanë prezantuar rolin, strukturën dhe kompetencat e dy autoriteteve rregullatorë të medias, si dhe strukturat dhe kompetencat e secilit departament, përfshirë edhe kapacitetet e tyre teknike dhe humane si dhe aktivitetet e tyre.

Nga Departamenti i Monitorimit dhe Drejtoria e Programeve janë prezantuar aktivitetet e monitorimit dhe metodologjia e punës, aktivitetet gjatë fushatës zgjedhore siç janë monitorimi i përmbajtjes programore – vlerësimi i pajtueshmërisë me Ligjin dhe rregulloret, vizitat tek të licencuarit (kryesisht monitorimi përmes terrenit), pranimi dhe trajtimi i ankesave nga publiku për përmbajtje programore si dhe monitorimi lidhur me pajtueshmërinë me Ligjin për Zgjedhje gjatë periudhës zgjedhore.

Gjithashtu, stafi i AMA-s kishte rastin të vizitonte zyret e monitorimit të mediave në KPM dhe njihet nga afër me funksionimin dhe punën e Departamentit të Monitorimit dhe Analizës dhe të shkëmbejnë praktikat më të mira institucionale sa i përket monitorimit të mediave.

Në ditën e dytë të vizitës studimore u realizua “Dita e monitorimit të punës së stafit të AMA-s” në zyrën e monitorimit të KPM-së.

Sa i përket trajtimit të ankesave, nga Departamenti Ligjor, Këshilli i Ankesave dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes janë prezantuar mënyrat e procedimit të ankesave por edhe rasteve tjera ligjore, respektivisht procedimi Ex officio (sipas detyrës zyrtare). Trajtimi i ankesave kryhet sipas afateve zyrtare dhe afateve ligjore dhe legjislacioni për trajtimin e rasteve ligjore përfshin raste për shkelje të Ligjit të KPM-së, shkelje të akteve nënligjore dhe shkelje të Ligjit për Zgjedhjet. Puna e Departamenteve ligjore përfshin procedimin e rasteve ligjore, dhënien e opinioneve ligjore, përfaqësimin gjyqësor dhe përgatitjen e planit legjislativ të institucionit.

Gjithashtu, është prezantuar edhe funksionimi i Bordit për Ankesa në KPM si dhe procedurat e përmbartimit të vendimeve.

Sa i përket ambientit medial, nga Departamenti i Licencimit dhe Drejtoria e Planifikimit të Frekuencave janë prezantuar të dhënat nga KPM dhe AMA lidhur me: Formulimin e Procedurave dhe Kriteret për dhënien e licencës dhe ripërtëritjen e tyre, Udhëheqjen me Procedurat e licencimit, lëshimin e licencave përmes procedurës së konkursit publik dhe lëshimin e licencave përmes procedurës me anë të kërkesës (pa frekuencë tokësore).

Po ashtu, në punëtori është diskutuar edhe rreth trajtimit të kërkesave të të licencuarve dhe komunikimit me të licencuarit lidhur me kërkesat e tyre të ndryshme si: ndryshime në licencë, ripërtëritje të licencës, ndërprerje të licencës, ankesa për ndërhyrje në frekuencë të transmetimit apo mos pranim të sinjalit dhe çështjet e ndërprerjes së transmetimit. Në fund, u prezantuan të dhënat edhe për numrin e të licencuarve, kategoritë e licencimit, gjuhët e transmetimit dhe shtrirjen gjeografike. Të gjitha të dhënat janë publike në regjistrin e licencave të të licencuarve.

PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE

Në kuadër të KPM-së funksionon Zyra Ekzekutive, si organ i dytë i këtij institucioni të pavarur. Zyra Ekzekutive e cila udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv, e ndihmon Komisionin e KPM-së në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, përcaktohet që Kryeshefi Ekzekutiv:

- menaxhon me nëpunësit civilë të KPM-së;
- menaxhon me financat dhe me burimet tjera të financimit;
- ofron këshilla për politikat e KPM-së;
- siguron zbatimin e vendimeve, politikave dhe masave tjera të KPM-së në mënyrë efektive; dhe
- bën koordinimin e punëve me institucionet tjera.

Në kuadër të Zyrës Ekzekutive operojnë katër (4) departamente për Rregullimin e Transmetimeve Audiovizive dhe Departamenti i Administratës:

- Departamenti i Monitorimit dhe Analizës;
- Departamenti i Licencimit;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti për Menaxhim Frekuencor; dhe
- Departamenti i Administratës.

Burimet njerëzore

Personeli i Zyrës Ekzekutive janë shërbyes civilë dhe janë të miratuara gjithsej 39 pozita deri në vitin 2022. Ngritja e kapaciteteve njerëzore në Zyrën Ekzekutive, proces ky që është filluar gjatë vitit 2018, pritet të arrijë të rrisë edhe efikasitetin në punën dhe përgjegjësitë e KPM-së në kuadër të zgjerimit të fushës së kompetencës dhe trendit në rritje të numrit të të licencuarve.

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS (DMA)

Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA), gjatë vitit 2022, ka vlerësuar pajtueshmërinë e të licencuarve me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe aktet nënligjore të KPM-së. Rekomandimet e këtij Departamenti, pas monitorimeve të bëra dhe realizimit të aktiviteteve të poshtëshënuara, ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera të Zyrës Ekzekutive të KPM-së kanë mbështetur veprimet e mëtutjeshme. Në disa raste ky departament ka monitoruar të licencuarit nga dy herë për të njëjtën çështje, për të vlerësuar nëse i licencuari kishte ardhur në pajtueshmëri pas veprimeve ligjore që ishin ndërmarr nga gjetjet e raporti të parë.

Ndalimi i ritransmetimit të kanaleve me origjinë ruse

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më datë 26.02.2022, ka marrë vendim që të gjithë Operatorët e Shpërndarjes (OSH), të licencuar në Kosovë dhe që ritransmetojnë kanale me origjinë nga Rusia, t'i largojnë ato përkohësisht nga ritransmetimi. Lidhur me zbatimin e këtij vendimi nga ana e OSH-ve, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës ka realizuar monitorimin e të gjithë katalogëve të kanaleve të OSH-ve të licencuara në KPM, për tu siguruar se po zbatohet Vendimi i KPM-së.

Lidhur me këtë, deri më 4 mars 2022, janë monitoruar të gjithë operatorët e shpërndarjes (17) të licencuar nga KPM-ja që operojnë në Kosovë. Në bazë të monitorimit, është vlerësuar se të gjithë operatorët kanë vepruar në pajtim me Vendimin e KPM-së duke hequr nga transmetimi kanalet ruse. Po ashtu, më 25 mars 2022 dhe nga data 11 deri më 20 maj 2022, DMA ka verifikuar pajtueshmërinë e operatorëve të shpërndarjes me Vendimin e KPM-së, dhe në bazë të monitorimit është vlerësuar se OSH-të ishin duke vepruar në pajtueshmëri.

Pajtueshmëria me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë

Në fillim të vitit 2022, ofruesve të shpërndarjes u është kërkuar të deponojnë në KPM katalogët e azhurnuar të kanaleve, marrëveshjet e reja për të drejtat e (ri)transmetimit të këtyre kanaleve dhe përmbajtjeve programore. Nga ky aktivitet janë siguruar të dhëna të përditësuara në lidhje me të drejtat e (ri)transmetimit nga ana e operatorëve të shpërndarjes si dhe oferta e tyre programore për qytetarët.

Gjatë vitit 2022, janë kryer edhe monitorime të ndryshme në terren, në bazë të ankesave dhe ex-officio, lidhur me pajtueshmërinë e operatorëve të shpërndarjes me aktet nënligjore të KPM-së, si dhe rastet e operimeve ilegale pa licencë të KPM-së.

Monitorimet nga data 11 deri më 20 maj 2022 janë realizuar me qëllim të verifikimit të kanaleve të transmetuara nga OSH-të, ritransmetimit të kanaleve me bartje të obligueshme, verifikimin e obligimeve të tyre ndaj përdoruesve në lidhje me ri-programimin e renditjes numerike të kanaleve, grupimit dhe kontrollit prindëror të kanaleve përmes pranuesve të shërbimit.

Raportet e monitorimit lidhur me shkeljet e gjetura të Operatorëve të Shpërndarjes janë proceduar për trajtim të mëtutjeshëm tek Departamenti Ligjor.

Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale

DMA, gjatë vitit 2022, ka realizuar disa aktivitete të monitorimit lidhur me obligimin e OSHMA-ve, për të vepruar në pajtueshmëri me kornizën ligjore të KPM-së, që rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre karshi përmbajtjeve programore që konsiderohen të dëmshme për zhvillimin moral, fizik dhe emocional të fëmijëve. Këto obligime parashihen me: Ligjin Nr. 04/L-44 për KPM-në dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së, përfshirë këtu: Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale, KKPM-2016/03

Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuele.

Lidhur me përmbushjen e këtij synimi janë realizuar këto aktivitete të monitorimit:

1. Në muajin prill janë monitoruar njëzet e një (21) OSHMA me përmbajtje gjeneralistike, prej tyre:
 - gjashtëmbëdhjetë (16) OSHMA me transmetim tokësor: RTK1, TV 21, TV Koha Vision, TV Puls, TV Besa, TV Vali, TV Mir, TV Most, TV Herc, TV Festina, TV Liria, TV Prizreni, TV Dukagjini, TV Syri Vision, TV Mitrovica dhe TV Tema.
 - pesë (5) OSHMA me transmetim përmes OSH-ve: RTK2, Klan Kosova, TE7, Kanal 10 dhe ATV.
2. Në muajin maj janë monitoruar katër (4) OSHMA me përmbajtje tematike (muzikë) që operojnë përmes OSH-ve: ON TV, Zico TV, MTV Kosova dhe First Channel.

Pas marrjes së veprimeve ligjore nga KPM, lidhur me gjetjet nga monitorimet e sipërpërmendura, DMA ka bërë monitorimin e OSHMA-ve të gjetura në shkelje:

3. Në muajin qershor/korrik janë monitoruar pesë (5) OSHMA me përmbajtje gjeneralistike të gjetura në shkelje gjatë muajit prill:
 - tri (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional: TV Koha Vision, TV Vali dhe TV Mir;
 - dy (2) OSHMA me transmetim përmes OSH-ve: Klan Kosova dhe Kanal 10; dhe
4. Në muajin korrik janë monitoruar edhe katër (4) OSHMA me përmbajtje tematike (muzikë) të gjetura në shkelje gjatë muajit maj: ON TV, Zico TV, MTV Kosova dhe First Channel.

Monitorimi ishte fokusuar në vlerësimin dhe analizimin e programeve me përmbajtje të dëmshme, që sipas akteve nënligjore në mes tjerash i referohen programeve që ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mendor dhe moral të fëmijëve, kohën e transmetimit të përmbajtjeve të tilla programore, paralajmërimit dhe përdorimit të shenjave përkatëse të përcaktuara në Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele. Gjithashtu, fokus i monitorimit ka qenë edhe gjuha e përdorur në përmbajtje programore, rastet kur fëmijët apo të miturit kanë qenë të përfshirë apo prezentë në përmbajtje të caktuara programore, përmbajtjet e komunikimeve komerciale audiovizuele në raport me fëmijët dhe të miturit dhe format e komunikimeve komerciale në programet për fëmijë. (Për më shumë detajeve rreth gjetjeve të raportit shih shtojcë numër IV).

Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës

Duke pas parasysh rolin e mediave në përgjithësi, e në veçanti ndikimin e lajmeve në të gjitha aspektet shoqërore në përgjithësi, është realizuar monitorimi i lajmeve qendrore të ofruara nga të licencuarit e KPM-së, me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të përmbajtjeve që ofrohen për qytetarët e Kosovës, në rastet kur transmetoheshin përmbajtje programore, lidhur me ngjarje që janë me interes për publikun dhe që privatësia dhe integriteti i individit duhej respektuar.

Monitorimi i parë është realizuar lidhur me raportimet për rastin e dyshimit për dhunim të një fëmije. Në këtë monitorim janë përfshirë dhjetë (10) OSHMA: RTK1, RTK2, KTV, RTV21, TV DUKAGJINI, KLAN KOSOVA, TE7, ATV, KANAL 10 dhe TëVë1.

Në përgjithësi, janë monitoruar gjithsej 30 kronika të lajmeve qendrore, që kanë trajtuar temën e njëjtë.

Në bazë të monitorimit të realizuar për OSHMA-të e lartcekura, është gjetur se të gjitha kanë raportuar në pajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, respektivisht me objektin dhe fokusin e monitorimit, respektivisht në pajtim me nenin 9, paragrafët 1, 3 dhe 6. Të gjitha OSHMA-të e kanë trajtuar temën në mënyrë objektive, duke ju referuar burimeve të besueshme të informacionit, kryesisht raporteve të policisë, organizatave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe deklarimeve publike të personave që përfaqësojnë institucione përgjegjëse lidhur me temën. Kronikat janë shoqëruar me prezantim të reagimit të shoqërisë civile, nëpërmjet protestave dhe aksioneve që sensibilizojnë vetëdijen shoqërore dhe institucionet përgjegjëse ligj-zbatuese, rreth rasteve të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti. Sipas monitorimit, OSHMA-të kanë respektuar parimet etike dhe kanë trajtuar me maturi e profesionalizëm këtë temë të ndjeshme.

Monitorimi i dytë është realizuar për rastin e dhunës së ushtruar ndaj të moshuarës në Pejë, ku objekt i monitorimi kanë qenë dhjetë (10) OSHMA: RTK1, RTK2, KTV, RTV21, TV DUKAGJINI, KLAN KOSOVA, TE7, ATV, KANAL 10 dhe TëVë1.

Pra, në përgjithësi janë monitoruar dhe analizuar gjithsej dhjetë (10) kronika të lajmeve qendrore, që kanë trajtuar temën e njëjtë.

Në bazë të monitorimit të OSHMA-ve të lartcekura, është gjetur se në përgjithësi OSHMA-të kanë raportuar në pajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, respektivisht nenin 7, paragrafi 1. Të gjitha OSHMA-të e kanë trajtuar temën në mënyrë objektive, duke ju referuar burimeve të besueshme të informacionit, kryesisht raporteve të policisë, organizatave për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe deklarimeve publike të personave që përfaqësojnë institucione përgjegjëse lidhur me temën.

Sipas gjetjeve nga monitorimi, OSHMA-të kanë respektuar parimet etike dhe kanë trajtuar me maturi, profesionalizëm dhe ndjeshmëri këtë temë të ndjeshme dhe komplekse, duke informuar publikun për ngjarjen, por edhe duke mbrojtur privatësinë e të moshuarës. Ato e kanë mbuluar pamjen e fytyrës së të moshuarës dhe nuk kanë treguar emrin dhe mbiemrin e saj, apo të dhëna të tjera që mund ta identifikojnë atë.

Përfundim ka pasur vetëm në TëVë1, ku janë zbuluar informata personale të të moshuarës, përkatësisht është bërë e ditur emri i djalit të saj, si dhe është përmendur diagnoza e sëmundjes së saj. Përmendja e emrit të djalit në mënyrë indirekte mund të zbulojë identitetin e saj, ndërsa përmendja e diagnozës së viktimës konsiderohet e dhënë e ndjeshme personale.

Në përgjithësi është konstatuar se OSHMA-të e monitoruara në edicionet qendrore të lajmeve kanë respektuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës,

nenin 7, paragrafi 1, duke ndërmarr masa për mbrojtje të privatësisë dhe identitetit të të moshuarës, përmes teknikës së turbullimit të pamjes së fytyrës dhe mos zbulimit të të dhënave personale.

Komunikimet Komerciale Audiovizuale

Vlerësimi i pajtueshmërisë me Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuale ka qenë pjesë e aktiviteteve të monitorimit të përmbajtjeve programore të OSHMA-ve lidhur me pajtueshmërinë me aktet nënligjore të KPM-së. DMA ka realizuar monitorimin e dhjetë (10) OSHMA-ve me status të ndryshëm licence, por me përmbajtje programore gjeneralistike, si:

- tre (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional: RTK1, KTV dhe TV21; dhe
- shtatë (7) OSHMA me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes: RTK2, TV DUKAGJINI, KLAN KOSOVA, KANAL 10, ATV, TE7 dhe TËVË1.

Në këto monitorime janë gjetur shkelje në shtatë (7) OSHMA, dhe janë adresuar tutje për veprime të mëtutjeshme ligjore¹. Gjetjet e këtij aktiviteti të monitorimit kanë vënë në pahë se OSHMA-të, janë gjetur në shkelje lidhur me mos paralajmërimin apo ndarjen e komunikimit komercial nga pjesët tjera programore, si dhe kohëzgjatjen e tyre duke tejkuluar kufizimin prej 12 minutave për orë si dhe 20 % të volumit të lejuar prej orës 18:00-24:00. Po ashtu është vërejtuar se disa nga to nuk respektojnë kufizimin e ndërprejes së edicioneve të lajmeve me komunikime komerciale, jo më shumë se një herë kur ato janë më të gjata se 30 minuta. Në disa raste është tejkuluar edhe sasia e lejuar e kohëzgjatjes prej 15 minuta të dritareve të teleshoppingut, si dhe nuk janë dalluar nga pjesët tjera programore me mjete optike edhe akustike. Monitorimet kanë gjatur se edhe vendsoja e produkteve në emisione të caktuar nuk është paralajmëruar, si janë vensosdur produkte në emisione të karakterit informues dhe aktual, kryesisht në debate.

DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2022 ka shqyrtuar raste të ndryshme të Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (tutje OSHMA) dhe Operatorëve të Shpërndarjes (tutje OSH) për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe akteve nënligjore të KPM-së. Departamenti Ligjor gjatë vitit 2022 ka shqyrtuar edhe raste tjera në bazë të ankesave të personave fizik dhe juridik të parashtruara kundër OSHMA-ve dhe OSH-ve.

Rastet e proceduara në bazë të shkeljes së dispozitave ligjore të Ligjit për KPM-në dhe akteve nënligjore të KPM-së² janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

Rastet për transmetim ilegal - Shkelja e nenit 21, paragrafi 1, dhe nenit 30, paragrafi 5, të Ligjit 04/L-44 për KPM-në

¹ Departamenti i Monitorimit dhe Analizës, ka hartuar raportin e plotë të monitorimit, lidhur me gjetjet e këtij aktiviteti të monitorimit. Këtë raport e gjeni të bashkangjitr në shtojcën nr. V.test test

² Shih Shtojcën II "Paraqitja Tabelare e rasteve ligjore"


Gjatë vitit 2022 Departamenti Ligjor ka proceduar katër (4) raste për shkelje të nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në, i cili përcakton se: “Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për transmetim të cilin e lëshon KPM-ja”, dhe nenit 30, paragrafi 5, i Ligjit për KPM-në, i cili përcakton se: “Kushdo që operon pa leje transmetimi valide, i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa.”

Departamenti Ligjor i KPM-së i ka dërguar Njoftim për Shkelje Operatorëve të Shpërndarjes: Niart, Cipko Net, Infinet Netëork dhe personit fizik Betim Abazi, për operim ilegal. Tre prej këtyre operatorëve: Cipko Net, Infinet Netëork dhe personi fizik Betim Abazi kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri për t’u pajisur me licencë të KPM-së. Këto raste janë bartur për vitin 2023.

Rastet e Shkeljes së Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, nenit 28 - Mos sjellja e Raportit vjetor


Departamenti Ligjor gjatë vitit 2022 ka proceduar nëntëdhjetë e shtatë (97) raste për mos sjellje të raportit vjetor. Të gjithë të licencuarve të cilët kanë dështuar të veprojnë në pajtim me nenin 28 të Ligjit për KPM-në u janë dërguar Njoftime për shkelje, si veprim i parë procedural dhe njoftues.

Pas dërgimit të Njoftimit për shkelje nga ana e Departamentit Ligjor, gjashtëdhjetë (60) nga këto OSHMA kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste janë mbyllur. Për tetëmbëdhjetë (18) prej tyre, Komisioni i KPM-së ka marrë Vendim që t’i sanksionojë me Vërejtje, nëntëmbëdhjetë (19) tjera me masë sanksionuese në shumën prej një mijë (1000) dhe dy mijë (2000) euro. Rastet janë mbyllur.



Rastet për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerçiale Audiovizuale

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2022 ka proceduar shtatë (7) raste kundër OSHMA-ve që janë gjetur në shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komeriale Audiovizuale. Të gjitha OSHMA-ve iu është dërguar Njoftim për shkelje, të cilat i kanë pranuar si veprim i parë procedural dhe njoftues. Pas dërgimit të Njoftimit për shkelje nga ana e Departamentit Ligjor të gjitha OSHMA-të kanë ardhur në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur.



Mbrojtja e fëmijëve dhe e të miturve nga përmbajtjet e dëmshme, duke u bazuar në Rregulloren KPM- 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komeriale Audiovizuale dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2022 ka proceduar dhjetë (10) raste kundër OSHMA-ve lidhur me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme, duke u bazuar në Rregulloren KPM- 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale. Këto OSHMA kanë pranuar Njoftimin për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Pas pranimit të Njoftimeve për shkelje, katër (4) prej këtyre OSHMA kanë ardhur në pajtueshmëri, ndërsa për gjashtë (6) prej tyre Komisioni i KPM-së ka marrë Vendim me masë sanksionuese Vërejtje. Rastet janë mbyllur.

Rastet e shkeljes së Ligjit 04/L-44 për KPM-në, shkelja e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës; Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale; Rregullores KPM 2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë.

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2022 ka proceduar shtatë (7) raste kundër OSHMA-ve, prej tyre:

- Gjashtë (6) raste lidhur me shkeljen e Ligjit 04/L-44 për KPM-në, shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Rregullores KPM 2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale audio dhe Audiovizuale, Rregullores KPM 2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë. Lidhur me këto shkelje, Komisioni i KPM-së me datën 19 shtator 2022 ka marrë Vendim për ndërprerje të licencës së tyre.
- Një (1) rast për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, për të cilin është dërguar Njoftim për shkelje. Rasti është mbyllur.

Rastet për zbatimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2022 ka proceduar njëzet e nëntë (29) raste lidhur me zbatimin e këtij Ligji dhe për këtë KPM iu ka dërguar shkresë Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) lidhur me regjistrimin e marrëveshjeve në shoqatën Vapik, ashtu siç përcaktohet me nenin 30.2 të Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Komisioni i KPM-së, me datën 12 prill 2022, ka marrë Vendim që t'i sanksionojë me Vërejtje këta operatorë. Katër nga këta OSH kanë ardhur në pajtueshmëri, ndërsa për njëzet e pesë (25) OSH, Komisioni i KPM-së me datën 10 tetor 2022 ka marrë Vendim që t'i sanksionojë me gjobë në shumën prej një mijë (1.000) euro dhe këto raste barten për vitin 2023 për arsye të mos zbatimit të Ligjit nga ana e OSH-ve lidhur me regjistrimin e marrëveshjeve në shoqatat kolektive.

Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë - Mos pagesa e taksës për licencë dhe gjobat e shqiptuar nga Komisioni i KPM-së

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2022 i ka dërguar në përmbarrim pesëdhjetë (50) Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilat nuk e kanë paguar tarifën për licencë për vitin 2022. Po ashtu, në përmbarrim janë dërguar edhe dhjetë (10) raste për mos pagesë të gjobave të shqiptuara nga Komisioni i KPM-së.

Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2022 ka proceduar gjashtëdhjetë e nëntë (69) raste të shkeljeve dhe ankesave të Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) dhe qytetarëve.

Departamenti Ligjor ka dërguar njëzet e një (21) Njoftime për shkelje OSH-ve që janë gjetur në shkelje për të drejtën e shpërndarjes, bartjen e obligueshme dhe listën e kanaleve, dhe pas Njoftimit për shkelje kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste janë mbyllur. Për tri (3) të tjera, pas Njoftimit për shkelje, Komisioni i KPM-së ka marrë Vendim për sanksionim me Vërejtje, ndërsa për OSH Niart pas Njoftimit, Komisioni ka marrë Vendim për konfiskim të pajisjeve për operim ilegal.

Njëzet e tri (23) raste kanë qenë ankesa të qytetarëve ndaj OSH IPKO, tetë (8) ndaj OSH ARTMOTION dhe një (1) ndaj OSH KUJTESA NET. Këto raste nuk kanë qenë objekt trajtimi

nga ana e KPM-së pasi që kanë pasur të bëjnë me mos përmbushjen e obligimeve kontraktuale në mes të palëve dhe për këtë KPM iu ka kthyer përgjigje në ankesë Palëve ankuese. Rastet janë mbyllur.

Ndërsa, për njëmbëdhjetë (11) ankesa tjera të qytetarëve, pas shqyrtimit dhe analizimit të tyre, KPM ka gjetur se as ato nuk kanë qenë objekt trajtimi nga ana e KPM-së pasi që kanë pasur të bëjnë me mos përmbushjen e obligimeve kontraktuale në mes të palëve; dhe për një (1) rast për OSH Niart, Departamenti Ligjor ka përgatitur rekomandim për Komision, por në mungesë të funksionimit të Komisionit rasti është bartur për vitin 2023.

***Ankesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2022, rastet e shkeljes së Kodit të Etikës
KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës***

Janë proceduar dhjetë (10) raste:


1. Rasti i parë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Afrim Toverlanit ndaj Klan Kosova. Ankesa i referohet emisionit “Info magazina” i transmetuar në Klan Kosova, me pretendimin se në titull të emisionit është theksuar se z. Afrim Toverlani arrestohet pasi kanos me thikë Kryetarin e Prishtinës, z. Shpend Ahmeti. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se Klan Kosova informatat e transmetuara i ka pasur të bazuara në informata zyrtare dhe se Klan Kosova i ka dhënë të drejtën për reagim Palës ankuese dhe për këtë ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 18 janar 2022. Rasti është mbyllur.
2. Rasti i dytë është proceduar bazuar në Ankesën e Pjetër Shalës ndaj RTK 1. Ankesa i referohet spotit politik “Liria ka Emër” të transmetuar në RTK 1, me pretendimin se spoti për z. Shala nuk është transmetuar njëjtë në raport më të burgosurit e tjerë që janë të përfshirë në procesin gjyqësor në Gjykatën Speciale. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e spotit politik “Liria ka Emër” dhe ka gjetur se RTK 1 nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KPM 2016/03. Përgjigje në ankesë Palës ankuese i është kthyer më datën 14 shkurt 2022. Rasti është mbyllur.
3. Rasti i tretë është proceduar bazuar në Ankesën e znj. Venera Lekaj Gjurgaj ndaj Radio Maria. Ankesa i referohet emisionit me titull “Teologji” të transmetuar në Radio Maria. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se Radio Maria ka bërë fushatë kundër vaksinimit që po bëhet, ku një fushatë e tillë është në kundërshtim më çdo parim dhe fushatë që dëmton shëndetin publik. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se Radio Maria ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 1 dhe për këtë i ka dërguar Njoftim për shkelje me datën 28 shkurt 2022. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 1 mars 2022. Rasti është mbyllur.
4. Rasti i katërt është proceduar bazuar në Ankesën e z. Mërgim Teplanit ndaj TE 7, e cila i referohet kronikës “Mungesa e peletit në shkollën Eqrem Çabej” të transmetuar në edicionin qendror të lajmeve. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se TE 7 gjatë

transmetimi të kronikës ka lëshuar një deklaratë se: “Drejtori i shkollës z. Shemsedin Beqiri nuk u deklarua, por nuk lejoi as stafin të flasë mbi këtë problem. Kjo deklaratë nuk është aspak e vërtetë, është kundër etikës së gazetarisë. Ne asnjëherë nuk jemi detyruar nga drejtori i shkollës të mos prononcohemi për këtë medium.”. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se TE 7 ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2 të Kodit të Etikës dhe për këtë i ka dërguar Njoftim për shkelje me datën 10 mars 2022, duke kërkuar që t’i jepet e drejta e reagimit Palës ankuese në afat prej shtatë (7) ditësh. KPM ka gjetur se TE 7 nuk ia ka ofruar të drejtën e reagimit Palës ankuese dhe për këtë Komisioni i KPM-së, më datë 5 prill 2022, ka marrë Vendim që ta sanksionojë me Vërejtje. Rasti është mbyllur.


5. Rasti i pestë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Rabit Murselit ndaj Klan Kosova. Ankesa i referohet emisionit “Kiks Kosova” të transmetuar në Klan Kosova. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se Klan Kosova ka shtrembëruar në mënyrë tendencioze intervistën që ka zhvilluar ekipa e emisionit në fjalë, ku në titullin e kësaj interviste shkruhet: Komandanti i zjarrfikësve në Gjilan fajëson AME-në për shkeljen e konkursit. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin dhe bazuar në Raportin e monitorimit ka gjetur se Klan Kosova ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2 të Kodit të Etikës dhe për këtë i ka dërguar Njoftim për shkelje me datën 13 prill 2022, duke kërkuar që Palës ankuese t’i jepet e drejta e reagimit në afat prej shtatë (7) ditësh. Pas Njoftimit për shkelje, KPM ka gjetur se Klan Kosova ia ka ofruar të drejtën e reagimit Palës ankuese, duke vepruar kështu në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KPM-2016/03. Rasti është mbyllur.
6. Rasti i gjashtë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Valbon Bytyqit ndaj Kanal 10. Ankesa i referohet emisionit “Indoks” të transmetuar në Kanal 10, me pretendimin se me transmetimin e këtij emisioni janë transmetuar lajme të pavërteta, dhe deklarata shpifëse. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se Kanal 10 ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1 të Kodit të Etikës dhe për këtë i ka dërguar Njoftim për shkelje me datën 10 gusht 2022, duke kërkuar që Palës Ankuese t’i jepet e drejta e reagimit në afat prej shtatë (7) ditësh. Pas Njoftimit për shkelje, KPM ka gjetur se Klan Kosova nuk ia ka ofruar të drejtën e reagimit Palës ankuese dhe rasti është proceduar për Komision, por për arsye të mos kompletimit të Komisionit rasti është bartur për vitin 2023.
7. Rasti i shtatë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Fatmir Plakiqi ndaj Kanal 10. Ankesa i referohet emisionit “Indoks” të transmetuar në Kanal 10. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se Kanal 10 nuk ka verifikuar faktet, nuk ka raportuar të vërtetën dhe ka cenuar parimin e paanshmërisë dhe ka shkelur të drejtën individuale. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin dhe ka gjetur se Kanal 10 ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1 të Kodit të Etikës dhe për këtë i ka dërguar Njoftim për shkelje me datën 14 shtator 2022, duke kërkuar që Palës ankuese t’i jepet e drejta e reagimit në afat prej shtatë (7) ditësh. Pas Njoftimit për shkelje, KPM ka gjetur se Klan Kosova ia ka ofruar të drejtën e reagimit Palës ankuese, duke vepruar kështu në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KPM-2016/03. Rasti është mbyllur.

8. Rasti i tetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Veton Berisha ndaj 1st Channel. Ankesa i referohet emisionit “It`s my home” të transmetuar në 1st Channel me pretendimin se në emision është përdorur gjuhë e urrejtjes, duke theksuar se: “Ne si komunitet egjiptian jemi të shqetësuar për gjuhën e përdorur me ç`rast është përdorur termi ofendues “magjup” ku me qëllim të poshtërimit të njëri tjetrit ata me vetëdije na lëndojnë neve si komunitet egjiptian.” KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se 1 st Channel ka kërkuar falje dhe me këtë ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KPM 2016/03. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 3 tetor 2022. Rasti është mbyllur.
9. Rasti i nëntë është proceduar bazuar në Ankesën e znj. Serbeze Haxhiajt ndaj Radio Fontana. Ankesa i referohet programit të mëngjesit të transmetuar në Radio Fontana. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se Radio Fontana ka lejuar që të inkuadrohet në emision një person që është prezantuar si Murlani, i cili është paraqitur si kushëriri i saj, dhe ia ka dëmtuar reputacionin si gazetare. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se Radio Fontana nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KPM 2016/03. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 7 dhjetor 2022. Rasti është mbyllur.
10. Rasti i dhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Viviant Gërgurit ndaj TV Dukagjinit. Ankesa i referohet emisionit “Dueli Sportiv” të transmetuar në TV Dukagjini. Pala ankuese ka bërë Ankesë me pretendimin se TV Dukagjini gjatë transmetimit të këtij emisioni ka përdorur gjuhë raciste nga një trajner futbollit, që ka ushtruar rolin e panelistit të përhershëm në emision. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin dhe ka gjetur se TV Dukagjini ka kërkuar falje për gjuhën e përdorur në emision, duke vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KPM 2016/03. Palës ankuese i është kthyer përgjigje në ankesë më datën 5 dhjetor 2022. Rasti është mbyllur.

Rastet e ankesave lidhur me shkeljet e Kodit të Etikës



Vendimet të cilat i ka marrë Komisioni i KPM-së gjatë vitit 2022 si raste të paraqitura nga Departamenti Ligjor janë gjithsej 124, prej të cilave 44 me gjobë, 73 me vërejtje, 6 vendime për revokim të licencës dhe 1 vendim konfiskim të pajisjeve.



DEPARTAMENTI I LICENCIMIT

Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës


Departamenti i Licencimit është përgjegjës për shqyrtimin dhe procedimin e kërkesave për licenca të reja për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale dhe operatorë të shpërndarjes, përfshirë edhe shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndryshime të kushteve të licencës së KPM-së si dhe atyre për ripërtëritje të licencës. Gjithashtu, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për mbajtjen dhe mirëmbajtjen e një regjistri për të gjithë të licencuarit e KPM-së i cili, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për KPM-në, është në dispozicion të publikut përmes ueb faqes së KPM-së.

Numri i Ofrueseve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (OSHMA) të licencuar për transmetim tokësor të programeve - ndarja e tyre sipas gjuhës së transmetimit dhe mbulueshmërisë

Në Kosovë, operojnë gjithsej 19 Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (TV) me transmetim tokësor.

Sipas gjuhës së transmetimit ato ndahen në:


- 1 televizion publik, përveç në gjuhën shqipe transmeton edhe në gjuhë të komuniteteve;
- 13 televizione në gjuhën shqipe;
- 5 televizione në gjuhën serbe.



Ndërsa, sipas mbulueshmërisë, kemi:

- 3 televizione me mbulim tokësor nacional;
- 11 televizione me mbulim tokësor regjional; dhe


- 5 televizione me mbulim tokësor lokal.



Ndërsa, sa i përket ofruesve të shërbimeve mediale audio (radio), të licencuar janë 89 radio me transmetim tokësor.


Sipas gjuhës së transmetimit, ato ndahen në:

- 2 radio të transmetuesit publik, përveç në gjuhën shqipe ato transmetojnë edhe në gjuhë të komuniteteve;
- 57 radio në gjuhën shqipe;
- 22 radio në gjuhën serbe;
- 3 radio në gjuhën boshnjake;
- 1 radio në gjuhën turke;
- 2 radio në gjuhën gorane;
- 1 radio në gjuhën rome; dhe
- 1 radio multietnike.



Ndërsa, sa i përket mbulueshmërisë, ato kategorizohen në:

- 4 radio me transmetim tokësor nacional;
- 22 radio me transmetim tokësor regional;
- 60 radio me transmetim tokësor lokal; dhe
- 3 radio me fuqi të ulët të transmetimit.




Numri i Ofrueseve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA) të licencuara për transmetim të programeve përmes Operatorëve të Shpërndarjes - ndarja e tyre sipas gjuhës së transmetimit:

Të licencuar janë gjithsej 108 televizione me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, prej tyre:

- 100 televizione transmetojnë program në gjuhën shqipe;
- 5 televizione transmetojnë program në gjuhën serbe; dhe
- 3 televizione transmetojnë program në kuadër të transmetuesit publik RTK (RTK 2; RTK News dhe RTK Art), prej tyre një transmeton në gjuhë të komuniteteve (RTK2).

Televizionet me transmetim përmes operatorëve



■ TV në gjuhën shqipe


■ TV në gjuhën serbe

■ TV të transmetuesit publik

Ndarja e televizioneve përmes operatorëve sipas llojit të programeve

- 31 televizione përmes operatorëve me përmbajtje gjeneralistike;
- 3 televizione përmes operatorëve me përmbajtje – lajme;
- 1 televizion përmes operatorëve me përmbajtje - kulturë;
- 6 televizione përmes operatorëve me përmbajtje për fëmijë;
- 6 televizione përmes operatorëve me përmbajtje – dokumentarë
- 12 televizione përmes operatorëve me përmbajtje - sport;
- 23 televizione përmes operatorëve me përmbajtje – muzikë;
- 20 televizione përmes operatorëve me përmbajtje – filam;
- 2 televizione përmes operatorëve me përmbajtje –komercial;
- 4 televizione përmes operatorëve me përmbajtje – Reality Show.

Televizionet permes operatorëve sipas llojit të programit




Numri i Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) të licencuar - ndarja e tyre sipas pronësisë:

Të licencuar janë gjithsej 38 operatorë të shpërndarjes, prej tyre:

- 30 operatorë të shpërndarjes me pronarë shqiptar;
- 6 operatorë të shpërndarjes me pronarë serb; dhe
- 2 operatorë të shpërndarjes me pronarë boshnjak/goran.


Operatorët e shpërndarjes sipas pronësisë



Numri dhe llojet e kërkesave/rasteve të proceduara

Gjatë vitit 2022, Departamenti i Licencimit ka regjistruar 92 raste për shqyrtim, prej tyre:

- 5 kërkesa për licencë të radios;
- 6 kërkesa për licencë të televizioneve me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes;
- 4 kërkesa për licencë të operatorëve të shpërndarjes;
- 12 kërkesa për ripërtëritje të licencës;
- 4 njoftime për heqje dorë vullnetare nga licenca;
- 6 kërkesa për ndryshim të pronësisë;
- 1 kërkesë për ndryshim të skemës programore;
- 1 kërkesë për ndryshim të emrit (*për 11 kanalet e një personi juridik të parashtruara me anë të një kërkesë*);
- 1 kërkesë për ndryshim të kategorisë së licencës;
- 1 kërkesë për ndryshim të lokacionit të transmetuesit;
- 1 ankesë për ndërhyrje në frekuencë të transmetimit;
- 32 raste të ndërprerjes së transmetimit (*ndërprerjet e transmetimeve në numër kaq të lartë kryesisht kanë ndodhur gjatë kohës së pandemisë Covid -19*);
- 18 raste të kërkesës së KPM-së për fillimin e transmetimit të televizioneve përmes operatorëve të shpërndarjes (*pasi që këto televizione pas marrjes së licencës nuk kanë pasur të caktuar afatin e fillimit të transmetimit me kushtet e licencës së tyre, me ndryshimin e Rregullores KPM-2021/01 është përcaktuar afati i fillimit brenda 6 muajsh nga marrja e vendimit për licencim, ndërsa ato që kanë qenë të pajisura me licencë dhe nuk kanë qenë duke transmetuar program, me rregulloren në fjalë iu është caktuar afati prej 90 ditësh për fillimin e transmetimit*).



Shpallja e konkurseve publike për frekuenca të reja të radios

Pas vendimit të KPM-së, të datës 30 maj 2022, për shpalljen e konkursit publik për një frekuencë të radios në gjuhën boshnjake për lokacionin Vitomiricë, Komuna e Pejës, është shpallur konkursi për aplikim për licencë, i cili ka qenë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit të tij në ueb faqen e KPM-së, nga data 16 qershor 2022 deri 16 korrik 2022, ashtu siç parashihet me Ligjin për KPM-në.

Pas mbylljes së konkursit, me Vendim të KPM-së është caktuar Komisioni vlerësues i cili ka bërë vlerësimin e aplikacioneve të pranuar. Gjatë afatit të konkursit është pranuar vetëm një aplikacion dhe në bazë të vlerësimit, kandidati ka pasur mungesa të shumta në dokumentacion dhe nuk i ka plotësuar kushtet për licencim, të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.


Gjithashtu, me datën 19 shtator 2022, Komisioni ka marrë vendim për shpalljen e konkursit publik për një frekuencë të radios në gjuhën turke në Komunën e Prizrenit dhe për një frekuencë të radios në gjuhën boshnjake për lokacionin Vitomiricë, Komuna e Pejës. Konkursi për aplikim për licencë ka qenë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit të tij në ueb faqen e KPM-së, ashtu siç parashihet me Ligjin për KPM-në. Aplikacionet për licencë të pranuar në këtë konkurs nuk janë vlerësuar për arsye të mungesës së kuorumit për vendimmarrje të KPM-së.

Vendimet e KPM-së lidhur me rastet e licencimit

Në përgjithësi, gjatë vitit 2022, lidhur me rastet e licencimit KPM ka marrë këto vendime:

- 2 vendime për shpalljen e konkursit publik për frekuenca të lira të radios;
- 1 vendim për themelimin e Komisionit për Vlerësimin e aplikacioneve për licencë;
- 5 vendime për licencimin e OSHMA-ve të cilat transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes;

- 3 vendime për licencimin e Operatorëve të Shpërndarjes (OSH);
- 7 vendime për ripërtëritje të licencës;
- 1 vendime për ndërprerje të licencës si rezultat i heqjes dorë në mënyrë vullnetare nga licenca e KPM-së, për 5 kanale të OSHMA-ve me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes;
- 2 vendime për ndërprerje të licencës si rezultat i heqjes dorë në mënyrë vullnetare nga licenca e KPM-së për operator të shpërndarjes;
- 3 vendime për ndryshim të pronësisë (*me një (1) nga vendimet, përveç pronësisë është ndryshuar edhe emri dhe skema programore e të licencuarit*);
- 1 vendim për ndryshimin e lokacionit të transmetuesit;
- 11 vendime për ndryshimin e emrit të të licencuarve (*këto vendime janë për kanalet e një personi juridik dhe të parashtruara me anë të një kërkesë*);




Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2023

Për vitin 2023, janë bartur për shqyrtim gjithsej 50 raste, nga këto:

- 1 kërkesë për licencë për OSHMA (TV) me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes;
- 1 kërkesë për licencë për operator të shpërndarjes;
- 5 kërkesa për ripërtëritje të licencës;
- 1 njoftim për heqje dorë vullnetare nga licenca;
- 4 kërkesa për ndryshim të pronësisë;
- 1 kërkesë për ndryshim të skemës programore;
- 1 kërkesë për ndryshim të kategorisë së licencës;
- 1 kërkesë për ndryshim të lokacionit të transmetuesit;
- 1 ankesë për ndërhyrje në frekuencë të transmetimit;
- 28 raste të ndërprerjes së transmetimit; dhe

- 6 raste të kërkesës së KPM për fillimin e transmetimit të televizioneve përmes operatorëve të shpërndarjes.



Rastet janë bartur për trajtim në vitin 2023, për shkak që pas shqyrtimit të tyre është vlerësuar nevoja për plotësime të rasteve me dokumentacion nga ana e palëve apo veprime tjera procedurale nga KPM. Lidhur me rastet e mos transmetimit të televizioneve tokësore, lokale dhe regjionale, pas një kërkesë të dorëzuar nga AMPEK për zgjatjen e afatit për ri-fillimin e transmetimit, KPM ka marr vendim që këtyre televizioneve të ju japë një afat shtesë për ri-fillimin e transmetimit deri më datën 30 shtator 2022.

Rastet të cilat janë mbyllur pas Shkresave të KPM-së


Pas shkresave të KPM-së, 11 raste janë mbyllur për shkak që të licencuarit kanë ardh në pajtueshmëri me kushtet dhe termet e licencës.

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2022, Departamenti i Licencimit ka kërkuar nga të gjithë të licencuarit që të ofrojnë informacione të plota lidhur me të dhënat rreth informatave kontaktuese (adresa, telefoni, email), menaxhmentit dhe pronësinë. Në këtë mënyrë është arritur që të azhurnohen regjistrat për Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audivizuele si dhe Operator të Shpërndarjes.

Krahasimi i gjendjes së të licencuarve të cilët kanë operuar në vitin 2021 me vitin 2022

- Gjatë vitit 2021 dhe 2022 kanë operuar 108 ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuele me transmetim tokësor (19 TV dhe 89 Radio).

- Gjatë vitit 2021 kanë operuar 115 ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes (TV), ndërsa në vitin 2022 kanë operuar 108.
- Gjatë vitit 2021 kanë operuar 36 operator të shpërndarjes, ndërsa në vitin 2022 kanë operuar 38 operator të shpërndarjes.



DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR

Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge

Gjatë vitit 2022 janë bërë matje dhe monitorime në terren të sinjaleve radiove dhe televizioneve me mbulim tokësor nacional, regional dhe lokal në tërë territorin e Republikës së Kosovës, për të inçizuar gjendjen e transmetimeve radio televizive tokësore në brezet frekuencore (radio FM VHF/III dhe TV VHF/III; TV UHF/IV/V) me qëllim vlerësimi, analizimi respektivisht konstatimi të:

- Transmetimeve radio televizive tokësore analoge me mbulim nacional të subjekteve të licensuara, gjegjësisht evidentimin e zonave të pambuluara me sinjal radioteleviziv.
- Transmetimeve radio televizive tokësore analoge me mbulim regional/lokal të subjekteve të licensuara.
- Evidentimit të interferencave në brezin frekuencor radiodifuziv dhe evidentimit të frekuencave të lira për radio transmetime në territorin e Republikës së Kosovës.
- Prezencës së sinjaleve radio televizive tokësore digjitale, gjegjësisht evidentimit të prezencës së sinjaleve nga shtetet fqinjë.
- Monitorimit të frekuencave radio FM që shfrytëzohen nga KFOR-i, UNMIK-u dhe radio stacionet e huaja ndërkombëtare për nevojat e tyre.

- Monitorimit të radio televizioneve nacionale, regjionale e lokale me qëllim të verifikimit të pajtueshmërisë së zonës së tyre të mbulimit me pjesën e dytë dhe të katërt të Licencës.

Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, TV21)

Nga matjet dhe analizat e bëra në terren, vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV të subjekteve transmetuese nacionale është e një kualiteti shumë të mirë (65 dBuV/m për TV) dhe e pa interferuar për ato lokacione që i mbulojnë, dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë e të katërt të licencës. Megjithatë, duhet të theksohet se nga raportet e mëhershme, mbulimi i tërësishëm i territorit të Republikës së Kosovës nuk është i kënaqshëm. Aktualisht, territori i Republikës së Kosovës mbulohet vetëm 62,7% me sinjal televiziv. Regjione të tëra si: Dragashi, Kaçaniku, Zhupa, Kamenica, Klina, Artana, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi kanë mbetur në tërësi apo pjesërisht jashtë zonës së mbulimit me sinjal televiziv për shkak të problemit të vazhdueshëm të mos aktivizimit të pikës së lartë të Goleshit, për transmetim primar televiziv si dhe mos aktivizimit të rrjetit sekondar (rrjeti i përsëritësve televiziv). Në këtë kontekst, KPM-ja në vazhdimësi ka informuar organet më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, për rëndësinë e aktivizimit të kësaj pike për transmetim televiziv.

Pika e lartë e Goleshit përdoret vetëm nga KFOR-i për transmetime radio FM. Për të siguruar mbulueshmëri më të gjerë me sinjal televiziv është shumë e rëndësishme që kjo pikë të aktivizohet edhe për subjektet transmetuese televizive.

Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU, respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që nga Stokholm 61, Gjeneva 84, 89 dhe e fundit Gjeneva 2006, si pikë kryesore e transmetimit për Kosovën. Për këtë arsye janë të rezervuara dhe të pranuar ndërkombëtarisht kanale transmetimi radio e televizive me fuqi të mëdha rrezatimi nga kjo pikë. Me aktivizimin e kësaj pike të lartë të Goleshit për transmetim televiziv, do të rritej zona e mbulimit nga 62.7% (me nivel të sinjalit të kënaqshëm prej 60 dBuV/m) në 80% të territorit të Kosovës dhe do të mundësohej zhvillimi i rrjetit sekondar, ashtu që do të arrihej që mbi 90% e territorit të Kosovës të mbulohet me sinjal televiziv kualitativ.

Të dhënat nga kontrollet dhe matjet dëshmojnë se shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Kosovës vazhdon të mbetet përafërsisht i njëjtë në krahasim me situatën në vitin 2021.

Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)

Gjatë vitit 2022, Departamenti për Menaxhim Frekuencor (DMF) ka bërë matjet në kuadër të përcaktimit të objektivave të KPM-së për vitin 2022, të cilat kanë pasur për qëllim sigurimin e mbulueshmërisë së zonave të veçanta gjeografike të territorit të Republikës së Kosovës (me theks të veçantë rrugët magjistrale dhe regjionale), me sinjal kualitativ të të licencuarve me mbulim nacional në radio në brezin frekuencor VHF/FM (87.5 - 108 MHz).

DMF-ja gjatë matjeve të bëra në terren ka vërtetuar gjendjen e njëjtë si dhe gjatë vitit paraprak që tregon se, në disa zona të caktuara, Radio Kosova 1, Radio Kosova 2 dhe Radio 21 nuk ofrojnë mbulim të mirë, ndërsa niveli i sinjalit të mbulueshmërisë është nën nivelin e duhur të 54 dbuv/m për këto zona. Matjet teknike janë bërë në disa rrugë magjistrale si: Prishtinë-Gjilan (Slivovë, Llabjan, Parillovë dhe Bresalc); Kaçanik–Hani i Elezit; Mitrovicë–Bajgorë; Shtime–Carralevë, Dragash–Restelicë; Prizren–Brezovicë; Kramovik–Dollc; Pejë–Rugovë; Kamenicë, dhe është vërejtur se në këto zona nuk ka pranim stereo (nën 46dbuv/m mono) të sinjalit të radiove nacionale.

KPM do të sigurojë frekuenca shtesë me qëllim të mbulimit të zonave ku nuk ka fare sinjal, ndërsa në bashkëpunim me ta, duhet të gjenden lokacionet e përshtatshme për pika të transmetimit.

Mbulimi me sinjal radio televiziv në nivel regjional dhe lokal

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese është e një kualiteti shumë të mirë (60 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM Stereo radio transmetime) dhe e pa interferuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë dhe të katërt të licencës.

Televizionet regjionale – lokale, sipas licencave të tyre, mbulojnë rreth **68.14%** (të gjitha së bashku) të territorit të Kosovës me sinjal televiziv, ndërsa radiot lokale/regjionale mbulojnë rreth **96.98%** të territorit të Kosovës (të gjitha së bashku).

Rastet për interferencë

Gjatë vitit 2022, DMF nuk ka pranuar ankesa për interferencë nga subjektet transmetuese (radio dhe TV), që vërteton se spektri frekuencor (TV dhe radio) është i sinkronizuar dhe i pa interferuar.

Rastet për transmetime të pa licencuara

DMF, gjatë vitit 2022, nuk ka hasur në pranim të ndonjë sinjali FM TV i cili është i pa licencuar nga ana e KPM-së.

Frekuencat e revokuara nga KPM

DMF, gjatë vitit 2022, nuk ka proceduar me asnjë rast për të cilën është dashur të revokohet ndonjë frekuencë (licencë).

Monitorimet e radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR

DMF, gjatë vitit 2022, ka bërë monitorime të frekuencave radio që janë në shfrytëzim të KFOR-it, UNMIK-ut dhe radiostacioneve të huaja ndërkombëtare me qëllim të azhurnimit të bazës së të dhënave që posedon KPM-ja.

Gjatë vitit 2022, radiot e huaja ndërkombëtare si BBC, VOA dhe RFI vazhdojnë transmetimet e tyre.

Frekuencat për transmetime radio FM që i përdor KFOR-i, UNMIK-u dhe radiostacionet e huaja ndërkombëtare, nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë.

Gjatë vitit respektiv, ka pasur bashkëpunim në mes KPM-së dhe KFOR për të siguruar pikën e lartë të Goleshit si zonë transmetuese e lirë dhe opsionet për të arritur këtë mbesin të trajtohen përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit në mes institucioneve relevante dhe KFOR-it.

Gjatë vitit 2022, KPM ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me KFOR-in sa i përket aspektit të frekuencave FM, të cilat i shfrytëzon për Radio KFOR.

Kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit

Gjatë vitit 2022, DMF ka pranuar kërkesë për ndryshim të kategorisë (nga lokal në regjional) nga Radio 10 në Rahovec, ku pas matjeve në terren dhe analizave është konstatuar se ndërrimi i

lokacionit nuk paraqet ndonjë pengesë në interferim të radiove të licencuara nga KPM, dhe me rekomandim të Departamentit të Licencimit, kjo kërkesë është aprovuar nga Komisioni.

Raste të ndryshimit të lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së

Gjatë vitit 2022, DMF nuk ka proceduar me ndonjë rast të ndryshimit të pikës së transmetimit pa miratimin e KPM-së.

Subjektet transmetuese të cilat kanë ndërprerë transmetimin tokësor ose kanë zvogëluar zonën e mbulueshmërisë

Gjatë vitit 2022, një numër shumë i madh i TV me mbulim regjional kanë pasur ndërprerje të transmetimit tokësor. Nga matjet në terren është konstatuar se TV Besa, TV Opinioni, TV Prizreni, TV Festina, TV Liria, TV Syri Vision, TV Dukagjini, TV Zoom dhe TV Mitrovica gjatë vitit 2022 kanë pasur ndërprerje të vazhdueshme të transmetimeve tokësore (pa e infromuar KPM-në).

Ndërsa, me probleme më të vogla në transmetim tokësor kanë qenë TV Herc, TV Most dhe TV Mir. Duhet të theksohet se të gjitha këto TV transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (ndërsa transmetimin tokësor e kanë ndërprerë).

Po ashtu, matje janë bërë edhe për sinjalin FM radio ku është konstatuar se: Radio Bubamara, Radio Hayat, Radio Kent FM (Mamushë), Radio Bambus, Radio Kllokot, Radio Bravo, Radio Borzani, Radio Herc, Radio Kaçaniku, Radio Antena, Radio Dodona dhe Radio Gora nuk kanë respektuar licencën e KPM-së, pra kanë bërë ndërprerjen e transmetimit pa e njoftuar KPM-në.

Të gjitha rastet janë përcjellë te Departamenti i Licencimit për trajtim.

Kërkesa për frekuencë shtesë dhe frekuenca të reja

Gjatë vitit 2022, Komisioni i KPM-së ka marrë vendim për shpalljen e dy (2) frekuencave të lira. DMF pas matjeve në terren dhe analizave ka siguruar frekuenca të lira dhe të pa interferuara: një frekuencë të radios në gjuhën turke në Komunën e Prizrenit, dhe një frekuencë të radios në gjuhën boshnjake për lokacionin Vitomiricë, Komuna e Pejës. Gjithashtu, DMF ka bërë matje në tërë territorin e Republikës së Kosovës lidhur me gjetjen dhe përditësimin e frekuencave të lira Radio FM dhe TV në mënyrë të vazhdueshme.

Plani frekuencor dhe dixhitalizimi

KPM gjatë vitit 2022 ka miratuar Planin e Frekuencave në brezin e transmetimeve në vlerësim të së drejtës së saj për qasje të barabartë me shtetet fqinje në resurset frekuencore. Shtetet e rajonit kishin lëvizur para me marrëveshje të ndryshme rajonale për koordinim të frekuencave dhe në një situatë të tillë Kosova ishte vënë në një pozitë jo të barabartë. Miratimi i Planit Frekuencor për Kosovën në brezin UHF synon të mbrojë të drejtën sovranë sipas parimit të qasjes së barabartë në spektër. Ky plan u është dërguar shteteve fqinje për koordinim frekuencor dhe deri më tash Mali i Zi është përgjigjur pozitivisht për 6 frekuenca. Proceset e koordinimeve frekuencore janë mjaft komplekse dhe marrin kohë, por është e rëndësishme të respektohen parimet e ITU për qasje të barabartë në spektrin frekuencor. Kosova nuk ka obligime ndaj marrëveshjeve që tjerët kanë bërë apo bëjnë, përdërisa mbetet e hapur dhe e përkushtuar të përfshihet në marrëveshjet bilaterale me shtetet fqinje si dhe në iniciativat tjera rajonale në respektim të parimit të qasjes së barabartë në spektrin frekuencor dhe përdorimit të papenguar e efikas të resurseve frekuencore.

Në vazhden e këtyre angazhimeve, KPM ka marr pjesë në punëtorinë me temën “UHF and VHF band utilization, regulators challenges, future considerations regarding frequency coordination issues”, me ftesë të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) të Shqipërisë, ku ishin të ftuar edhe shtetet e rajonit përfshirë shtetet që gravitojnë detin Adriatik dhe atë Jon (Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut). Temë kryesore ishte koordinimi frekuencor TV, e që në këtë takim Kosova ishte vendi i vetëm që nuk ka filluar transmetimin dixhital.

KPM do të bashkëpunojë me shtetet e rajonit edhe për brezin VHF dhe ka kërkuar që të jetë prezente në nismat rajonale për këtë qëllim.

Sa i përket procesit të dixhitalizimit të transmetimeve tokësore, KPM është e mendimit se Ligji për Dixhitalizim duhet në amendamentohet ose të përfshihen nënë të caktuara gjatë draftimit të Ligjit për KPM, ashtu që televizionit publik t’i ndahen frekuenca sipas nevojës, ndërsa frekuencat tjera t’i nënshtrohen garës fer, sipas së cilës forcat e tregut përcaktojnë se kush fiton të drejtën e shfrytëzimit të frekuencës sipas kushteve të përcaktuara nga KPM.

Gjendja për prezencën e sinjaleve televizive tokësore dixhitale, gjegjësisht evidentimi i prezencës së sinjaleve nga shtetet fqinjë:

Nga matjet në terren është regjistruar një numër i caktuar i sinjaleve televizive dixhitale që vijnë nga territori i vendeve fqinje, Serbia dhe Maqedonia, ngjashëm me vitin 2021.

Vlen të theksohet se Serbia nuk është duke e respektuar Marrëveshjen e Telekomunikacionit të nënshkruar në Bruksel nga Kryeministrat e të dyja vendeve, sipas së cilës asnjëra palë nuk duhet të mbulojë me qëllim kufirin që ndan dy vendet me sinjal dixhital televiziv.

Matjet e bëra kanë përfshirë tërë territorin e Kosovës me theks të veçantë pikat nacionale të transmetimeve radio televizive tokësore analoge si dhe lokacionet afër kufirit me shtetet fqinje.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

Buxheti

Buxheti për KPM është aprovuar në mbështetje të Ligjit nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Ligji është shpall në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / Nr. 13 / 31 Dhjetor 2021.

Ndryshimet e Buxhetit fillestar ndaj Buxhetit final janë aprovuar sipas kërkesës së KPM-së. Në tre mujorin e fundit kemi kërkuar nga MFPT-Departamenti i Buxhetit, që të aprovohet kërkesa për transfer të mjeteve në vlerë prej 47,054.29 €, nga kategoria e Pagave dhe Shtesave në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve.

Transferi i mjeteve nga KPM, nga kategoria e shpenzimeve paga dhe shtesa në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbimeve wshtw bwrw për pagesën e faturave të papaguara dhe obligimeve kontraktuale të mbetura për muajin Tetor dhe Nëntor 2022, në mënyrë që të mos barten në vitin tjetër fiskal.

Transferi i mjeteve të lira është aprovuar nga Departamenti i Buxhetit, duke u bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048 nenit 30.2 sipas të cilit Ministri, nëse merr një arsyetim të vlefshëm nga udhëheqësi i një organizate buxhetore, mund të autorizojë transferimin e një pjese të një ndarje të organizatës buxhetore në një ndarje tjetër të

organizatës së njejtë, me kusht që vlera e shumës së transferuar të mos jetë më e madhe se 15% (pesëmbëdhjetë përqind) e ndarjes së ndikuar negativisht.

Buxheti fillestar i KPM-së sipas Ligjit 08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 ishte 1,028,065.00 €, i ndarë sipas kategorive: Paga dhe Shtesa: 461,160.00 €; Mallra dhe Shërbime: 288,905.00 €; Shpenzime Komunale: 28,000.00 € dhe Projekti Kapital: 250,000.00 €.

Buxhetit përfundimtar i KPM-së për vitin 2022 ishte me vlerë prej 1,028,065.00 € i ndarë sipas kategorive: Paga dhe shtesa 414,105.71 €; Mallra dhe Shërbime: 335,959.29 €; Shpenzime Komunale: 28,000.00 € dhe Projekti Kapital: 250,000.00 €.

KPM në periudhën Janar-Dhjetor 2022 ka shpenzuar shumën në vlerë prej 739,508.52 €, prej të cilave për kategorinë Paga dhe Shtesa: 359,369.53 €; Mallra dhe Shërbime: 332,346.22 €; Shpenzime Komunale; 14,335.77 €; dhe Projekti Kapital 33,457.00 €;

Përqindja e realizimit të Buxhetit për vitin 2022 është 71.93 %, sipas kategorive në vijim: Paga dhe Shtesa 86.78 %, Mallra dhe Shërbime 98.92 %, Shpenzime Komunale 51.20 % dhe Projekti Kapital 13.38 %.

Buxheti i Komisionit të Pavarur i Mediave për vitin 2022				
Kategoritë	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pashpenzuar
Pagat dhe Rrogat	461,160.00	414,105.71	359,369.53	54,736.18
Mallra dhe Shërbime	288,905.00	335,959.29	332,346.22	3,613.07
Shërbime Komunale	28,000.00	28,000.00	14,335.77	13,664.23
Projekti Kapital Sist.Elekt.r.e-KPM-UPS	250,000.00	250,000.00	33,457.00	216,543.00
Total:	1,028,065.00	1,028,065.00	739,508.52	288,556.48

Buxheti i shpenzuar sipas Kategorive ekonomike:

I. Paga dhe Shtesa

Buxheti final në kategorinë e pagave dhe shtesave në raport me Buxhetin fillestar është zvogëluar për shumën në vlerë prej 47,054.29 € dhe janë transferuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Në kategorinë e pagave dhe shtesave, Buxheti fillestar në vlerë prej 461,160.00 € në krahasim me Buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 414,105.71 € dhe janë shpenzuar mjete në vlerë prej 359,369.53 € apo 86.78%.

Numri i aprovuar nga MFPT në vitin 2023 është 39 punëtorë që janë shërbyes civil dhe Komisioni prej 7 (shtatë anëtarëve) si dhe 3 (tre) Anëtarë të Bordit të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që nuk janë shërbyes civil.

Gjatë periudhës raportuese Buxheti nuk është realizuar sipas planifikimit. Kjo rrjedh si pasojë e mungesës së pozitive të aprovuara. KPM ka gjithsejt të autorizuar 39 pozita të karrierës. Aktual në detyrë janë 32 nëpunës.

Gjithsejt nga numri i aprovuar i punëtorëve dhe numri aktual i punëtorëve mbetet numri i pa plotësuar i 7 (shtatë) zyrtarëve në KPM, 1(një) anëtar i BAM-it dhe 3(tre) anëtar të Komisionit.

II. Mallra dhe Shërbime

Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në raport me Buxhetin fillestar është rritur për shumën 47,054.29 €. Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, Buxheti fillestar në vlerë prej 288,905.00 € në krahasim me Buxhetin final është rritur në vlerë prej 335,959.29 € dhe janë shpenzuar mjete në vlerë prej 332,346.22 € apo 98.92% .

III. Shërbime Komunale

Në kategorinë e Shërbimeve Komunale, nga totali i Buxhetit final në vlerë prej 28,000.00 € është shpenzuar shuma në vlerë prej 14,335.77 € apo 51.20%, ndërsa Buxheti i pashpenzuar është në vlerë prej 13,664.23 €.

IV. Projekte Kapitale

Projekti Kapital: “Sistemi Elektronik–e-KPM” në vlerë prej 250,000.00 € është shpenzuar shuma në vlerë prej 33,457.00 € për paisjen UPS dhe Buxheti i pashpenzuar është në vlerë prej 216,543.00 €, ose 13.38 %.

Mjetet kanë qenë të zotuara, por Projekti Kapital “Sistemi Elektronik-e-KPM” nuk është realizuar edhe pse KPM ka shpallur tender lidhur me projektin në fjalë, mirëpo i njëjti është shtyrë për shkak të ankesave nga ana e operatorëve ekonomik, fillimisht në autoritetin kontraktues mandej edhe në OSHP.

1.2 Realizimi i të Hyrave

KPM realizon të hyra nga Shërbimet mediale audio-vizuele, si: tarifa për aplikim të licencës, tarifat vjetore të licencës, tarifa për ndryshim dhe vazhdim të licencës, dhe gjobat. Këto të Hyra përmes llogarisë së KPM-së kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë KPM-2017/06, të Licencuarit nga KPM obligohen të paguajnë tarifën për licencë në baza vjetore për

secilin vit fiskal. Afati për pagesën e tarifave vjetore të të licencuarve të KPM-së është 30 qershor i vitit respektiv.

Faturat e lëshuara për vitin 2022 janë në vlerë prej 292,722.51 € dhe të Hyrat nga tarifa për licencë për vitin 2022 janë shuma në vlerë prej 272,764.77 €.

Nga të hyrat e mbledhura prej KPM-së, janë gjeneruar 315,844.71 € prej tyre 309,694.30 € u takojnë të hyrave nga tarifa për licencë ndërsa shuma prej 6,150.41 € u takojnë të hyrave nga gjobat. Nga te hyrat e gjeneruara në vlerë prej 309,694.30 € janë të përfshira edhe të hyrat e pranuar nga tarifrat për ndryshim të licencës, të hyrat për aplikim si dhe të hyrat nga licencat e reja.

Në kuadër të Realizimit të të Hyrave në vlerë prej 315,844.71 € është përfshirë vlera e të hyrave të mbledhura për vitin 2022 me vlerë prej 273,620.92 € dhe të hyrat e realizuara të viteve paraprake në vlerë prej 42,223.79 €. Shuma totale e realizimit përfshinë edhe një pjesë të kthimit të mjeteve të shërbimeve të përmbaruesit privat

Gjatë periudhës raportuese të hyrat e realizuara në vlerë prej 315,844.71 € shënojnë një zvoglim në vlerë prej 47,048.90 € apo 12.96 % më pak krahasuar me të hyrat e realizuara në periudhën e njejtë të vitit paraprak.

KPM prej taksës së licencës për vitin 2022 ka planifikuar që të realizojë të hyra në vlerë prej 275,119.96 €.

1.3 Të Arkëtueshmet nga tarifa për Licencë

Obligimet nga tarifa për licencë dhe gjobat të cilat e kanë statusin e të arkëtueshme në vlerë prej 795,969.95 €, janë si pasojë e mos pagesave të obligimeve për pagesën e tarifës së licencës, kamatës dhe gjobave.



Shuma totale në vlerë prej 494,925.78 € janë obligime nga tarifa për licencë, shuma në vlerë prej 21,382.97 € nga kamatat dhe shuma në vlerë prej 279,661.20 € janë obligime nga gjobat.


Obligimet për tarifën vjetore për Licencë për periudhën 2011-2013 janë proceduar për ekzekutim në Gjykatën Themelore dhe për vitet 2014-2022 janë proceduar te përmbaruesi privat.

Në kuadër të Ll/A në vlerë prej 795,969.95 € është e përfshirë vlera e Ll/A të krijuara në vitin 2022 me vlerë prej: 80,632.74 € (të arkëtueshmet nga tarifa për licencë në vlerë prej 21,582.74 € dhe të arkëtueshmet nga gjoba në vlerë prej 59,050.00 €) si dhe Ll/A të viteve paraprake në vlerë prej 715,337.21 €.

Vlera e llogarive të arkëtueshme (LL/A) në vlerë prej 795,969.95 €, në krahasim me vitin paraprak shënon rritje në vlerë prej 67,702.87 € (728,267.08 € në vitin 2021) apo 9.30 %.

Në grafika janë të dhënat për vitin 2022 dhe krahasimin me vitin 2021 e Faturave të lëshuara, Të Hyrat nga tarifa për Licencë, Të arkëtueshmet nga tarifa për licencë dhe të arkëtueshmet nga gjoba.





Organizimi i brendshëm i tri organeve të KPM-së

1. Komisioni i KPM-së numëron 7 (shtatë) anëtarë, të cilët janë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me mandat të caktuar dhe kanë statusin e të emëruarave publik. Gjithsej nga numri i aprovuar prej 7 (shtatë) anëtarëve, numri aktual prej 4 (katër) anëtarëve të Komisionit, mbetet i pa plotësuar edhe me 3 (tre) anëtarë.

2. Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv ka gjithsej të autorizuar 39 pozita të karrierës. Aktual në detyrë janë 32 nëpunës. Sa i përket strukturës etnike, gjithsej janë 30 (tridhjetë) nga komuniteti shqiptar, 1 (një) nga komuniteti turk dhe 1 (një) nga komuniteti boshnjak. Sipas strukturës gjinore, janë 14 meshkuj dhe 18 femra. Në fund të vitit gjithsej nga numri i aprovuar i punëtorëve, numri aktual i punëtorëve mbetet numri i pa plotësuar i 7 (shtatë) zyrtarëve. Këto pozita do të vazhdojnë të jenë në proces të rekrutimit. Gjatë periudhës raportuese, kemi pasur një zyrtarë në pushim pa pagesë që nga muaji gusht 2021 e deri në muajin gusht 2022

3. Bordi i Ankesave numëron 3 (tre), të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me mandat të caktuar dhe kanë statusin e të emëruarave publik. Bordi i Ankesave të KPM-së aktualisht është i plotësuar me numrin e dy anëtarëve, që nga marsi i vitit 2021 mbetet numri i pa plotësuar edhe për 1 (një) anëtar.

BORDI PËR ANKESA

Bordi për Ankesa (BA) është organ i pavarur në bazë të nenit 36 të Ligjit për KPM-në. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me Vendimet e Komisionit të KPM-së. Bordi për Ankesa përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nga radhët e anëtarëve të Bordit për Ankesa, Kuvendi zgjedh Kryetarin. Anëtarët e Bordit për Ankesa emërohen me mandat tre (3) vjeçar.

Përbërja aktuale e Bordit për Ankesa

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më 29 tetor 2020, ka emëruar për anëtar të Bordit për Ankesa z. Ylber Fetahaj me mandat tre (3) vjeçar dhe z. Avdyl Hyseni anëtar të Bordit për Ankesa me mandat tre (3) vjeçar, ashtu siç parashihet me nenin 40, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, ndërsa me Vendimin e datës 29 dhjetor 2020, e ka zgjedhur z. Ylber Fetahaj si Kryetar të Bordit për Ankesa.

Më 15 mars 2021 i ka përfunduar mandati një anëtari të Bordit dhe prej kësaj date Bordi nuk është në përbërje të plotë dhe as funksional, në pritje të emërimit të anëtarit të tretë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mënyrë që ky organ të jetë funksional.

Përbërja e Bordit për Ankesa gjatë vitit 2021

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar	Kohëzgjatja e mandatit
Ylber	FETAHAJ	Kryetar	29 tetor 2020	mandat tre (3) vjeçar
Avdyl	HYSENI	Anëtar	29 tetor 2020	mandat tre (3) vjeçar

Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa

Bordi për Ankesa (BA), gjatë vitit 2022, nuk ka mbajtur seanca shqyrtuese, për shkak të skadimit të mandatit të një anëtari, gjë që ka bërë që Bordi për Ankesa të mos ketë kuorum për trajtimin e ankesave ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së. Pas datës 15 mars 2021, Bordi për Ankesa vetëm u ka kthyer përgjigje të gjitha Palëve ankuese duke i informuar që është jofunksional për faktin se nuk është në përbërje të plotë prej tre anëtarësh, deri në zgjedhjen e anëtarit nga Kuvendi i Kosovës dhe i ka udhëzuar që të vazhdojnë procedurat ligjore bazuar në legjislacionin në fuqi.

OBJEKTIVAT E VITIT 2023

- ✚ Avancimi i Infrastrukturës primare ligjore
 - Hartimi i një dokumenti nga ana e KPM-së (Grupi Punues) ku rekomandohen qëndrime dhe nene konkrete ligjore relevante për Draft Ligjin e ri për KPM, bazuar në zhvillimet e fundit teknologjike, evoluimin e mediave, legjislacionin evropian dhe praktikrat më të mira rregullatore
- ✚ Avancimi i legjislacionit rregullator sekondar
 - Rregullorja për Pronësi dhe Koncentrim të Mediave
 - Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve
 - Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audiovizuale
 - Rregullorja për Reality TV
 - Përcaktimi i ngjarjeve ekskluzivisht të rëndësishme
- ✚ Ngritja e efikasitetit të monitorimeve
 - Definohet një procedurë më efikase e trajtimit të gjetjeve, respektivisht definimi i intervaleve kohore të arsyeshme të trajtimit të lëndëve prej momentit të shfaqjes së tyre deri në një vendimmarrje meritore dhe ekzekutimin e saj
 - Marrëveshje bashkëpunimi me RTUK
 - Aktivitetet trajnuese
 - Furnizimi me softwere dhe teknikë efikase të monitorimit (2023 – 2026)
- ✚ Rritja e Transparencës
 - Uebfaqja e KPM-së të dizajnohet me një dizajn që mundëson transparencë efektive, të jetë miqësor me përdoruesit, strukturë adekuate ku kemi kategorizime të duhura të informacioneve e arkives, dhe prej nga përdoruesit lehtas marrin informacionin që dëshirojnë
 - Definohet saktë dhe në mënyrë meritore procedura e ankesave dhe aktivizohet në uebsajt një modul efikas përmes të cilit palët lehtas paraqesin ankesat e tyre dhe marrin përgjigjen meritore brenda afateve të arsyeshme kohore, si dhe publiku i gjerë informohet për këto
 - Baza e të dhënave për të licencuarit e përditësuar publikohet në uebsajt së bashku me indikatorë të ndryshëm relevant
- ✚ Rritja e efikasitetit në përdorimin e Spektrit Frekuencor
 - Strategjia për Digital Audio Broadcasting – DAB
 - Pjesëmarrja në takimet e organizuara rajonale për këtë temë dhe spektrin frekuencor në përgjithësi

- ✚ Ndërgjegjësimi për përgjegjësinë editoriale dhe zhvillimi profesional i televizioneve (2023 – 2026)

- Hulumtim i besueshmërisë së publikut ndaj kanaleve vendore

REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT

Vështirësitë dhe sfidat lidhur me zbatimin e Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

KPM gjatë vitit 2022 ka hasur në vështirësi të shumta sa i përket zbatimit të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta Nr. 04/L-065, konkretisht në lidhje me obligimet të cilat kanë të bëjnë me regjistrimin e marrëveshjeve për të drejtat e transmetimit dhe ritransmetimit në shoqatën për menaxhimin kolektiv të të drejtave.

KPM, edhe përkundër faktit se është e përkushtuar për t'i kryer obligimet ligjore, gjykon se nuk ka qartësinë e duhur në zbatimin e Ligjit për të Drejtat e Autorit, konkretisht nenit 30 të këtij Ligji, për faktin se ekzistojnë disa paqartësi në kuadër të nenit 30 të cilat e vështirësojnë ndërmarrjen e veprimeve konkrete nga ana e KPM-së në funksion të realizimit të të drejtave të autorëve.

Me qëllim që zbatimi i ligjit të jetë i barabartë dhe jo selektiv dhe t'i përfshijë të gjitha subjektet e licencuara nga ana e KPM-së, KPM ka nevojë për disa sqarime të nenit 30 të Ligjit për të Drejtat e Autorit Nr. 04/L-065, konkretisht çështjeve në vijim:

Neni 30, paragrafi 2, “Marrëveshjet mbi të drejtën e autorit që kanë të bëjnë me transmetimin dhe ritransmetimin e programeve audiovizuale do të jenë të vlefshme vetëm pasi ato të jenë regjistruar nga shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave të cilat licencohen nga Zyra për të drejtën e autorit pranë Ministrisë së Kulturës, në pajtim me nenin 171 të këtij ligji”. Nuk besojmë që kjo është mënyrë e duhur rregullimi ngase i obligon TV-të që direkt të lidhin marrëveshje me shoqata edhe nëse tashmë disponojnë me të drejta individuale. Dilema jonë më e madhe është se si do mundemi ta vejmë në praktikë këtë.

Neni 30. Paragrafi 4, i Ligjit për të Drejtat e Autorit kërkon nga ana e shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA-të) përmbushjen e obligimeve për transmetim dhe ritransmetim. Kjo i bie që KPM do të merret direkt me televizionet që nuk përmbushin këtë obligim. Aktualisht një gjë e tillë është duke u kërkuar vetëm për operatorët e shpërndarjes nga ana e VAPIK. Kjo na sjell te dilema e zbatimit selektiv të Ligjit. Kërkesa për marrëveshje për të drejtën e autorit mes TV-ve dhe VAPIK në kuptimin e të drejtave kolektive nuk duket të jetë koherente. E drejta e autorit ushtrohet ose individualisht ose përmes shoqatave për të drejta kolektive. Nuk do duhej realizuar në mënyrë të dyfishtë në momentin kur fitohet e drejta pa kufizime ritransmetimi. Është bindje jona se “*transmetimet*” nuk duhet t'i nënshtrohen regjimit të menaxhimit kolektiv.

“Ligji nr. 05 L 047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04 L 065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta” është në kundërshtim edhe me Direktivën Evropiane “COUNCIL DIRECTIVE 93/83/EEC”, së cilës Ligji për të Drejtat e Autorit i referohet në fillim se është në linjë me të.

Neni 1 i Ligjit Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për të Drejtat e Autorit Nr. 04/L-065, përcakton se qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta me qëllim **të harmonizimit me direktivat e Bashkimit Evropian** të fushës së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, duke përfshi këtu edhe Direktivën **98/83/EEC e datës 27 shtator 1993** e cila ka **synuar lehtësimin e transmetimit ndërkufitar** të programeve audio-vizuale. Konkretisht në nenin 2, pika 1.21, të Ligjit Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për të Drejtat e Autorit Nr. 04/L-065, është futur përkufizimi i *ritransmetimi kabllor* që është në kundërshtim me përkufizimin e të njëjtit në Direktivë, si në vijim:

“Ritransmetim kabllor - është ritransmetimi i njëkohshëm, i pandryshuar dhe i pandërprerë te publiku, nëpërmjet sistemit me tel, mediumet optike dhe mikrovalore për marrjen nga publiku **të transmetimit që vjen nga një organizatë tjetër transmetuese**”.

Ndërsa, në Direktivën 93/83/EEC kemi një tjetër përkufizim për ritransmetimin kabllor si:

“Për qëllimet e kësaj direktive, “ritransmetim kabllor” nënkupton ritransmetimin e njëkohshëm, të pandryshuar dhe të pakursyer nga një sistem kabllor ose mikrovalor për marrjen nga publiku i një transmetimi fillestar **nga një shtet tjetër anëtar**, me tel ose me ajër, duke përfshirë atë nga satelitore, e programeve televizive ose radiofonike të destinuara për t'u marrë nga publiku”.

Direktivat evropiane flasin për ritransmetimet e përmbajtjeve nga shtetet tjera të BE-së. Mendojmë që devijimi i kuptimit të “ritransmetimit kabllor” e humb në esencë qëllimin e ligjit dhe pamundëson zbatimin efektiv të tij.

KPM kërkon nga Kuvendi i Kosovës që të ndihmojë në evitimin e kësaj situate konfuzë së paku në shikimin e KPM-së, dhe gjatë procesit të rishikimit të Ligjit për të Drejtat e Autorit të ketë një harmonizim progresiv e racional me Direktivat Evropiane që rregullojnë këtë fushë, dhe të sigurohet se të drejtat e autorëve në vendin tonë realizohen me transparencë të plotë, sipas praktikave më të mira, në mënyrë jo diskriminuese, e ku qartësia ligjore nuk diskutohet.

Pritjet e KPM-së janë që dilemat e ngritura të qartësohen dhe avancimi i infrastrukturës ligjore të rezultojë me ngritje të efektivitetit në zbatim dhe realizim adekuat të të drejtave të autorëve. Nga këndvështrimi i KPM-së, të Drejtat e Autorit duhet të zbatohen në baza individuale deri në anëtaresimin e Kosoves në BE. Në momentin e anëtarësimit, të drejtat kolektive shfrytëzohen përmes shoqatave të autorizuara nga zyra për të drejtat e autorit sipas përkuzimeve të direktivës relevante.

Në secilin rast, është e rëndësishme që gjatë rishikimit të ligjit, me të Drejtat e Autorit për *ritransmetimet* të merret Zyra për të Drejtat e Autorit pranë Ministrisë së Kulturës, meqë konsiderohet se ka ekspertizën e duhur për këtë fushë, dhe të mos ngarkohet KPM me këtë çështje e cila e vendosë KPM-në në sfida që nuk do duhej të ishin përgjegjësi e saj.

Pikëpamjet e KPM-së për dixhitalizimin tokësorë

Komisioni i Pavarur i Mediave e sheh me interes dhe të nevojshme ndërmarrjen e veprimeve për ndryshimin/anulimin e Ligjit për Dixhitalizimin (05/L-027) meqë gjykon se përmbajtja aktuale e

ligjit është jo koherente, në kundërshtim me Vendimin e Parlamentit Evropian nr. 2017/899, dhe në kundërshtim me kërkesat që kanë të bëjnë me Dividendën e Dytë Dixhitale. Rrjedhimisht, Ligji për Dixhitalizimin është gati i pazbatueshëm.

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë broadband në vendin tonë, respektivisht shtrirja e kabllave me kapacitete të larta komunikimi në gjithë territorin e Kosovës, dhe mënyra se si qytetarët tanë e pranojnë sinjalin televiziv ka efekt të konsiderueshëm në rëndësinë e dixhitalizimit tokësor dhe kërkesën për shërbime të tilla.

Vendimi i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit (DECISION (EU) 2017/899) mbi përdorimin e brezit 694-790 MHz i datës 17 maj 2017, kërkon nga Shtetet Anëtare të BE-së që të mundësojnë përdorimin e këtij brezi (“700 MHz”) për sistemet tokësore të komunikimeve elektronike të afta për ofrimin e shërbimeve brezgjera pa tela. Kjo nënkupton Dividendën e Dytë Dixhitale në Evropë respektivisht perfundimin e transmetimeve klasike televizive në brezin 694-790.

Ligji mbi Digjitalizimin tashmë është në kundërshtim me vendimin e Parlamentit Evropian meqë kërkon që të lëshohet në funksion për transmetime dixhitale tokësore kanali nr.58 i cili i takon brezit të lartëcekur frekuencor, e që në Evropë gjithandej përdoret për tjera qëllime.

Në përgjithësi, Ligji mbi Dixhitalizimin sot nuk është në linjë me zhvillimet e fundit teknologjike, nuk është në linjë me rregullimin në Evropë, dhe as nuk i përgjigjet gjendjes reale në tregun medial të vendit.

Për rrethanat aktuale të tregut, ku kemi mbulim pothuajse 100% me shërbimet kabllore (internet + tv), ku shumë televizione tashmë kanë ndaluar transmetimet tokësore me vetëdëshirë për arsye se nuk kanë shikues që pranojnë sinjalin me frekuencë por vetëm me kablo, ku kemi trende të “okupimit” të brezeve frekuencore të transmetimeve televizive nga ana e teknologjisë në ekspansion 5G, dhe në njohje të faktit se “strategjia mbi dixhitalizimin” përfshinë në vehte një kosto vjetore të konsiderueshme të mirëmbajtjes, rezulton se strategjia aktuale mbi dixhitalizimin është e panevojshme, e padobishme dhe nuk gjen zbatim.

Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike kërkon nga Shtetet Anëtare të BE-së të respektojnë parimin e neutralitetit teknologjik, që i bie se rregullatorët nacional nuk duhet të imponojnë e as diskriminojnë në favor të përdorimit të një teknologjie. Prandaj, e rëndësishme mbetet që tregu audiovizuel të jetë i hapur dhe të rregullohet sipas praktikave më të mira pavarësisht teknologjive të përdorura:

- Shërbimeve kabllorike
- Frekuencave radiodifuzive
- Platformave online
- Etj.

Gjithashtu, referuar Kodit të Komunikimeve Elektronike, *“konkurrenca dhe investimet efikase duhet inkurajuar në tandem, në mënyrë që të kemi rritje ekonomike, inovacion dhe mundësi zgjedhjesh nga ana e konsumatorëve”*.

Poashtu, referuar Kodit të Komunikimeve Elektronike, *“konkurrenca mund të nxitet më së miri përmes një niveli efikas ekonomik të investimeve në infrastrukturën e re dhe ekzistuese, plotësuar me rregullim aty ku është e nevojshme, për të arritur konkurrencë efektive në shërbimet me pakicë. Një niveli efikas i konkurrencës së bazuar në infrastrukturë është shkalla e duplikimit të*

infrastrukturës për të cilën investitorët në mënyrë të arsyeshme presin të kenë kthim të drejtë bazuar në pritjet e arsyeshme në evoluimin e pjesëve të tregut”.

Sipas Raportit të Bankës Botërore të përgatitur nga ekspertë të fushës nga Korea e Jugut dhe dorëzuar në KPM në vitin 2019, në Evropë tashmë dy vende kishin vendosur të largoheshin nga Transmetimet Tokësore Dixhitale (DTT) për shkak të numrit të vogël të shtëpive që pranonin DTT si pranim primar. Në terme ekonomike, transmetuesit televiziv dhe akterët tjerë nuk dëshironin të paguajnë për licencë dhe kosto tjera operationale kur vetëm një pjesë e vogël e popullatës përdornin këto shërbime. Rasti i parë është Belgjika në fund të vitit 2018 me arsyetimin e “ndryshimit të mënyrës së shfrytëzimit të mediave”, kurse Zvicra ndërpreu shërbimet DTT në qershor 2019 duke afektuar 2% të popullatës ose rreth 64000 shtëpi.

Në rastin tonë, përqindja dhe numri i shtëpive me pranim me frekuencë është dukshëm më i vogël e gati i papërfillshëm, ndërsa në anën tjetër kemi mbulim shumë të mirë me kablllo respektivisht fije optike (FTTH).

KPM gjykon se brezi i Dividendës Dixhitale (DD2) duhet të lirohet për t’i shërbyer komunikimeve pa tela dhe gjeneratës së ardhshme të komunikimeve mobile dhe rekomandon që të rishikohet mundësia e ndryshimit të Ligjit mbi Dixhitalizimin ose të anulohet në tërësi.

Zgjidhja më e thjeshtë dhe e rekomanduar është që të anulohet Ligji mbi Dixhitalizimin dhe të përfshihet një paragraf i vetëm në draft-ligjin për KPM që siguron se KPM ndan frekuenca për televizionin publik për qëllim të transmetimeve dixhitale tokësore pa iu nënshtruar garës, dhe gjithashtu lëshon frekuenca për transmetime dixhitale tokësore sipas nevojës bazuar në një garë kompetitive në respektim të kushteve të përcaktuara nga KPM që sigurojnë një garë fer, dhe njëkohësisht sigurojnë mbrojtje nga përqëndrimi i mediave.

Vështrësitë dhe sfidat lidhur me pavarësinë financiare

KPM si një institucion i pavarur kushtetues duhet të disponojë me resurse humane të përgatitura mirë profesionalisht. Të tilla kadro mund të zhvillohen dhe qëndrojnë në KPM vetëm nëse arrijmë t’i mbajmë të motivuar, e kjo arrihet nëse arrijmë t’u sigurojmë të ardhura të qëndrueshme. KPM është në kërkim të mundësive që të arrihet ky synim i cili është esencial në arritjen e objektivave të saj.

Nevoja për rritjen e numrit të stafit

Në vazhdimësi, KPM-ja ka parashtruar kërkesa për shtimin e numrit të stafit, duke u bazuar në kërkesat reale që ndërlidhen me zgjerimin e fushëveprimit të KPM-së, marrë parasysh edhe faktin se numri i të licencuarve nga KPM-ja është rritur dukshëm, përfshirë edhe paraqitjen e platformave të reja mediale si rezultat i zhvillimeve teknologjike, duke shtuar volumin e detyrave për nëpunësit ekzistues.

Aktualisht, KPM-ja është duke u ballafaquar me mungesë të theksuar të stafit dhe si rezultat i kësaj në vazhdimësi ka ngarkesa në punë, të cilat po rezultojnë edhe me pamundësinë e kryerjes së detyrave sipas pritjeve. Kjo gjendje gjithsesi mund të ketë edhe efekte negative sa i përket zbatimit të rregulloreve dhe procedurave në punë, sidomos marrë parasysh edhe detyrat që i ngarkohen KPM-së nga ana e ligjeve jo-organike.

AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2021

Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Sipas opinionit të auditimit, Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Gjatë auditimit është dhënë një rekomandim lidhur me regjistrimin dhe zhvlerësimin e pasurive nën një mijë euro (1000 €), për shkak të mosfunksionimit të sistemit E-pasuria, e i cili sistem nuk ka funksionuar as në organizatat tjera buxhetore. Rekomandimi është zbatuar gjatë vitit 2022 dhe të gjitha pasuritë janë regjistruar në tabela të brendshme dhe në sistemin elektronik E-pasuria.

Përveç këtij rekomandimi, Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021 ka vlerësuar dhe ka dhënë opinion të pamodifikuar.

Deri në përfundim të periudhës raportuese, ende nuk është kryer auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2022.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Shtojca I - Organogrami




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

ORGANIZIMI



KOMISIONI

ZYRA EKZEKUTIVE

BORDI I ANKESAVE

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

ORGANIZIMI

Kryetar

Nënkryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

BORDI I ANKESAVE

ORGANIZIMI



Kryetar



Anëtar i Bordit



Anëtar i Bordit

Kryeshefi Ekzekutiv

Departamenti Ligjor

Dept. Monitorimit dhe Analizës së Mediave (DMA)

Dept. Admin dhe Financa

Dept
.LIC

Dept.
MF

Asistent
Ekzekutiv

Drejtori i
Prokurimit

Zyrtar i
lartë për
informim
publik

AB

Divizioni I
(pajtueshmer
i dhe
legjislacion)

Divizioni II
(ankesa dhe
përfaqësim)

Divizioni I (OSHMA - T)

Divizioni II (OSHMA-OSH,
OSH)

Divizioni i financave

Menxhe
rja HR

Zyrtar i
Logjistikës

Zyrtar i
Arkivës

IT

Div.
Lic

Divi.
MF

ZL

Z

ZL

ZL

ZL

ZL

ZL

ZL

ZL

ZL

ZL

ZL

ZL

ZL

ZL

Z



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Shtojca II - Tabela e Rasteve Ligjore



PARAQITJA TABELARE E RASTEVE LIGJORE

Gjatë vitit 2022 KPM ka shqyrtuar raste të natyrave të ndryshme të Ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) dhe Operatorëve të shpërndarjes (OSH) për shkelje të Ligjit të KPM-së dhe akteve nënligjore të KPM-së.

Varësisht nga natyra e shkeljes së dispozitave ligjore të KPM-së rastet e proceduara janë kategorizuar dhe paraqitur në formë tabelare si në vijim:

1. Rastet për transmetim ilegal-Shkelja e nenit 21, paragrafi 1 dhe nenit 30 paragrafi 5 e Ligjit 04/L-44 të KPM-së;

Gjatë vitit 2022 ka proceduar katër (4) raste lidhur me këtë shkelje.

Tabela-1

Nr. Rendor	Procedura e inicuar nga:	Pala Përgjegjëse	Lloji i shkeljes dhe dispozitat ligjore	Veprimet e KPM-së	Përfundimet
1.	KPM	NIARTI	Shkelja e Ligjit të KPM-së. Shkelja e Nenit 21 paragrafi 1, Licenca e transmetimit dhe ripërtëritja e tyre dhe nenit 30 paragrafi 5, Sanksionet.	Njoftim për shkelje (9 shkurt 2022) Vendim me datë 4 mars 2022 nga ana e Komisionit, konfiskim të pajisjeve.	Pala është pajisur me licencë të KPM-së. Rasti është mbyllur.
2.	KPM	CIPKO NET	Shkelja e Ligjit të KPM-së. Shkelja e Nenit 21 paragrafi 1 dhe nenit 30 paragrafi 5.	Njoftim për shkelje (10 mars 2022)	Rasti bartet për vitin 2023, për arsye se nuk ka shfaqur interesim për t'u licencuar.
201300000006720	XBL-SU100/12FM RADIO LOGGER S	2010090672	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	19,140.00	0.00	19,140.00	0.00	0.00
201300000006728	UPS 6000 KVA ECLO PROJEKT.MON	MAT ML34UT172480027	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	2,610.00	0.00	2,610.00	0.00	0.00
201300000006731	MINI HEADEND FROM ANALOG TO A	5572	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	4,350.00	0.00	4,350.00	0.00	0.00
201300000006732	XBL-SU1000/2 BROADCAST LOGGER	2010090667	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	15,660.00	0.00	15,660.00	0.00	0.00
201300000006734	XBL-SU1000/8FM RADIO LOGGER S	2010090668	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	17,400.00	0.00	17,400.00	0.00	0.00
201300000006739	UPS 6000 KVA ECLO PROJEKT.MON	MATML34UT172480030	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	2,610.00	0.00	2,610.00	0.00	0.00
201300000006743	MINI HEADEND FROM ANALOG TO A	5575	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	4,350.00	0.00	4,350.00	0.00	0.00
201300000007056	XBL-SU1000/4 BROADCAST LOGGER	2010 090673	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	20,010.00	0.00	20,010.00	0.00	0.00
201300000007057	XBL-SU1000/5FM RADIO LOGGER S	2010 090674	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	17,400.00	0.00	17,400.00	0.00	0.00
201300000007058	UPS 6000 KVA ECLO PROJEKT MON	MAT ML 34UTI172480032	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	2,610.00	0.00	2,610.00	0.00	0.00
201300000007059	MINI HEADEND FROM ANALOG TO A	5573	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	4,350.00	0.00	4,350.00	0.00	0.00
201300000007060	XBL-SU1000/5 BROADCAST LOGGER	2010 09 0669	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	24,360.00	0.00	24,360.00	0.00	0.00
201300000007061	XBL-SU1000/14FM RADIO LOGGER	2010 09 0670	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	24,360.00	0.00	24,360.00	0.00	0.00
201300000007062	UPS 6000 KVA ECLO PROJEKT. MO	MAT ML34UT172480028	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	2,610.00	0.00	2,610.00	0.00	0.00

Id e Artikullit të Pasurisë	Përshkrim i Artikullit të Pasurisë	Numri serik	Kodi i gjendjes së Pasurisë	Përshkrimi i gjendjes së Pasurisë	Kodi i Klasës së Pasurisë	Përshkrim i Klasës së Pasurisë	Vlera origjinale	Ndryshim i vlerës	Amortizim	Shitje	Vlera në libër
201300000007063	MINI HEADEND FROM ANALOG TO A	5574	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	4,350.00	0.00	4,350.00	0.00	0.00
201300000007065	42-FREE STANDING RECK CABINET	SN303255	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	1,044.00	0.00	1,044.00	0.00	0.00
201300000007067	XBL-MU BROADCAST LOGGER MASTE	2010 09 0656	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	32,625.00	0.00	32,625.00	0.00	0.00
201300000007068	XBL-MU BROADCAST LOGGER MASTE	2010 09 0655	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	32,625.00	0.00	32,625.00	0.00	0.00
201300000007069	CENTRAL MEDIA STORAGE HEAD EC	2010 09 0656	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	200,100.00	0.00	200,100.00	0.00	0.00
201300000007070	XBL-SU1000/2 BROADCAST LOGGER		1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	29,580.00	0.00	29,580.00	0.00	0.00
201300000007071	XBL-SU1000/2 BROADCAST LOGGER	2010 09 0659	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	29,580.00	0.00	29,580.00	0.00	0.00
201300000007073	XBL-SU1000/2 BROADCAST LOGGER	2010 09 0662	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	29,580.00	0.00	29,580.00	0.00	0.00
201300000007074	XBL-SU1000/2 BROADCAST LOGGER	2010 09 0663	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	29,580.00	0.00	29,580.00	0.00	0.00
201300000007076	XBL-SU1000/2 BROADCAST LOGGER	2010 09 0664	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	29,580.00	0.00	29,580.00	0.00	0.00
201300000007086	LTO WORKSTATION ECLO PROJEKT.	2010 09 0676	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	34,539.00	0.00	34,539.00	0.00	0.00
201300000007089	KVM SWITCH MONITOR ECLO PROJE	9R14056604G-ROHS-A93700006A	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	2,610.00	0.00	2,610.00	0.00	0.00
201300000007093	UPS 10000 KVA 65 KG ECLO PROJ	MAT ML36UT176710004	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	6,960.00	0.00	6,960.00	0.00	0.00
201300000007097	XBL-SU1000/4 BROADCAST LOGGER	N/A	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	20,010.00	0.00	20,010.00	0.00	0.00
201300000007101	XBL-SU1000/5FM RADIO LOGGER S	N/A	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	17,400.00	0.00	17,400.00	0.00	0.00
201300000007103	UPS 6000 KVA ECLO PROJEKT. MO	N/A	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	2,610.00	0.00	2,610.00	0.00	0.00
201300000007106	MINI HEADEND FROM ANALOG TO A	N/A	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	4,350.00	0.00	4,350.00	0.00	0.00
2014000000005430	XBL-SU1000/8 Broadcast longge	ET25093	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	78,511.65	0.00	78,511.65	0.00	0.00

Id e Artikullit të Pasurisë	Përshkrim i Artikullit të Pasurisë	Numri serik	Kodi i gjendjes së Pasurisë	Përshkrimi i gjendjes së Pasurisë	Kodi i Klasës së Pasurisë	Përshkrim i Klasës së Pasurisë	Vlera origjinale	Ndryshim i vlerës	Amortizim	Shitje	Vlera në libër
201400000005434	Licenca TV-Radio		1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00	0.00
201400000005436	UPS 6 kVL online double conv.	MC20UT822490027	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	2,550.00	0.00	2,550.00	0.00	0.00
201400000005437	Blankom Mini Headend from Ana		1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	5,200.30	0.00	5,200.30	0.00	0.00
201400000005440	Dyshemja e ngritur me konstru		1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	1,877.41	0.00	1,877.41	0.00	0.00
201400000005441	Izolimi akustik i dhomes me m		1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	1,982.00	0.00	1,982.00	0.00	0.00
201400000005442	Instalimi i rrymes		1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	1,020.44	0.00	1,020.44	0.00	0.00
201400000005444	Instalimi i sistemit kunder z		1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	1,134.57	0.00	1,134.57	0.00	0.00
201400000005445	Air kondicioner per server dh	10038777	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	23,637.85	0.00	23,637.85	0.00	0.00
201400000005448	Dera kunder zjarrit me hapje	14PR02494897	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	1,100.00	0.00	1,100.00	0.00	0.00
201400000005450	Sistemi per qasje elektrike t	AR-727CM-V3-485	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	2,000.00	0.00	2,000.00	0.00	0.00
201400000005454	19-- free standing Reck Cabin		1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	1,180.00	0.00	1,180.00	0.00	0.00
201400000005465	Raid controller 48TB	DHSIBSH-14221B8AC9	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	17,859.62	0.00	17,859.62	0.00	0.00
201400000005466	JOB hard disk zgjerim 48TB	DHSIBSH-14221B89DE	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	12,772.50	0.00	12,772.50	0.00	0.00
201400000005467	JOB hard Disk zgjerimi 48TB	DHSIBSH-14221B8967	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	12,772.50	0.00	12,772.50	0.00	0.00
201400000005468	JOB hard disk zgjerimi 48TB	DHSIBSH-14221B8965	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	12,772.50	0.00	12,772.50	0.00	0.00
201400000005469	JOB hard disk zgjerimi 48TB	DHSIBSH-14221B8965	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	12,772.50	0.00	12,772.50	0.00	0.00
201400000005470	Fiberchannel Switch	1329F00027	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	4,190.00	0.00	4,190.00	0.00	0.00
201400000005472	UPS online 30KVA	MC17UD81715003	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	20,775.00	0.00	20,775.00	0.00	0.00

Id e Artikullit të Pasurisë	Përshkrim i Artikullit të Pasurisë	Numri serik	Kodi i gjendjes së Pasurisë	Përshkrimi i gjendjes së Pasurisë	Kodi i Klasës së Pasurisë	Përshkrim i Klasës së Pasurisë	Vlera origjinale	Ndryshim i vlerës	Amortizim	Shitje	Vlera në libër
201400000005543	Update versioni i fundit i IC	N/A	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	53,056.00	0.00	53,056.00	0.00	0.00
201400000005545	Licenca per pordorimin e ICS	N/A	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	7,860.00	0.00	7,860.00	0.00	0.00
201400000005546	10 m Digital Map of Kosovo	N/A	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	140,360.00	0.00	140,360.00	0.00	0.00
201400000005547	LLaptop 17-HDD- SSD-500GB SPU	G6TVG12 M17X	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	1,326.00	0.00	1,326.00	0.00	0.00
201400000005549	Llaptop 17--HDD:SSD-500GB CPU	CWRVG12 M17X	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	1,326.00	0.00	1,326.00	0.00	0.00
201400000005550	LLaptop 17-HDD:SSD-500GB CPU	5CRVG12 M17X	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	1,326.00	0.00	1,326.00	0.00	0.00
201400000005559	Laptop Macbook Pro Retina Dis	C02N22Q6FH05	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	1,842.00	0.00	1,842.00	0.00	0.00
201400000007854	Update versioni i fundit i IC		1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	67,314.00	0.00	67,314.00	0.00	0.00
201400000007861	Licenca per pordorimin e ICS		1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	7,486.00	0.00	7,486.00	0.00	0.00
201400000007866	DVB-T/T2 test Transmitter for		1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	55,734.00	0.00	55,734.00	0.00	0.00
201400000007872	Update versioni i fundit i so		1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	3,877.00	0.00	3,877.00	0.00	0.00
9992	DVB-T/T2 Test reciver	MAC0090B81CC41A	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	21,286.00	0.00	21,286.00	0.00	0.00
10000	KATHREIN MSK200/MZN 200/T2	n/a	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	3,500.00	0.00	3,500.00	0.00	0.00
14923	Arkiva Elektronike	1506F002200-DHSIHU-1540254E66.E8C-DHSIBIBSH15381DAA55.25DA07.125C537.125C53DA4B.	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	217,385.07	0.00	217,385.07	0.00	0.00
20809	Furnizues me rrym per Storage	DHSISHI-1432MZ7546	1	NE PERDORIM	31510	FURN.ME RRYME,GJENERIMI,TRANSMISIONI	1,197.36	0.00	359.22	0.00	838.14
20817	Furnzues me rrym per Storage	SHSISHI-1432MZ7485	1	NE PERDORIM	31510	FURN.ME RRYME,GJENERIMI,	1,197.36	0.00	359.22	0.00	838.14

Id e Artikullit të Pasurisë	Përshkrim i Artikullit të Pasurisë	Numri serik	Kodi i gjendjes së Pasurisë	Përshkrimi i gjendjes së Pasurisë	Kodi i Klasës së Pasurisë	Përshkrim i Klasës së Pasurisë	Vlera origjinale	Ndryshim I vlerës	Amortizim	Shitje	Vlera në libër
						TRANSMISIONI					
20824	Furnizues me rrym per Storage	DHSISHI-1432MZ7496	1	NE PERDORIM	31510	FURN.ME RRYME,GJENERIMI,TRANSMISIONI	1,197.36	0.00	359.22	0.00	838.14
20837	Furnizues me rryme per Storage	DHSISHI-1432MZ480	1	NE PERDORIM	31510	FURN.ME RRYME,GJENERIMI,TRANSMISIONI	1,197.36	0.00	359.22	0.00	838.14
20842	Furnizues me rrym per Storage	DHSISHI-1432MZ7486	1	NE PERDORIM	31510	FURN.ME RRYME,GJENERIMI,TRANSMISIONI	1,197.36	0.00	359.22	0.00	838.14
20848	Furnizues me rrym per Storage	DHSISHI-1432MZ7510	1	NE PERDORIM	31510	FURN.ME RRYME,GJENERIMI,TRANSMISIONI	1,197.36	0.00	359.22	0.00	838.14
54952	Paisje tjera	20191002001-12;305413-62;909MADHE0082-94;4260217680914/4260217680808;WCAZAK65574	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	239,060.80	0.00	119,530.41	0.00	119,530.39
66413	Server	E301485X0A00852A; E301485X0A00852B; A318063X0409808; 20201021042	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	119,950.00	0.00	43,315.28	0.00	76,634.72
68815	Softuer	N/a	1	NE PERDORIM	31680	SOFTUER	9,770.00	0.00	2,791.42	0.00	6,978.58
82469	UPS	UPS 96 KVA	1	NE PERDORIM	31690	PAISJE TJERA PAISJE TJERA	33,457.00	0.00	4,182.13	0.00	29,274.87
							3,810,607.48	0.00	3,562,095.00	0.00	248,512.48
Totalet :							3,810,607.48	0.00	3,562,095.00	0.00	248,512.48

Aneks 5 -Të dhënat analitike të regjistrit të inventarizimit të stoqeve

Nr	Kodi	Përshkrimi	Sasia në depo	Cmimi	Vlera
1	5622	Notes A4	11.00	0.68	7.48
2	182758	mbeshtjells rap nga kartoni a4	74.00	0.21	15.54
3	182762	Nenshkruj ketu postit me ngjyra	5.00	0.11	0.55
4	182763	Laps i thjesht klasik druri	19.00	0.04	0.76
5	182755	dosje me shirita me ngjyra 150	2.00	1.78	3.56
6	182765	Kimik me koke te rrumbullakt	4.00	0.07	0.28
7	182766	Kimik me ngjyra mpretsia 0.5mm	1.00	0.14	0.14
8	182764	Mpres i lapsave nga metali	4.00	0.10	0.38
9	8755	desk organizier	66.00	0.78	51.77
10	194555	Zarfa A4	4.00	7.10	28.40
11	173538	Drita Hallogjene 12V 20W	2.00	5.00	10.00
12	17413	Letër A4 80gr e bardhë	50.00	2.38	119.00
13	209348	Bateri alkaline 1.2V madhesia AA, AAA AQP	11.00	0.25	2.75
14	206874	Bllok A3dyngjyresh NCR 100flete pa nr serk njeaneshe	7.00	4.96	34.69
15	148827	Bateri e laptopit	1.00	70.20	70.20
16	65560	Leter A4/80gr/M2	189.00	2.53	478.17
17	213179	Letër speciale për zyre A4/160 g/m2	5.00	2.80	14.00
18	47987	Fasiklla transparente me vrima A/4, 1/100	19.00	0.84	15.96
19	155389	Fasciklla me mbishkrim	499.00	0.08	39.92
20	195836	Mbështjellës plastik i raportëve	200.00	0.08	16.00
21	9066	bateri 1.5v.AAA e vogel	39.00	0.25	9.75
22	175267	Makine llogaritese per tavikne me ekran 8 shifror	9.00	1.30	11.70
23	209352	Heft makine (kapse e letrave stapler) AQP	4.00	3.00	12.00
24	209353	Heft makine (kapse e letrave stapler) AQP perdoret me dore kapacitet 250 flete AQP	4.00	3.00	12.00
25	38350	Notes per qellime te pergjithshme A5	99.00	0.20	19.80
26	173317	Notes ngjites 76x126MM	99.00	0.18	17.82

27	195713	Vetengjites notes me ngjyre per postim 76*76mm AQP.	99.00	0.17	16.83
28	195714	Markera permanent me ngjyra te ndryshme AQP.	29.00	0.10	2.90
29	195716	Markera per hijezim (nenvizues) me ngjyra te ndryshme AQP.	29.00	-	-
30	195840	Organizues tavoline për lapsa dhe kimika 5 tabaka. Dimenzionet WxHxD	19.00	0.77	14.63
31	209355	Vetengjites notes me ngjyra per postim 38*51 MM AQP	99.00	0.05	4.95
32	42374	Kabëll Ip cat5 cable 3ft	4.00	0.95	3.80
33	196614	Kabull vazhduese msi stream 5 white	3.00	3.50	10.50
34	176004	Foto e Presidentit shtypi ne pelhure cancas dim. 60 x 42cm punimi ne kornize dekorative druri	4.00	25.00	100.00
35	213522	MAUS WIRELES	1.00	17.45	17.45
36	14013	Kabëll	6.00	3.69	22.11
37	170068	Ujë i xhamave	11.00	2.00	22.00
38	209550	Alkohol 70 perqind 1l	28.00	2.80	78.40
39	2661	Fasiklla me mekanizem	900.00	0.10	90.00
40	2859	Zarfa A4	8.00	7.10	56.80
41	6198	fletore pune notes A5	22.00	0.98	21.56
42	9345	vizore 30 cm	31.00	3.80	117.80
43	32707	Fletore xhepi me kopertina të trasha A6	31.00	1.40	43.40
44	66504	Maska mbrojtese N95 rezistente ndaj grimcave, avujve dhe gazrave kimike	27.00	7.08	191.16
45	80620	Shirit ngjithës dy anësorë per tepison t=5cm	30.00	1.20	36.00
46	172012	Notes A4 per shenime kalendarike	120.00	2.20	264.00
47	173703	Lidhese kleme per bateria akumulatori 12V	234.00	0.25	58.50
48	195944	NOTES A5 ME KOPERTIN TE TRASH	120.00	3.00	360.00
49	494	Korrektor	40.00	0.10	4.00
50	2681	Kalkulator	1.00	1.85	1.85
51	195842	Marker per hijezim (nenvizues) me ngjyra te ndryshme	40.00	0.20	8.00
52	3898	leter A/4	700.00	2.53	1,771.00
Totali sipas kategorisë:					4,310.26
Totali:					4,310.26



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Shtojca IV - Raporti i Monitorimit “Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale”



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RAPORT MONITORIMI

Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale

Departamenti i Monitorimit dhe Analizës

korrik 2022

Përmbajtja

Hyrje	5
I. Baza ligjore	6
Ligji Nr. 04/1-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave	6
Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele	6
Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës	7
Rregullorja për Komunikime Komerciale Audiovizuale.....	7
II. Metodologjia	8
III. Shkeljet e gjetura	10
Monitorimi i OSHMA-ve me përmbajtje gjeneralistike gjatë muajit prill 2022.....	10
Monitorimi i OSHMA-ve me karakter tematik gjatë muajit maj 2022	13
Monitorimi i OSHMA-ve me karakter gjeneralistik gjatë muajit qershor-korrik 2022	13
Monitorimi i OSHMA-ve me karakter tematik gjatë muajit korrik 2022	14
IV. Gjetjet nga monitorimi	16
V. Konkluzione dhe rekomandime	19

KPM – Komisioni i Pavarur i Mediave.

DMA – Departamenti i Monitorimit dhe Analizës i KPM-së.

OSHMA – Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizuel nënkupton personin fizik ose juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuele të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.

OSH – Operatori i Shpërndarjes nënkupton personin juridik i cili shpërndanë shërbime mediale audiovizuele për përdoruesit përmes rrjetit kabllor, IPTV dhe çfarëdo forme tjetër të shpërndarjes jashtë brezit frekuencor radio-difuziv.

Termi “fëmijë” – nënkupton personat që i takojnë moshës deri në 14 vjeç.

Termi “i mitur” – nënkupton personat që i takojnë moshës prej 14 deri 18 vjeç.

Termi “kohë e kufizimit” – është koha në orarin radio/televiziv që ndan periudhën e lejueshme për të shfaqur program radio/televiziv, që ka përmbajtje për të rritur prej periudhës kur nuk është e lejueshme. “Koha e kufizimit” fillon prej orës 24:00 dhe mbaron në orën 05:00. Në shërbimet e parapagimit të cilat nuk janë të mbrojtura me kod, koha e kufizimit është po ashtu prej orës 24:00 deri në ora 05:00.

Termi “dhunë e panevojshme” – nënkupton përdorimin e qëllimshëm të forcës fizike, mekanike apo çfarëdo force tjetër për të dëmtuar, lënduar apo keqtrajtuar.

Termi “frikë” – nënkupton emocionin, shpesh të fuqishëm, që nxitet nga parashikimi për rrezik, të keqe dhe dhimbje, pavarësisht se kërcënimi është real apo imagjinar.

Termi “përmbajtje erotike” – u referohet materialeve programore, që përqendrohen tek dëshira seksuale dhe që paraqesin zona të caktuara erogjene të trupit të njeriut dhe synimin final për akt seksual, por nuk i paraqesin personat në mënyrë të qartë gjatë marrëdhënieve seksuale.

Termi “programe me përmbajtje të dëmshme” – u referohet programeve, të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, dhe moral të fëmijëve, që në mes tjerash përfshijnë përmbajtjet me dhunë fizike, verbale, gjestikulative, emocionale, seksuale ose të përfituara nëpërmjet efekteve speciale, përmbajtjet me skena seksuale përfshirë skenat me shfaqje seksuale si ekzibicionizmi, nudizmi, dhuna seksuale dhe diskriminimi gjinor dhe përmbajtja dhe programi me përmbajtje bixhozi, parashikimin e së ardhmes, leximin e letrave, shërbimeve psikike dhe të ngjashme që nuk janë vërtetuar shkencërisht.

Kategorizimi i programeve – në bazë të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele, në bazë të përmbajtjes përcaktohen katër (4) kategori programore:

- **Kategoria e parë** përfshin programet që nuk kanë përmbajtje të dëmshme.
- **Kategoria e dytë** përfshin programet që nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën dhjetë (10) vjeçare dhe për të cilat është e domosdoshme prania e prindit ose kujdestarit. Kjo kategori u referohet programeve, që përmbajnë ndonjë skenë dhune ose frike. Rastet kur bëhet portretizimi apo përshkrimi i dhunës dhe pasojave të saj mund të jenë të pranishme në përmbajtjen e programit nëse justifikohet nga objektivi i tij arsimor. Transmetimi i këtyre programeve duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjën përkatëse.
- **Kategoria e tretë** përfshin programet që përmbajnë skena dhune dhe frike, si dhe përmbajtje erotike, të cilat përsëriten relativisht shpesh. Përmbajtjet me skena seksuale mund të paraqiten në këtë kategori, përveç nëse paraqiten me qëllim të edukimit mbi seksualitetin dhe shëndetin e njeriut. Këto përmbajtje të dëmshme programore nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën katërbëdhjetë (14) vjeçare. Për programet e kategorisë së tretë prania e prindit ose kujdestarit është e domosdoshme. Transmetimi i këtyre programeve duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjën përkatëse.
- **Kategoria e katërt** përfshin programet që përmbajnë skena me përmbajtje të vazhdueshme dhune të panevojshme, frike, skena seksuale, përmbajtje pornografike, programe me përmbajtje bixhozi, parashikimin e të ardhmes, leximin e letrave, shërbimeve psikike dhe të ngjashme që nuk janë vërtetuar shkencërisht. Kjo kategori përfshin edhe përmbajtjet me skena të përdorimit të substancave narkotike, përdorimit të substancave të rrezikshme, përdorimit të armëve, produkteve të duhanit, produkteve të alkoolit, përmbajtjet ku paraqiten sjellje të rrezikshme, përmbajtjet ku përdoret gjuhë e papërshtatshme me kusht që në përmbajtjen e programit në tërësi këto nuk paraqiten si sjellje pozitive. Këto programe nuk rekomandohen për persona nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare. Transmetimi i programeve të kësaj kategorie duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjën përkatëse. Ndërsa, programet me përmbajtje pornografike mund të transmetohen vetëm në mënyrë të koduar.

Komunikimi komercial i synuar kah të miturit – komunikimi i cili rekomandon një produkt apo shërbim i cili sipas natyrës, formës, cilësisë apo arsyeve tjera të tij, synon të përdoret ekskluzivisht apo kryesisht nga të miturit, pavarësisht nëse ata mund ta përdorin atë vet apo me ndihmën e të tjerëve.

Hyrje

Qëllimi i monitorimit të përmbajtjes programore të OSHMA-ve ishte vlerësimi i pajtueshmërisë së tyre me aktet nënligjore të KPM-së, sa i përket mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuele.

Me fjalë të tjera, qëllimi i këtij raporti është përshkrimi i shkeljeve të identifikuara nga monitorimi i OSHMA-ve, e që përmes këtij përshkrimi dhe rekomandimeve të këtij raporti të ndërmerren masa nga ana e OSHMA-ve për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore dhe evitimin e ekspozimit të tyre nga përmbajtjet e tilla programore.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, KPM-ja licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuele, përfshirë këtu edhe aspektet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuele.

Lidhur me këtë, është realizuar monitorimi i OSHMA-ve me transmetim tokësor dhe OSHMA-ve me karakter gjeneralistik dhe tematik që operojnë përmes OSH-ve për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me aktet nënligjore të KPM-së që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuele.

Komisioni i Pavarur i Mediave në mënyrë të vazhdueshme ka treguar vëmendje të posaçme sa i përket zbatimit të akteve nënligjore të KPM-së nga ana e OSHMA-ve, me qëllim të mbrojtjes së kësaj kategorie të ndjeshme të shoqërisë nga përmbajtjet që mund të kenë ndikim negativ në zhvillimin e tyre fizik, mental dhe moral.

Prandaj, krahas vlerësimit të zbatueshmërisë së akteve nënligjore të KPM-së, përmes projekteve monitoruese vjetore synohet të krijohet një pasqyrë e qartë e raportit të fëmijëve dhe të miturve në përmbajtjet mediale audiovizuele, respektivisht mbrojtjes së tyre nga përmbajtjet e dëmshme dhe të papërshtatshme.

I. Baza ligjore

Çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale janë të parapara në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në¹ dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së, përfshirë këtu:

- Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale²;
- Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës³; dhe
- Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale⁴.

Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave

Dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale në Ligjin për KPM-në përcaktohen në nene të caktuara të këtij ligji që kanë të bëjnë me:

- Përmbajtjen e Komunikimeve komerciale audiovizuale, produktet e reklamuar (sipas nenit 27);
- Sponsorizimin e programeve për fëmijë (sipas nenit 31);
- Vendosjen e produkteve (sipas nenit 32); dhe
- Masat e duhura për të siguruar mbrojtjen në përgjithësi të fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme (sipas nenit 33).

Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale

Kjo Rregullore në tërësi i është dedikuar mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e programeve të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mental dhe moral, përfshirë edhe mbrojtjen e identitetit dhe respektimin e dinjitetit të fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

Në bazë të kësaj Rregulloreje përcaktohet edhe mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe koha e transmetimit të programeve të tilla.

1 <https://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1335165851.7107.pdf>

2 <https://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1370439037.589.pdf>

3 <https://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1476189555.8908.pdf>

4 <https://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1514284325.0124.pdf>

Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës

Dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale në Kodin e Etikës përfshijnë çështjet lidhur me:

- Gjuhën e përdorur në përmbajtje programore (sipas nenit 4); dhe
- Praninë dhe prezencën e fëmijëve në përmbajtjet programore në përgjithësi, përfshirë këtu çështjet e privatësisë, intervistat me fëmijë, etj. (sipas nenit 9).

Rregullorja për Komunikime Komerciale Audiovizuale

Dispozitat ligjore lidhur me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale në Rregulloren për KKAV kanë të bëjnë kryesisht me:

- Përmbajtjen e komunikimeve komerciale audiovizuale, produktet dhe shërbimet e reklamuar, si dhe ndikimit të tyre tek fëmijët dhe të miturit (sipas nenit 9 dhe nenit 16);
- Orarin e transmetimit të KKAV-ve dhe teleshoppingut për produkte të caktuara (sipas nenit 10);
- Mënyrat e reklamimit (sipas nenit 12) dhe format e reklamimit si sponsorizimi i programeve për fëmijë (sipas nenit 14) dhe vendosja e produkteve (sipas nenit 15); dhe
- Obligimet që kanë të bëjnë me Ofruesit e Shërbimeve Mediale Radio (sipas nenit 24 dhe 25).

II. Metodologjia

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së OSHMA-ve me aktet nënligjore të KPM-së që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale, është bërë mbledhja e të dhënave, përkatësisht incizimi i përmbajtjeve programore të transmetuara, përmes sistemit të monitorimit⁵, i cili ka mundësuar ruajtjen e përmbajtjeve programore të subjekteve të këtij monitorimi.

Përmes këtij sistemi, është bërë analizimi dhe vlerësimi i përmbajtjeve programore të transmetuara gjatë periudhës monitoruese.

Materialet referente bazë në dispozicion kanë qenë legjislacioni i Komisionit të Pavarur të Mediave, respektivisht rregulloret: Rregullorja KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale, KKPM-2016/03 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe Rregullorja KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale. Këto rregullore janë zgjedhur për arsye se përbrenda vetes përmbajnë dispozita ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

Vlerësimi dhe analizimi është fokusuar në identifikimin e programeve me përmbajtje të dëmshme, që sipas akteve nënligjore në mes tjerash i referohen programeve që ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental dhe moral të fëmijëve, e që përfshijnë përmbajtje me dhunë fizike, verbale, gjestikulative, emocionale, seksuale ose të përfituara nëpërmjet efekteve speciale, përmbajtjet me skena seksuale përfshirë skenat me shfaqje seksuale si ekzibicionizmi, nudizmi, dhuna seksuale dhe diskriminimi gjinor dhe përmbajtja dhe programi me përmbajtje bixhozi, parashikimin e së ardhmes, leximin e letrave, shërbimeve psikike dhe të ngjashme që nuk janë vërtetuar shkencërisht.

Vlerësimi është bërë edhe sa i përket kohës së transmetimit të përmbajtjeve të tilla programore, paralajmërimit dhe përdorimit të shenjave përkatëse të përcaktuara në Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale.

Po ashtu, vlerësimi dhe analizimi është bërë edhe në rastet kur fëmijët apo të miturit kanë qenë të përfshirë apo prezentë në përmbajtje të caktuara programore.

Monitorimi ka përfshirë periudhën kohore tri (3) ditore të zgjedhur në mënyrë rastësore, gjatë muajit:

- 1) prill ku janë përfshirë njëzet e një (21) OSHMA me përmbajtje gjeneralistike:
 - gjashtëmbëdhjetë (16) OSHMA me transmetim tokësor: RTK1, TV 21, TV Koha Vision, TV Puls, TV Besa, TV Vali, TV Mir, TV Most, TV Herc, TV Festina, TV Liria, TV Prizreni, TV Dukagjini, TV Syri Vision, TV Mitrovica dhe TV Tema;

⁵ Sistemi i monitorimit i dizajnuar për nevojat e Departamentit të Monitorimit dhe Analizës të KPM-së, për incizim dhe monitorim të përmbajtjeve programore të të licencuarve të KPM-së, në formë audio dhe audiovizuale.

- Pesë (5) OSHMA me transmetim përmes OSH-ve: RTK2, Klan Kosova, TE7, Kanal 10 dhe ATV.

Tri OSHMA me transmetim tokësor lokal/regjional: TV Iliria, TV Opinion dhe TV Zoom nuk janë përfshirë në monitorim për arsye të mungesës së incizimit të sinjalit të tyre për shkak të mos transmetimit nga ana e tyre.

- 2) maj dhe ka përfshirë katër (4) OSHMA me përmbajtje tematike (muzikë) që operojnë përmes OSH-ve: ON TV, Zico TV, MTV Kosova dhe First Channel.
- 3) qershor/korrik dhe ka përfshirë pesë (5) OSHMA me përmbajtje gjeneralistike të gjetura në shkelje gjatë muajit prill:
 - Tri (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional: TV Koha Vision, TV Vali dhe TV Mir.
 - Dy (2) OSHMA me transmetim përmes OSH-ve: Klan Kosova dhe Kanal 10.
- 4) korrik dhe ka përfshirë katër (4) OSHMA me përmbajtje tematike (muzikë) të gjetura në shkelje gjatë muajit maj: ON TV, Zico TV, MTV Kosova dhe First Channel.

III. Shkeljet e gjetura

Në bazë të monitorimit, është vërejtur se OSHMA-të gjatë periudhës monitoruese kanë vepruar në kundërshtim me:

- Rregulloren KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuale, kryesisht gjatë transmetimit të programeve me përmbajtje të dëmshme jashtë kohës së paraparë dhe mos paralajmërimit, kategorizimit dhe shoqërimit me shenja përkatëse të këtyre përmbajtjeve; dhe
- Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, sa i përket gjuhës së përdorur në përmbajtje programore.

Shkelje tjera janë gjetur edhe lidhur me:

- mbrojtjen e identitetit dhe respektimin e dinjitetit të fëmijëve dhe të miturve në programe në dy raste, në kundërshtim me Kodin e Etikës dhe Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuale; dhe
- vendosjen e produktit në programe për fëmijë në një rast dhe reklamimin e shitjes së armëve, në kundërshtim me Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, përkatësisht.

Monitorimi i OSHMA-ve me përmbajtje gjeneralistike gjatë muajit prill 2022

Në bazë të monitorimit, tri ditë nga ora 00:00-24:00 të zgjedhur në mënyrë rastësore, të përmbajtjeve programore të transmetuara gjatë muajit prill në njëzet e një (21) OSHMA-të me karakter gjeneralistik, në pajtueshmëri me aktet nënligjore të KPM-së, përkatësisht dispozitave ligjore të parapara për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale, kanë vepruar gjashtëmbëdhjetë (16) OSHMA: RTK1, RTK2, TV 21, TV Puls, TV Besa, TV Most, TV Herc, TV Festina, TV Liria, TV Prizreni, TV Dukagjini, TV Syri Vision, TV Mitrovica, TV Tema, TE7 dhe ATV.

Ndërsa, në shkelje të akteve nënligjore sa i përket dispozitave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale, në shkelje janë gjetur pesë (5) OSHMA: TV Koha Vision, TV Vali, TV Mir, Klan Kosova dhe Kanal 10.

RTK1 – në periudhën monitoruese më datën 9, 11 dhe 13 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

RTK2 – në periudhën monitoruese më datën 15, 17 dhe 19 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TV 21 – në periudhën monitoruese më datën 9, 11 dhe 13 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TV Puls – në periudhën monitoruese më datën 9, 11 dhe 13 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TV Besa – në periudhën monitoruese më datën 9, 11 dhe 13 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TV Most – në periudhën monitoruese më datën 15, 20 dhe 23 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TV Herc – në periudhën monitoruese më datën 14, 15 dhe 16 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TV Festina – në periudhën monitoruese më datën 9, 12 dhe 13 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TV Liria – në periudhën monitoruese më datën 9, 11 dhe 13 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TV Prizreni – në periudhën monitoruese më datën 26, 27 dhe 30 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TV Dukagjini – në periudhën monitoruese më datën 9, 11 dhe 13 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TV Syri Vision – në periudhën monitoruese më datën 9, 11 dhe 13 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TV Mitrovica – në periudhën monitoruese më datën 9, 11 dhe 13 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TV Tema – në periudhën monitoruese më datën 9, 11 dhe 13 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

TE7 – në periudhën monitoruese më datën 9, 11 dhe 13 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

ATV – në periudhën monitoruese më datën 9, 12 dhe 13 prill 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

KTV – në periudhën monitoruese më datën 09, 11 dhe 13 prill 2022, shkelje është vërejtur sa i përket Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, përkatësisht nenit 3, paragrafi 3, dhe nenit 6, paragrafi 2, për shkak të mos paralajmërimit të një seriali me përmbajtje të dëmshme programore për fëmijë dhe të mitur dhe transmetimit të tij jashtë kohës së paraparë me Rregullore.

TV Vali – në periudhën monitoruese më datën 09, 11 dhe 13 prill 2022, shkelje është gjetur sa i përket mos shoqërimit me shenjë përkatëse të filmave artistik me përmbajtje të dëmshme programore për fëmijë dhe të mitur, siç parashihet me nenin 3, paragrafi 3, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve.

Ndërsa, sa i përket Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale, shkelje është gjetur gjatë transmetimit të reklamimit televiziv të një pike të shitjes së armëve dhe poligonit të shenjëtarisë, në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 1.

TV Mir – në periudhën monitoruese më datën 09, 11 dhe 13 prill 2022, shkelje janë gjetur sa i përket mos kategorizimit, paralajmërimit dhe shoqërimit me shenjë përkatëse të serialeve dhe filmave artistik me përmbajtje të dëmshme programore për fëmijë dhe të mitur, siç parashihet me nenin 3, paragrafi 1 dhe 3, dhe nenin 7, paragrafi 1, 2 dhe 3, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, si dhe transmetimit të tyre jashtë kohës së paraparë sipas nenit 6, paragrafi 2 dhe 3, të kësaj Rregulloreje.

Klan Kosova – në periudhën monitoruese më datën 09, 12 dhe 14 prill 2022, shkelje janë gjetur sa i përket mos kategorizimit, paralajmërimit dhe shoqërimit me shenjë përkatëse të serialeve dhe një filmi artistik me përmbajtje të dëmshme programore për fëmijë dhe të mitur, siç parashihet me nenin 7, paragrafi 1, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, si dhe transmetimit të tyre jashtë kohës së paraparë sipas nenit 6, paragrafi 2, të kësaj Rregulloreje.

Në disa raste serialet janë shoqëruar me piktograme ndryshe nga ato të përcaktuara në Rregullore.

Po ashtu, gjatë periudhës monitoruese, shkelje është vërejtur edhe gjatë transmetimit të një programi për fëmijë në të cilin ka pasur vendosje të produktit, në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 2, pika 2.2, të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale.

Kanal 10 – në periudhën monitoruese më datën 9, 12 dhe 14 prill 2022, shkelje janë gjetur sa i përket mos kategorizimit, paralajmërimit dhe shoqërimit me shenjë përkatëse të filmave artistik me përmbajtje të dëmshme programore për fëmijë dhe të mitur, siç parashihet me nenin 3, paragrafi 3, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, si dhe shkelje të nenit 7, paragrafi 1, për shkak të përdorimit të piktogrameve ndryshe nga ato të përcaktuara në Rregullore.

Monitorimi i OSHMA-ve me karakter tematik gjatë muajit maj 2022

Në bazë të monitorimit, tri ditë nga ora 07:00-24:00 të zgjedhur në mënyrë rastësore, të përmbajtjeve programore të transmetuara gjatë muajit maj në katër (4) OSHMA-të me karakter tematik (muzikë): ON TV, Zico TV, MTV Kosova dhe First Channel, është gjetur se të gjitha këto OSHMA kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të parapara për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

Në periudhën monitoruese më datën 26, 27 dhe 28 maj 2022, këto OSHMA kanë vepruar në kundërshtim me:

- Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale, përkatësisht nenin 3, paragrafi 1, për shkak të transmetimit të përmbajtjeve programore (videoklipeve muzikore) me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur jashtë kohës dhe kushteve të parapara në këtë Rregullore. Këto videoklipe kanë përmbajtur skena dhune, frike, erotike, përdorim të substancave narkotike, përdorim të armëve, gjuhë vulgare dhe ofenduese; dhe
- Kodin e Etikës Ofruesit e Shërbimeve Mediale, përkatësisht nenin 4, paragrafi 1, duke transmetuar jashtë kohës së kufizimit përmbajtje programore (videoklipeve muzikore) në të cilat ka pasur gjuhë vulgare dhe ofenduese. Në OSHMA First Channel, gjuhë vulgare dhe ofenduese është përdorur edhe gjatë transmetimit të disa emisione argëtuese.

Monitorimi i OSHMA-ve me karakter gjeneralistik gjatë muajit qershor-korrik 2022

Në bazë të monitorimit, tri ditë nga ora 00:00-24:00 të zgjedhur në mënyrë rastësore, të përmbajtjeve programore të transmetuara gjatë muajit qershor-korrik në pesë (5) OSHMA-të me karakter gjeneralistik: TV Koha Vision, TV Vali, TV Mir, Klan Kosova dhe Kanal 10, është gjetur se të gjitha këto OSHMA kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të parapara për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

KTV – në periudhën monitoruese më datën 26, 27 dhe 28 qershor 2022, shkelje janë vërejtur sa i përket Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, përkatësisht nenit 3, paragrafi 3, dhe nenit 6, paragrafi 2, për shkak të mos paralajmërimit, kategorizimit dhe shoqërimit me shenjë përkatëse të një seriali me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur dhe transmetimit të tij jashtë kohës së paraparë me Rregullore.

Ndërsa, për shkak të cenimit të privatësisë së fëmijëve dhe zbulimit të identitetit të tyre përmes paraqitjes vizuale të fytyrave të tyre, gjatë transmetimit të një programi lidhur me një qendër që ofron shërbime për fëmijët dhe të miturit me dëmtime në të folur, dëgjim, sindrom down, autizëm, me zhvillim të vonshëm etj., kjo OSHMA është gjetur në shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve dhe nenit 9, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

TV Vali – në periudhën monitoruese më datën 26, 27 dhe 28 qershor 2022, shkelje është gjetur vetëm sa i përket Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale, gjatë transmetimit të reklamimit televiziv të një pike të shitjes së armëve dhe poligonit të shenjtarisë, në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 1.

TV Mir – në periudhën monitoruese më datën 24, 26 dhe 27 qershor 2022, shkelje është gjetur vetëm gjatë transmetimit të një seriali me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur, i cili nuk është paralajmëruar, kategorizuar dhe shoqëruar me shenjë përkatëse, siç përcaktohet në nenin 3, paragrafi 1 dhe 3, dhe nenin 7 të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve. Ky serial gjithashtu është transmetuar jashtë kohës së paraparë me nenin 6, paragrafi 2, të kësaj Rregulloreje.

Klan Kosova – në periudhën monitoruese më datën 25, 26 dhe 27 qershor 2022, shkelje janë gjetur sa i përket Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, përkatësisht nenit 6, paragrafi 2, dhe nenit 7, për shkak të transmetimit të serialeve me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur jashtë kohës së paraparë dhe përdorimit të piktogrameve ndryshe nga ato të përcaktuara në Rregullore.

Kanal 10 – në periudhën monitoruese më datën 3, 4 dhe 5 korrik 2022, shkelje është gjetur vetëm gjatë transmetimit të një dokumentari me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur, me ç'rast ky program nuk është paralajmëruar, shoqëruar dhe kategorizuar sipas nenit 3, paragrafi 3, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve. Po ashtu, në këtë emision është paraqitur edhe fytyra e një fëmije viktimë e luftës, përkatësisht zbulimi i identitetit të një fëmije viktimë, në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 2, të kësaj Rregulloreje. Ky program është transmetuar gjithashtu jashtë kohës së paraparë me nenin 6, paragrafi 2, të kësaj Rregulloreje.

Monitorimi i OSHMA-ve me karakter tematik gjatë muajit korrik 2022

Në bazë të monitorimit, tri ditë nga ora 07:00-24:00 të zgjedhur në mënyrë rastësore, të përmbajtjeve programore të transmetuara gjatë muajit korrik në OSHMA-të me karakter tematik (muzikë), është gjetur se OSHMA-të: Zico TV, ON TV dhe First Channel kanë vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale, ndërsa në shkelje është gjetur vetëm OSHMA MTV Kosova.

ZIKO TV – në periudhën monitoruese më datën 3, 4 dhe 5 korrik 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

ON TV – në periudhën monitoruese më datën 3, 4 dhe 5 korrik 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

First Channel – në periudhën monitoruese më datën 13, 15 dhe 16 korrik 2022, është gjetur se kjo OSHMA ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale.

MTV Kosova – në periudhën monitoruese më datën 3, 4 dhe 5 korrik 2022, kjo OSHMA ka vepruar në kundërshtim me:

- Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale, përkatësisht nenin 3, paragrafi 1, për shkak të transmetimit të përmbajtjeve programore (videoklipeve muzikore) me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur jashtë kohës dhe kushteve të parapara në këtë Rregullore. Këto videoklipe kanë përmbajtur skena erotike, gjuhë vulgare dhe ofenduese.
- Kodin e Etikës Ofruesit e Shërbimeve Mediale, përkatësisht nenin 4, paragrafi 1, duke transmetuar jashtë kohës së kufizimit përmbajtje programore (videoklipeve muzikore) në të cilat ka pasur gjuhë vulgare dhe ofenduese.

IV. Gjetjet nga monitorimi

Shkeljet më të shpeshta të identifikuara gjatë monitorimit kishin të bëjnë kryesisht me kufizimet dhe obligimet e përgjithshme të ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale të parapara në Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, si:

- mos-paralajmërimi me sinjal akustik apo tekstual para fillimit dhe pas ndërprerjeve të programeve me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur;
- mos-kategorizimi i përmbajtjeve programore me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur;
- mos-përdorimi me shenja përkatëse të përmbajtjeve programore me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur apo përdorimi i piktogramave ndryshe nga ato të parapara; dhe
- transmetimi i programeve të kategorive të caktuara jashtë kohës së paraparë sipas Rregullores.

Dy shkelje janë vërejtur edhe sa i përket mbrojtjes së identitetit dhe respektimit të dinjitetit të fëmijëve dhe të miturve në programe, në kundërshtim me nenin 4 të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale dhe nenin 9, paragrafi 1, të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale.

Ndërsa, sa i përket Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, shkelje janë gjetur sa i përket:

- përdorimit të formës së komunikimit komercial të vendosjes së produktit në emisione për fëmijë, në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 2, pika 2.2; dhe
- transmetimit të reklamimit televiziv të një pike të shitjes së armëve dhe poligonit të shenjëtarisë, në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 1.

Sipas Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale parashihet që:

Neni 3, paragrafi 1: *“Shërbyesit medial audio-vizuel nuk do të transmetojnë programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, përveçse në kohën dhe kushtet e përcaktuara me këtë rregullore”.*

